



RINIA PUNË

Diskutim për sigurinë



RINIA PUNË

Diskutim për sigurinë

Disclaimer

Parathënie

Në Kosovë, mosha minimale për punësim është mosha 15 vjeçare, dhe adoleshentët, si punëtorë të moshës së re, ka më shumë gjasë të jenë pa përvojë dhe pa informacion për shumë detyra që priten prej tyre. Siguria në punë është zakonisht gjëja e fundit për të cilën ata brengosen. Shumë nga tiparet më pozitive të të rinjëve-energji, entuziazmi dhe nevoja për përgjegjësi dhe sfida gjithnjë e më të mëdha- mund të ndikojnë që ata të marrin përsipër obligime të cilat nuk janë të përgatitur që t' i përmbushin në mënyrë të sigurtë. Ata gjithashtu kanë tendencë të hezitojnë të shtrojnë pyetje dhe t'u bëjnë kërkesa punëdhënësve të tyre. Shumë prej tyre përfundojnë duke punuar në kushte të rrezikshme.

Për të adresuar këto probleme, vendet e zhvilluara ka vite që kanë filluar me integrimin e koncepteve të sigurisë dhe shëndetit në punë në kuadër të kurrikulave shkollore. Në nivelin fillor, këto kurrikula fokusohen në arsimimin për mbrojtje nga rreziqet, p.sh. përgatitja e fëmijëve që jo vetëm të identifikojnë rreziqet e ndryshme në mjediset ku kalojnë kohën por edhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të iu shmangur atyre. Në nivelin e mesëm të ulët dhe të lartë, kurrikulat janë kryesisht të përqëndruara në përgatitjen e fëmijëve për botën e punës pasi që ata i afrohen moshës minimale të punësimit. Vetdijësimi i fëmijëve për sigurinë dhe shëndetin në punë nuk ka të bëjë vetëm me përgatitjen e tyre për siguri vetanake në vendin e punës, por konsiderohet edhe si një element i rëndësishëm për ndërtimin e një kulture të parandalimit dhe për avansimin e sigurisë në vendet e punës.

Duke njohur rëndësinë e përfshirjes së arsimit për shëndetin dhe sigurinë në punë në kuadër të përvojave mësimore të nxënësve që në nivelin e mesëm të ulët, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka kërkuar mbështetjen e Zyrës Ndërkombëtare të Punës-Programi për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (ILO IPEC) për hartimin e një moduli mbi sigurinë dhe shëndetin në punë.

Si përgjigje në këtë kërkesë, ILO IPEC i ka rekomanduar MASHT-it përshtatjen e kurrikulës “Rinia në punë: Diskutim për sigurinë” (*Youth @ Work—Talking Safety Curriculum*) hartuar nga Instituti Kombëtar i Shteteve të Bashkuara për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (*US National Institute for Occupational Safety and Health-NIOSH*).

Kjo kurrikulë ndihmon zotërimin e dijeve themelore mbi sigurinë në punë dhe është relevante për çdo profesion dhe për çdo fazë të jetës së punës. Aktivitetet e të nxënësve në këtë kurrikulë synojnë ngritjen e vetdijës së të rinjëve mbi sigurinë në vendin e punës dhe zhvillimin e shkathtësive të nevojshme që të bëhen pjesëmarrës aktiv në ndërtimin e mjediseve të sigurt dhe të shëndetshme të punës, tani dhe gjatë gjithë jetës së tyre.

Përmbledhje

Anë e mbanë botës me miliona adoleshent punojnë, pra janë pjesë e tregut të punës. Statistikat e ndryshme ndërkombëtare tregojnë se koha e punësimit të tyre fillon nga mosha 15-17 vjeçare, por në disa vende edhe më herët. Në këtë kuadër bën pjesë edhe vendi ynë, Kosova, ku mosha minimale për punësim është mosha 15 vjeçare.

Edhe pse puna ofron shumë përfitime për të rinjtë, ajo mund të jetë e rrezikshme për shëndetin dhe jetën e tyre. Hulumtimet e ndryshme tregojnë se mundësitë për lëndime në punë janë dy herë më të mëdha tek adoleshentët se sa te punëtorët e rritur.

Arsimi për sigurinë dhe shëndetin në punë është qenësor për të parandaluar lëndimet e të rinjëve në punë. Në këtë kontekst, është shumë e rëndësishme që ata krahas trajnimeve të vecanta të sigurisë në punë (që u referohen sektorëve të caktuar punues, respektivisht profesioneve të vecanta) të zotërojnë edhe shkathtësitë e përgjithshme dhe të transferueshme të shëndetit dhe sigurisë në punë. Të rinjtë duhet të përgatiten që t'i identifikojnë rreziqet në cdo vend pune. Ata duhet të kuptojnë se rreziqet mund të kontrollohen, duhet të jenë të përgatitur të veprojnë në situata emergjente, duhet të jenë të informuar për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në punë dhe duhet të jenë në gjendje të flasin në mënyrë efektive kur të përballen me probleme në punë. Kurrikulat shkollore duhet të ofrojnë një vend të rëndësishëm për mësimin e këtyre aftësive.

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë po i kushton një vëmendje të veçantë kësaj çështje. Ndryshimet kurrikulare që kanë ndodhur viteve të fundit, të formësuara në dokumentet bazike Korniza e Kurrikulës dhe Kurrikulat Bërthamë, ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për të trajtuar këtë çështje me rëndësi. Këto dokumente në thelbin e tyre përmbajnë zhvillimin e kompetencave për arsimin gjatë tërë jetës, të lidhura ngushtë me kërkesat e tregut të punës. Filozofia e kurrikulës së re përqendrohet në krijimin e këtyre aftësive tek të rinjtë. Ato synohet të arrihen përmes të gjitha fushave kurrikulare. Por, fusha kurrikulare Jeta dhe puna e veçanërisht lënda mësimore Teknologjia janë të dedikuara për t'i realizuar ato drejtpërdrejt.

Ky modul mësimor, që po u ofrohet mësimdhënësve dhe nxënësve kosovar, mund të realizohet si pjesë integrale e lëndës teknologjia, por edhe përmes lëndëve dhe fushave tjera kurrikulare si p.sh. përmes moduleve mësimore të praktikës profesionale (si njësi e veçantë modulare) në shkollat e mesme profesionale dhe përmes fushës kurrikulare Shoqëria dhe mjedisi, në gjimnaze. Gjithashtu, ky modul mund të realizohet edhe tek pjesa e mësimin me zgjedhje, varësisht nga interesimet, kërkesat dhe nevojat e nxënësve.

Mirënjohje

Moduli mësimor Siguria në Punë është përshtatur për përdorim në Kosovë nga grupi punues ndër-institucional, i themeluar nga MASHT, me mbështetjen e Lindita Boshtrakaj, Menagjere e ILO IPEC në Prishtinë. Grupi punues ishte me këtë përbërje:

1. Merita Jonuzi, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
2. Mimoza Hasani, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
3. Ryve Prekorogja, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
4. Enesa Kadiq, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
5. Arbër Salihu, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
6. Luan Sahitaj, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
7. Naxhije Shala-Ajvazi, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
8. Binak Gërguri, Instituti Pedagogjik i Kosovës
9. Selvete Sadiku, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
10. Sherife Sekiraqa, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
11. Agim Millaku, Inspektorati i Punës
12. Ferat Emini, Instituti i Mjekësisë së Punës
13. Genc Bajraktari, Instituti i Shëndetit Publik

Procesi i përgatitjes së materialit është mbështetur nga Zyra Ndërkombëtare e Punës-Programi për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (ILO-IPEC) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, Institutin Pedagogjik të Kosovës, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës, Inspektoratin e Punës, Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës, Institutin e Shëndetit Publik dhe Institutin e Mjekësisë së Punës. Drafti i përgatitur nga grupi punues është diskutuar në një takim konsultativ me 32 mësimdhënës të shkollave të mesme të ulta dhe të shkollave profesionale. Lista e mësimdhënësve që kanë kontribuar në finalizimin e materialit është e bashkëngjitur.

MASHT falenderon ILO IPEC, grupin punues dhe mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulta dhe të shkollave profesionale për kontributin e ofruar në përshtatjen e materialit.

Përmbajtja e modulit: Siguria në punë

Moduli “Siguria në Punë” përfshin planet e detajuara mësimore për gjashtë njësi mësimore themelore dhe për katër njësi plotësuese, shënime të detajuara për mësimdhënësit, materialet për nxënësit dhe sllajdet në PowerPoint.¹

Mësimdhënësit kanë shumë opsione gjatë përdorimit të këtij moduli. Të gjitha mësimet nga 45-minuta (gjashtë mësimet themelore, plus katër plotësuese, mësimet “B”) përmbajnë aktivitete për të mësuar aftësitë dhe konceptet kryesore mbi sigurinë në punë. **Përmbajtja thelbësore mund të mbulohet në gjashtë orë mësimore.** Pesë njësitë mësimore “B” ofrojnë një shqyrtim shtesë ose më në detaje të përmbajtjes së njësive themelore të mësimimit, duke iu referuar situatave reale punuese të përzgjedhura nga vet nxënësit.²

Çdo njësi mësimore përmban seksionet e mëposhtme:

Qëllimi i orës mësimore dhe rezultatet e pritura: Jep qëllimin e orës mësimore dhe pritshmëritë për arritshmërinë e nxënësve në fund të secilës orë mësimore

Çështjet kryesore që duhen të mirren parasysh: Ofron konceptet e rëndësishme që duhet të zotërohen nga nxënësit gjatë orës mësimore

Përgatitja: Ofron një listë të hapave që mësimdhënësit duhet të ndjekin gjatë përgatitjes për realizimin e njësisë mësimore (siç janë: pajisjet, materialet për fotokopjim).

Plani i orës mësimore: Përmbledhje të aktiviteteve të përfshira dhe kohën e nevojshme për çdo aktivitet.

Udhëzime për realizimin e njësisë mësimore: Ofron udhëzime të plota për realizimin e secilit hap gjatë orës mësimore, duke përfshirë informata plotësuese për mësimdhënësit rreth përmbajtjes së mësimimit. Mësimdhënësit duhet të lexojnë materialet e mësimdhënësit para çdo mësimdhënie; ata mund ti referohen atyre edhe gjatë mësimimit.

Materialet për mësimdhënësit: Ofrojnë të gjitha instrumentet e nevojshme për realizimin e njësisë mësimore (kuizet, informata plotësuese për mësimdhënësin sa i përket interpretimit të sllajdeve, shembuj të situatave të ndryshme në punë apo përgjigjet e sakta të kuizeve që rekomandohen të aplikohen me nxënësit).

Materialet për nxënësit: përmbajnë ilustrimet, fletat e punës dhe udhëzimet e nevojshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara në kuadër të këtij moduli.

¹ Mësimdhënësit mund të përdorin grafoskop në vend të sllajdeve në PowerPoint duke printuar në folie prezantimin i cili është në dispozicion në faqen e MASHT

² Nëse ju keni vetëm një orë mësimore për të ia kushtuar kësaj teme, ju mund të përdorni Mësimin 1 për të ofruar nxënësve tuaj një vështrim të përgjithshëm të koncepteve jetike për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.

Çdo njësi mësimore (themelore dhe plotësuese) fillon me një diskutim hyrës, i ndjekur nga dy apo tre aktivitete të të nxënësve, me pjesëmarrje të nxënësve, me qëllim përvetësimin e koncepteve të atij mësimi dhe zhvillimin e shkathtësive përkatëse³.

Kurrikula është fleksibile dhe ofron shumë alternativa për të zgjedhur. Mësimdhënësit duhet të shqyrtojnë të gjitha aktivitetet e çdo mësimi dhe të përzgjedhin aktivitetet që ata vlerësojnë se do të jenë më efektive për nxënësit e tyre. Ne inkurajojmë mësimdhënësit që edhe t'i përshtasin sesionet dhe mësimet për t'i shërbyer sa më mirë nxënësve të tyre. Për shembull, mësimdhënësit mund të përzgjedhin skenare dhe raste studimore/situata të ndryshme të punës së të rinjëve që janë më relevante për nxënësit me të cilët zhvillojnë mësimin. Ata poashtu mund të krijojnë skenare të reja të bazuara në situata reale.

Shumë prej mësimëve përfshijnë detyra shtëpie, të cilat poashtu mund të përshtaten sipas specifikave të komunitetit ku vepron shkolla apo të nxënësve tuaj.

³ Nga hartuesit e kurrikulës (versionit origjinal) disa nga këto aktivitete janë testuar dhe kanë rezultuar të përshtatshme edhe me nxënës të cilët kanë aftësi të kufizuara njohëse (kognitive) dhe të nxënësve.

Përmbajtja

| | |
|---|------|
| Disclaimer..... | iv |
| Parathënie | v |
| Përmbledhje | vii |
| Mirënjohje..... | viii |
| Përmbajtja e modulit: Siguria në punë | ix |
| Hyrje | xv |
| Mësimi 1: Lëndimet e punëtorit të ri | 1 |
| Mësimi 2: Identifikimi i rreziqeve | 19 |
| Mësimi 2B: Identifikimi i Rreziqeve | 37 |
| Mësimi 3: Përmirësimi i sigurisë në punë..... | 47 |
| Mësimi 3B: Përmirësimi i sigurisë në punë | 81 |
| Mësimi 4: Emergjencat në punë..... | 91 |
| Mësimi 4B: Emergjencat në punë | 107 |
| Mësimi 5: Dini të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja | 115 |
| Mësimi 5B: Dini të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja..... | 129 |
| Mësimi 6: Ndërmarrja e Veprimit | 145 |
| Mësimi 6B: Ndërmarrja e Veprimit | 159 |

| | |
|---|-----|
| Materiali për nxënësit | 171 |
| Kuizi i sigurisë në punë | 173 |
| Gjeni rreziqet: Restaurant i ushqimeve të shpejta | 175 |
| Gjeni rreziqet: Dyqan ushqimor | 177 |
| Gjeni rreziqet: Zyra | 179 |
| Gjeni rreziqet: Pikë e karburantit..... | 181 |
| Identifikimi i rreziqeve | 183 |
| Zgjidhjet e rreziqeve: Restorante dhe kafiteri | 185 |
| Zgjidhjet e rreziqeve: Shitje me pakicë | 187 |
| Zgjidhjet e rreziqeve: Kinemaja..... | 189 |
| Zgjidhjet e rreziqeve: Zyra | 191 |
| Kërkimi i informatave | 193 |
| Profesionet kryesore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë | 197 |
| Emergjencat në lajme | 199 |
| Plani i veprimit të emergjencave | 203 |
| A je ti një punonjës i ri në Kosovë?: Mbroj shëndetin! Njih të drejtat tua! | 205 |
| Ligji i punës bingo! (Tabela 1-13)..... | 211 |
| Tregimi i Elenes | 237 |
| Çka keni mësuar? | 239 |

RINIA PUNË

Diskutim për sigurinë

Hyrje

Hyrje

Moduli Siguria në Punë është përgatitur për shfrytëzim në nivelin e mesëm të ulët-shkalla kurrikulare 4, në kuadër të lëndës *Teknologjia për klasën e IX*, për nivelin e mesëm të lartë- shkalla kurrikulare 5 - shkollat profesionale, në kuadër të *moduleve mësimore të praktikës profesionale (si njësi e veçantë modulare)* dhe për nivelin e mesëm të lartë-shkalla kurrikulare 5 – gjimnazet, në kuadër të fushës kurrikulare *Shoqëria dhe mjedisi*.

Aktivitetet e të mësuarit në këtë modul nxjerrin në pah rreziqet dhe strategjitë e parandalimit dhe mbrojtjes nga rreziqet në vende të ndryshme të punës. Materialet janë fleksibile dhe mësimdhënësit mund t'i përshtatin ato për nivelin, respektivisht shkallën kurrikulare kur zhvillohet ky modul, si dhe për fushën kurrikulare në kuadër të së cilës zhvillohet moduli. Mësimdhënësit poashtu mund të zgjedhin shembuj dhe skenarë të tjerë të vendeve të punës që mund të jenë më tipik për komunitetin ku vepron shkolla dhe për nevojat e nxënësve me të cilët zhvillohet ky modul.

Rezultatet e përgjithshme të të nxënësve

Siguria në Punë është një modul që mundëson zhvillimin e aftësive dhe përvetësimin e njohurive themelore mbi sigurinë dhe shëndetin në punë, relevante për cdo profesion dhe për cdo fazë të jetës së punës. Aftësitë e transferueshme që zhvillohen përmes këtij moduli do t'i ndihmojnë nxënësve të jenë të sigurt dhe të shëndetshëm gjatë gjithë jetës së tyre. Ato kontribuojnë drejtpërdrejt edhe në zotërimin e kompetencave kryesore të kurrikulës së arsimit para universitar në Kosovë.

Me rastin e përfundimit të këtij moduli nxënësve:

1. Kuptojnë se, edhe pse puna ka përfitime, të gjithë punëtorët mund të lëndohen, të sëmurën ose edhe të humbin jetën në punë. Punëtorët duhet të dinë se si rreziqet në vendin e punës mund të ndikojnë në jetën e tyre dhe të familjeve të tyre;
2. Kuptojnë se lëndimet dhe sëmundjet që lidhen me punën janë të parashikueshme dhe mund të parandalohen;
3. Identifikojnë rreziqet në punë dhe parashikojnë efektin e tyre të mundshëm te punëtorët në një vend pune;
4. Përshkruajnë mënyrat më të mira për të adresuar rreziqet në vendin e punës;
5. Identifikojnë urgjencat në punë dhe zgjedhin mënyrat më të mira për t'i adresuar ato;

-
6. Janë të vetdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë e punëdhënësve dhe punëtorëve sa i përket sigurisë dhe shëndetit në punë;
 7. Gjejnë burime të informacioneve për sigurinë dhe shëndetin në punë;
 8. Demonstrjnë forma të komunikimit efektiv me të tjerët për zgjidhjen e problemeve të sigurisë dhe shëndetit në punë - përfshirë komunikimin me njerëzit me autoritet dhe punëdhënësit e tyre.

Të gjitha mësimet janë hartuar për një orë mësimore prej 45 minuta. Disa sesione përshtaten mirë me këtë afat kohor, ndërsa të tjerat kërkojnë që mësimdhënësi të ec me një ritëm më të shpejtë apo të zgjedh në mesin e aktiviteteve të propozuara.

Mësimi 1, Prezantimi i Lëndimeve të Punëtorëve të Rinj, vlerëson njohuritë aktuale të nxënësve për sigurinë në punë dhe të drejtat ligjore. Gjithashtu thekson ndikimin që një lëndim në punë mund të ketë në jetën e një personi të ri dhe familjarizon nxënësit me idenë se lëndimet dhe sëmundjet në punë janë të parashikueshme dhe mund të parandalohen.

Mësimi 2 (dhe 2 B), Identifikimi i Rreziqeve, zhvillon të kuptuarit e rreziqeve të zakonshme të shëndetit dhe sigurisë me të cilat adoleshentët mund të përballen në punë.

Mësimi 3 (dhe 3B), Përmirësimi i Sigurisë në Punë, shpjegon masat që mund të zvogëlojnë ose të largojnë rreziqet në punë. Gjithashtu u tregon nxënësve se si të marrin më shumë informacion rreth rreziqeve të veçanta me të cilat ata mund të përballen dhe se si ti kontrollojnë ato.

Mësimi 4 (dhe 4B), Emergjencat në Punë, familjarizon nxënësit me llojet e emergjencave që mund të ndodhin në një vend pune dhe si punëdhënësit dhe punëtorët duhet të reagojnë ndaj tyre.

Mësimi 5 (dhe 5B), Të Drejtat dhe Përgjegjësitë tuaja, fokusohet në të drejtat ligjore të punëtorëve për shëndetin dhe sigurinë, në të drejtat e veçanta që gëzojnë punëtorët e rinj (nën moshën 18 vjeçare) dhe institucionet për zbatimin e ligjeve të sigurisë dhe shëndetit në punë. Këto mësim gjithashtu ndihmojnë nxënësit të kuptojnë përgjegjësitë e tyre në punë dhe masat që ata mund të ndërmarrin për të mbrojtur veten dhe të tjerët.

Mësimi 6 (dhe 6B), Ndërmarrja e Veprimit, zhvillon aftësitë e të rinjëve që të flasin në mënyrë të hapur dhe efektive në qoftë se lind një problem apo nëse ekziston ndonjë shqetësim në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë.

Metodat mësimore

Materiali përdor një shumëllojshmëri të qasjeve mësimore që të angazhoj nxënësit dhe të ofroj mundësi për nxënie aktive, përfshirë:

Ligjëratë e shkurtër

Diskutim në klasë

Stuhi mendimesh

Lojë me role

Punë në çifte

Punë në grupe

Analizë e situatave

Analizë e ilustrimeve

Raste studimore

Simulime

Aktivitete vet-vlerësuese

Mësimi 1

Lëndimet e punëtorit të ri

Ndihmon nxënësit të kuptojnë se lëndimet në punë janë të zakonshme dhe mund të ndryshojnë jetët e tyre përgjithmonë, por, gjithashtu mund të parashikohen dhe parandalohen.



RINIA  **PUNË**

Diskutim për sigurinë

Qëllimi i orës mësimore

Ndihmon nxënësit të kuptojnë se lëndimet në vendin e punës janë të zakonshme, mund të ndryshojnë jetën e tyre përgjithmonë, por gjithashtu mund të parashikohen dhe të parandalohen.

Rezultatet e të nxënit

Deri në fund të orës mësimore, nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Përshkruajnë se si lëndimet në vendin e punës mund të ndikojnë në jetën e një të riu.
- Kuptojnë raportin mes rreziqeve në punë dhe shëndetit.
- Shpjegojnë pse është e rëndësishme që ti kushtohet vëmendje sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.
- Kuptojnë se lëndimet dhe fatalitetet në vendin e punës ndodhin tek adoleshentët dhe mund t'u ndodhin edhe atyre.
- Kuptojnë se lëndimet dhe sëmundjet në punë janë të parashikueshme dhe mund të parandalohen.

Ndërlidhja me rezultatet e përgjithshme të modulit *Siguria në Punë*: 1, 2, 3, 4, Ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë-RNSh 4⁴: #1.8, #2.7, #3.4, # 3.5, # 4.1, # 5.7.

Ndërlidhja me RNF Shoqëria dhe Mjedisi: #1.2

Ndërlidhja me RNF Jeta dhe Puna: #6.4

Shënim:

- ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë dhe me RNF vlen për nivelin e mesëm të ulët-shkallën kurrikulare 4;
- për aplikimin e modulit në shkollat profesionale dhe në gjimnaze, respektivisht në nivelin e mesëm të lartë-shkallën kurrikulare 5 luteni që ndërlidhjen ta identifikoni nga Kurrikulat Bërthamë për nivelet përkatëse.

⁴ Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët

Çështjet kryesore që duhen të mirren parasysh

Në këtë modul, ne përdorim termin “lëndim” ose “incident” në vend se “aksident”.

Një “aksident” ndodh rastësisht dhe nuk mund ta parashikoni ose shmangni. Në anën tjetër, ju mund të parashikoni ose të shmangni një “lëndim” ose “incident.” Punëdhënësit duhet të ofrojnë kushte të sigurta për punëtorët, por të rinjtë gjithashtu kanë një rol të madh për të mbajtur të sigurtë veten dhe të tjerët.

Shumë të rinj besojnë se “Nëse lëndohesh në punë, është faji yt.”

Ata shpesh fajësojnë viktimën, në vend se të shohin të gjitha gjërat që mund të kenë shkaktuar lëndimin. Ky modul do tu mësojë nxënësve se si mund të ndodhin lëndimet dhe se si ndodhin ato çdo ditë tek të rinjtë - si ata.

Kur flasin për tregimet e vërteta mbi të rinjtë e lënduar ose që kanë humbur jetën në punë, nxënësit mund të gjejnë gabimet apo fajtorin

Duhet të pranojmë se këto mendime janë normale. Tregojuni atyre se mënyra më e mirë për të parandaluar lëndimet në punë është që (a) të gjenden të gjitha problemet që shkaktuan lëndimin, dhe (b) të hartohen plane për të parandaluar lëndimet, duke përfshirë shprehjen e mendimeve në mënyrë efektive.

Kur pyeten se çfarë do të bënin nëse do të lëndohen në punë, adoleshentët që mësojnë këtë material, shpesh përgjigjen “Unë do të padisë shefin tim.”

Në rast të lëndimit në punë punëtorët mund të padisin punëdhënësin në Gjykatë Themelore-Departamenti i Civil për lëndimet në vendin e punës. Përmes padisë, në pajtim me të drejtën e detyrimeve, përcaktohet shkalla e kompensimit për lëndimin në punë.

Nxënësit duhet të kuptojnë se një lëndim në punë mund të ndryshojë jetën e tyre përgjithmonë.

Përgatitja

Lexoni

Shënimet e mësimdhënësit, Materialet 1-3 në fund të këtij mësimi.

Përgatitni materialet

Një prezantim PowerPoint i sllajdeve 1-13, në një kompjuter (me projektor).

Prezantoni

Sllajdet 1–13

Merrni

Një tabelë (flipchart) dhe markera (ose përdorni një tabelë të bardhë dhe markera)

Një kompjuter me projektor ose grafoskop

Fotokopjoni

Materialin për nxënësit *Kuizi për sigurinë në punë*; nga një kopje për secilin nxënës

Plani i orës mësimore

Hapi 1

Njoftoni nxënësit me temën e sigurisë së të rinjve në punë

5 minuta

Diskutim në klasë

Hapi 2

Identifikoni njohuritë e nxënësve lidhur me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës dhe të drejtat e punëtorëve

15 minuta

Kuiz për sigurinë në vendin e punës, punë me grupe të vogla, diskutime në klasë

Hapi 3

Diskutoni rreth rreziqeve të cilat adoleshentët mund t'i hasin në vendin e punës: situata reale

20 minuta

Diskutim në klasë

Hapi 4

Njoftoni nxënësit me qëllimet e modulit “*Siguria në punë*”

5 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Udhëzime për realizimin e njësisë mësimore

Hapi 1:

Njoftoni nxënësit me temën e sigurisë së të rinjve në punë

5 min



Shfaqni sllajdin 1 në PowerPoint.


Shpjegoni se ju do tu jepni atyre një seri të orëve mësimore lidhur me sigurinë në punë.



Shfaqni sllajdin 2 në PowerPoint.

Shpjegoni se shumë adoleshentë kanë një vend pune, dhe se të gjitha llojet e punës kanë rreziqe.

Informoni nxënësit se në këtë seri të orëve mësimore ata do të mësojnë rreth temave të rëndësishme lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë.



Shfaqni sllajdin 3 në PowerPoint dhe shqyrtoni temat vijuese.

- Mënyrat se si punëtorët e rinj mund të lëndohen në punë.
- Mënyrat për të parashikuar dhe parandaluar lëndimet në punë.
- Rreziqet e zakonshme të shëndetit dhe sigurisë në punë.
- Mënyrat për të zvogëluar ose kontrolluar rreziqet në vendin e punës.
- Urgjencat në vendin e punës dhe mënyrat e reagimit.
- Çfarë duhet të bëni nëse ju shihni diçka në punë që mund t'ju lëndoj apo sëmurë.
- Çfarë të drejta dhe përgjegjësi ligjore kanë të rinjtë në punë.


Shkruani përkufizimin e fjalës “rrezik” në flipchart ose tabelë:

“Çdo gjë që mund t’iu lëndoj në punë, qoftë fizikisht ose mentalisht përbën një rrezik.”

Hapi 2:

Identifikoni njohuritë e nxënësve lidhur me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës dhe të drejtat e punëtorëve.

15 minuta



Prezantoni Kuizin Siguria në punë.

Shpjegoni nxënësve se me anë të një kuizi të shkurtër do të mësojmë se sa njohuri kanë ata lidhur me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës dhe të drejtat e punëtorëve.

Jepuni të gjithëve një kopje të Kuizit Siguria në Punë.

Ndajeni klasën në grupe të vogla prej katër deri në gjashtë nxënës.

Vizitoni çdo grup për të parë se si po punojnë.

Ktheni ata nëpër vendet e tyre pas 5 minutash.



Shfaqni sllajdin 4. Bëni pyetjen e parë.

Ftoni prezantuesin e grupit të parë. Nxënësi të lexoj pyetjen e parë, grupi të jap përgjigjen dhe ta shpjegojë atë. Lejo klasën të diskutoj shkurtimisht përgjigjen.

Klikoni tastin e majtë në mi (mouse) (ose shtypni enter, ose përdorni një telekomandë) për të treguar përgjigjen e saktë (një shenjë e kuqe do të shfaqet në hapësirën në të majtë të përgjigjes).

Thërrisni me radhë grupet e tjera, deri sa ata t'i përgjigjen të katër pyetjeve.

Shfaqni përgjigjet e sakta për secilën pyetje në sllajdet 5 dhe 6 në PowerPoint.



Shënim:

- Në Materialin 1 për mësimdhënësin në fund të këtij mësimi keni çelësin e kuizit dhe informata plotësuese për secilën pyetje; diskutoni rreth tyre.
- Tregojuni nxënësve se ata do të mësojnë më shumë për këto tema në kuadër të këtij moduli.

Hapi 3:

Diskutoni rreziqet në vendin e punës.

20 minuta



Tregoni se si lëndimet në punë mund të ndikojnë në jetën e një personi të ri. Flisni për një histori të vërtetë nga vendi juaj.

Shfaqni sllajdet 5 deri në 12 në PowerPoint.

Shënim:

- Në Materialin 2 për mësimdhënësit, në fund të këtij mësimi, keni përkshkrimin e detajuar të situatave në sllajdet 5-12.

Për çdo tregim që ju lexoni, pyesni nxënësit si më poshtë:

- “Pse mendoni se kjo ka ndodhur?”
- “Çfarë ka mund të parandaloj këtë person nga lëndimi?”
- “Si ndikojnë këto situata në jetën e përditshme të adoleshentëve?”

Regjistroni përgjigjet e tyre në tabelë ose dërrasë të zezë. Ju nuk keni nevojë të diskutoni përgjigjet tani. Tregojuni nxënësve se ata do të mësojnë më shumë rreth këtyre çështjeve gjatë orëve vijuese mësimore.

Tregoni klasës se punëtorët e rinj janë të prirur dy herë më shumë se të rriturit për tu lënduar në punë.

Kërkojuni nxënësve stuhi idesh për një listë të vendeve të punës tipike për adoleshentë.

Vendosni vendet tipike të punës, të identifikuar nga nxënësit, në kategori të saktë të industrive. Për shembull, një punëtor në restorante të ushqimit të shpejtë (fastfood) është pjesë e sektorit Koha e lirë dhe Mikpritja. Për më tepër, shih Materialin Nr. 3 për mësimdhënësit, në fund të këtij mësimi.

Hapi 4:

Njoftoni nxënësit me objektivat e modulit Siguria në punë

5 minuta

U thoni nxënësve se këto mësimet do t'i ndihmojnë ata të jenë larg statistikave të lëndimit. Ata do të mësojnë në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës, si dhe të drejtat e punëtorëve adoleshentë në punë.

Tregojuni nxënësve se ata do të përgatisin harta që tregojnë rreziqet në vendin e punës, të luajnë në role, dhe të luajnë lojëra.



Shfaqni sllajdin 13 në PowerPoint.

Shqyrtoni shtatë pikat e paraqitura aty.

Deri në fund të kursit, nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin rreziqet e vendeve të punës dhe t'i adresojnë ato
- Njohin ligjet që mbrojnë adoleshentët nga orët e gjata të punës dhe nga puna në orët e vona
- Njohin ligjet që mbrojnë adoleshentët nga punët e rrezikshme
- Njohin ligjet që mbrojnë adoleshentët nga diskriminimi dhe ngacmimet
- Vendosin si të zgjidhin problemet e shëndetit dhe sigurisë në punë
- Përmendin disa nga agjencitë që zbatojnë ligjet e shëndetit dhe sigurisë dhe ligjet mbi punën e fëmijëve
- Vendosin se çfarë të bëjnë në rast emergjence

Përfundoni Mësimin 1 duke lexuar këtë tekst:

Adoleshentët kanë më shumë gjasa se çdo grup-moshë tjetër për tu lënduar apo për të humbur jetën në punë.

Ju mund - dhe duhet - të mësoni për rreziqet dhe rrezikshmërinë në punë dhe të merrni masa për të mbrojtur veten dhe të tjerët. Lëndimet nuk janë aksidente. Lëndimet në vendin e punës mund të menagjohen dhe parandalohen.

Në mësimin tjetër, ju do të mësoni t'i gjeni rreziqet në disa vende tipike të punës.

Detyra e shtëpisë

Caktoni detyrë nxënësve t'i gjejnë tri ligje që ndërlidhen me punën e adoleshentëve në shtetin tuaj. I thuani atyre t'i dërgojnë këto me e-mail para orës së ardhshme, ose ti shkruajnë ato dhe t'i dorëzojnë në fillim të orës së ardhshme.

Kuizi Siguria në punë - Përgjigjet dhe çështjet për diskutim

1

Ligji thotë se punëdhënësi juaj duhet t'iu ofroj një vend të sigurt dhe të shëndetshëm për të punuar.

E saktë.

Kjo mund të përfshijë aftësimin tuaj se si të bëni punën tuaj në mënyrë të sigurt. Inspektorati i Punës siguron që punëdhënësit të ndjekin ligjet për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës, dhe mund të detyroj punëdhënësin tuaj, t'iu aftësoj në lidhje me rreziqet që i ka vendi ku ju punoni.

2

Ligji kufizon se deri në çfarë ore mund të punoni në një ditë shkollore në goftë se jeni nën moshën 18 vjeç.

E saktë.

Ligji i Punës dhe UA 01/2012 për Sistemimin e Punëve të Lehta dhe të Ndaluar për Personat nën moshën 18 vjeçare ndalon punën e të rinjëve gjatë natës, dhe atë prej orës 22 të natës deri në ora 6 të mëngjesit. Orari i punës për personat nën moshën 18 vjeçare nuk duhet të intereferoj me vijimin e shkollës. Orari i plotë i punës për të punësuarin, i cili është më i ri se tetëmbëdhjetë (18) vjeç, nuk mund të jetë më shumë se tridhjetë (30) orë në javë.

3

Nëse jeni 16 vjeç, ju mund të vozitni një makinë në rrugët publike, si pjesë e punës tuaj.

E pasaktë.

Adoleshentët të cilët janë 16 vjeç nuk mund të vozitin një makinë, traktor apo mjet tjetër me veprim motorik në rrugët publike si pjesë e punës së tyre. Moshë e lejuar për vozitjen e mjeteve me veprim motorik është 18 vjeç.

4

Nëse ju lëndoheni në punë, punëdhënësi juaj duhet të paguaj për kujdesin mjekësor.

E saktë.

Nëse ju lëndoheni në punë, ligji thotë se punëdhënësi juaj duhet të ofroj kompensimin e dëmshpërblimit për punëtorët. Kjo përfshin kujdesin mjekësor për lëndimet tuaja.

Materiali 2 për mësimdhënësin

Udhëzime për interpretimin e sllajdeve 5-12

Ngjarje të vërteta kur adoleshentët janë lënduar ose kanë humbur jetën në punë⁵



Sllajdi 5 në PowerPoint

Xheku ka punuar në kuzhinën e një restoranti të ushqimit të shpejtë gjatë mbrëmjeve (pas shkollës) dhe në fundjavë. Një të premte pasdite, Xheku duhej të punonte në fritezë. Në një moment, Xheku po ecte nëpër dysheme dhe mbante një shportë me patate të skuqura. Ai nuk e pa një vend të rrëshqitshëm mbi pllaka dhe rrëshqiti e u rrëzua. Ai ra në shtyllën kurrizore dhe u lëndua shumë. Xheku ka dhimbje që nuk i pushojnë dhe ai ka vështirësi të qëndroj në këmbë dhe ulur.



Sllajdi 6 në PowerPoint

Antonio, 17 vjeçar, ka punuar për një ndërtimtar në lagje. Një ditë ai bartte një trung 3.6 metra të gjatë në katin e sipërm të një shtëpie të papërfunduar. Ai u mbështetet në një oxhak të parrethuar dhe ra nga lartësia prej 8.5 metra në dyshemenë prej betoni në bodrum. Ai mbijetoi, por ka plasaritur tri kocka në shpinë. Lëndimi e detyroi të kalojë 3 muaj në një protezë nga qafa deri në ije. Për shkak të moshës së tij, ai nuk është dashur ta bëjë këtë punë të rrezikshme⁶.

⁵ Të gjitha ngjarjet janë të bazuara në lëndime të cilat kanë ndodhur në të vërtetë në SHBA prandaj edhe kemi vendosur që të mos i ndryshojmë emrat e fëmijëve. Gjithsesi, mësimdhënësi ka lirinë që këto ngjarje t'i përshtas apo të referohet në raste konkrete për të cilat mund të ketë informacion.

⁶ Ligji i Punës, respektivisht Udhëzimi Administrativ 01/2012 mbi Sistemimin e punëvetë lejuara dhe të ndaluara për personat 15-18 vjeç si dhe UA 05/2013 mbi Prandalimin dhe Eliminimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve, ndalon të rinjtë nën moshën 18 vjeç të punojnë në lartësi mbi 2 m



Sllajdi 7 në PowerPoint

Anxhela, 16 vjeçare, ka kryer shumë detyra të shtëpisë në kompjuter dhe ka dërguar e-maile dhe mesazhe tek miqtë e saj çdo ditë. Ajo gjithashtu ka punuar 3 orë në ditë pas shkollës duke shkruar të dhëna për një kompani të marketingut. Anxhela është paguar sipas “sasisë së kryer të punës”, respektivisht me normë. Kjo do të thotë që ajo është paguar për punën që e ka bërë dhe jo për kohën që ka kaluar duke e bërë atë. Ajo kurrë nuk ka bërë pushim. Ajo filloi të ndjejë mpirje të gishtave dhe një mëngjes u zgjua me një ndjenjë djegie në kyçin e dorës. Mjeku i Anxhelës tha se ajo kishte lëndim të rëndë si pasojë e lëvizjeve të përsëritura. Kjo ndodh kur ju shkruani në një pozitë të vështirë, pa pushim. Lëvizja dëmton muskujt, ligamentet dhe nervat. Tani ajo duhet të mbaj proteza në kyçet e duarve dhe nuk mund të punojë në kompjuter për më shumë se 15 minuta në një interval. Shkolla e mesme e Anxhelës ka caktuar dikë të marrë shënime për të në klasë.



Sllajdi 8 në PowerPoint

Terrelli ishte një djalë 15-vjeçar kur ai shkoi në Maryland me familjen e tij dhe gjeti punë në një kompani për mirëmbajtjen e parqeve. Pas vetëm një jave në punë, atij i është kërkuar që të ndihmoj në prerjen e degëve të pemëve, duke përdorur një prerëse motorike druri. Ndërsa po priste degët, Terrell u ngatërrua në disa degë të mëdha, makina e tërhoqi atë dhe e mbyti. Një kolegë gjeti trupin e tij më pas. Ai nuk duhej ta kryente këtë punë për shkak të moshës së tij.



Sllajdi 9 në PowerPoint

Kodi, 16 vjeçar, ka punuar në fermën e familjes së tij gjatë verës. Një ditë Kodi ngiste një traktor poshtë një rruge të ngushtë me zhavorr. Traktori nuk kishte rrip të sigurisë apo gyp mbrojtës. Ai ngiste shumë afër skajit të djathtë të rrugës dhe shkoi drejt një kanali. Kjo bëri që traktori të rrokulliset. Kur Kodi pa se çfarë po ndodh, ai u përpoq të hidhet, por çizmja e tij u kap midis ulëses dhe parafangos. Goma e majtë e traktorit e grimcoi këmbën e Kodit, duke e lënë atë të paralizuar nga beli e poshtë⁷. Për shkak të moshës së tij ai nuk do të duhej të voziste traktor.

⁷ Këto raste tregojnë se shumë të rinj punojnë në mënyrë jo-formale në fermat familjare. UA 05/2013 ndalon punën e personave në moshën 18 vjeçare me makineri bujqësore



Sllajdi 10 në PowerPoint

Linsi, një nxënëse e vitit të dytë në shkollën e mesme, ka punuar në banak në një piceri të vogël, pas shkollës dhe në fundjavë. Te premten gjatë natës, ajo ka punuar vetëm me Brejdën, një nxënës i vitit të katërt në shkollën e saj. Brejdëni ishte shpesh i vrazhdë me Linsin dhe ai madje e ngacmonte atë edhe para klientëve. Atë natë, Linsi foli me Brejdën dhe i kërkoi që të mos e ngacmoj më. Ajo i tha se do t'i tregonte shefit të tyre. Brejdëni i bërtiti Linsit dhe e shtyu. Linsi ra dhe goditi kokën në një tavolinë aty pranë. Linsi arriti që të ngrihet dhe të vrapoj jashtë. Ajo shpejt thirri ndihmën e shpejtë nga telefoni i saj celular. Kur Policia arriti në vendngjarje e arrestoi Brejdënin. Linsi kishte një gungë në kokë dhe shumë të nxira tjera. Ajo ende qan shumë dhe ndjehet e trishtuar. Nganjëherë nuk mund të flejë për shkak të asaj që i ndodhi.



Sllajdi 11 në PowerPoint

Ana, 15 vjeçare, ka punuar në një dyqan të ëmbëlsirave dhe lëngjeve. Një ditë, menaxheri i saj 34-vjeçar, Deni, filloi të bëjë komente të papërshtatshme në lidhje me trupin e Anës, para punonjësve të tjerë. Deni gjithashtu përdori një gjuhë fyese për të dhe tregoi disa shaka të pista. Edhe pse sjellja e Denit e bëri Anën të ndihet keq, Ana vuri re se asnjërit prej kolegëve të saj nuk i pengonte kjo. Si rezultat, Deni filloi edhe ta prek Anën kur ai ecte pranë saj ose i hidhte krahun në qafë apo bel. Një natë, Deni e ftoi Anën në shtëpinë e tij për darkë. Kur ajo nuk pranoi, Deni u zemërua, duke e akuzuar Anën se e ka provokuar. Ditën tjetër, Ana dëgjoi se ajo u largua nga puna e saj për “performancë të dobët.” Ana u ndje e hutuar dhe e mërzhitur. Ajo fajësoi veten për atë që ndodhi.



Sllajdi 12 në PowerPoint

Logan, një 14-vjeçar, nxënës i vitit të parë të shkollës së mesme, ka punuar gjatë verës në qumështoren e gjyshit tij. Ai shpesh shfrytëzonte një traktor për të tërhequr rimorkion e ushqimit të lopëve, e cila kishte një vidhë rrotulluese të madhe për përzierjen e ushqimit. Vidha ishte e lidhur me një shufër metalike në një burim energjie, në pjesën e pasme të traktorit. Shufra rrotullohej me shpejtësi midis traktorit dhe rimorkios dhe nuk kishte mbrojtëse. Një ditë, Logan vuri re një problem në rimorkio. Ai e la traktorin të ndezur dhe u afrua për të parë nga afër. Kur Logani arriti pranë shufrës, iu kap mënga e këmishës. I gjithë trupi i Loganit me shpejtësi përfundoi rreth boshtit të fuqishëm që rrotullohej. Një tjetër punonjës i qumështores e pa se çka ndodhi dhe nxitoi për të ndihmuar. Deri në kohën kur erdhi ambulanca, Logani i kishte humbur ndjenjat. Ai u zgjua në spital dhe mori vesh se kishte thyer qafën dhe se krahun e djathtë e kishte këputur.

Materiali 3 për mësimdhënësin

Kategoritë e industrive për punët tipike të adoleshentëve

Shënim: për Listën e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë konsultoni Udhëzimin Administrativ 05/2013 të Qeverisë

Më poshtë është një tabelë për strukturimin e përgjigjeve të nxënësve në lidhje me punët tipike që kryhen nga adoleshentët

| Industria | Disa punë tipike të adoleshentëve |
|--|--|
| Kohë e lirë dhe mikpritja | Kamerier, nikoqir, punëtor në restorante, pjt-alarës, banakier, punëtor i parqeve argëtuese, punëtor i fushave sportive, aktor, performues |
| Shitje me pakicë | Shitës, rregullues i raftëve në dyqan ushqimësh, shitës në dyqan për rroba/bizhuteri/lodra/mallra sportive |
| Shërbime të tjera | Punëtor në autolarje, kujdestar për kafshë shtëpiake/për të shëtitur qentë, kujdestar në parking, pastrues, kujdestar pishine |
| Prodhimtari, Ndërtimtari, Transport | Gërmimi i dheut, sitja e rërës dhe çimentos, bartja e peshave të rënda, puna në skela, përpunimi i metaleve |
| Bujqësi dhe pylltari | Operim me makineri bujqësore, punë me pesticide, punë të rënda fizike në fusha, prerja e drunjëve, përpunimi i drurit, vjelja e pemëve, korrës i lëndinave |

Mësimi 2

Identifikimi i rreziqeve

Ndihmon nxënësit të identifikojnë një shumëllojshmëri të rreziqeve të shëndetit dhe sigurisë në vendet tipike ku punojnë të rinjtë.



RINIA  **PUNË**

Diskutim për sigurinë

Qëllimi i orës mësimore

Ndihmon nxënësit të identifikojnë rreziqet për shëndetin dhe sigurinë në vendet tipike ku punojnë të rinjtë.

Rezultatet e pritura

Deri në fund të orës mësimore, nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin rreziqet që ekzistojnë në vendet e punës dhe të parashikojnë dëmin që ato mund të shkaktojnë
- Kuptojnë dallimet mes kategorive të ndryshme (llojeve) të rreziqeve në punë
- Identifikojnë mënyrat për t'u informuar në lidhje me kimikatet e përdorura në punë
- Kuptojnë se disa rreziqe në punë janë të dukshme ndërsa disa jo
- Ndërtojnë një hartë të detajuar të rreziqeve për një vend pune të imagjinuar ose vizualisht identifikojnë rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në një hartë të rreziqeve
- Ndajnë rreziqet sipas kategorive
- Analizojnë dhe rendisin rreziqet në lidhje me (1) dëmin/lëndimin e mundshëm dhe (2) shkallën e lëndimit

Ndërlidhja me rezultatet e përgjithshme të modulit Siguria në Punë: 2, 3, 7

Ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë-RNSH 48: # I.1, # I.2, # I.7, #I.8, # II.1, #II.2, #II.7, #III.1, #III.4, #III.5, #IV.6, #V.5, #V.6, #VI.3

Ndërlidhja me RNF Gjuhët dhe komunikimi: # 1.1.2, # 3.1

Ndërlidhja me RNF Shoqëria dhe Mjedisi: #1.1

Ndërlidhja me RNF Shëndeti dhe mirëqenia: #1.1

Ndërlidhja me RNF Jeta dhe Puna: #6.4 (1), #8.4 (1)

Shënim:

- ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë dhe me RNF vlen për nivelin e mesëm të ulët-shkallën kurrikulare 4;
- për aplikimin e modulit në shkollat profesionale dhe në gjimnaze, respektivisht në nivelin e mesëm të lartë-shkallën kurrikulare 5 luteni që ndërlidhjen ta identifikoni nga Kurrikulat Bërthamë për nivelet përkatëse.

⁸ Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët

Çështjet kryesore që duhen të mirren parasysh

Disa rreziqe të punës me të cilat përballen adoleshentët janë më të dukshme se të tjerat

Nxënësit tuaj duhet të dijnë se si të identifikojnë llojet e ndryshme të rreziqeve në vende të ndryshme të punës. Kjo do t'u ndihmojë atyre të mbrohen më mirë nga lëndimet e mundshme në çdo punë.

Adoleshentët duhet të kuptojnë mundësinë e rrezikshmërisë (sa janë gjasat që kjo të më lëndoj mua) dhe shkallën e rrezikshmërisë (nëse kjo më lëndon, sa keq mund të jetë?)

Njohuria rreth këtyre koncepteve i bën ata më të vëmendshëm ndaj rreziqeve në vendin e punës.

Shumë vende të punës bartin rreziqe që mund të identifikohen dhe të korrigjohen

Nxënësit duhet të jenë të vetëdijshëm për rreziqet në punë. Në këtë mënyrë ata të mund të njohin problemet e mundshme shëndetësore dhe të sigurisë. Duke njohur këto probleme, lëndimet dhe sëmundjet në punë mund të parashikohen dhe të parandalohen.

Në aktivitetin e *identifikimit të rreziqeve* në këtë mësim, nxënësit shpesh përmendin rëndësinë e sigurisë së konsumatorëve, sidomos në sektorin e hotelerisë.

Edhe pse siguria e konsumatorit është e rëndësishme, ky mësim - dhe kjo kurrikulë fokusohen në sigurinë dhe shëndetin e punëtorit.

Përgatitja

Lexoni

Sllajdet 14-22 dhe Udhëzimet për interpretimin e sllajdeve (Materiali 4 për mësimdhënësin).

Përgatitni materialet

Një prezantim i sllajdave 14-22 në PowerPoint në një kompjuter (me projektor)

Prezantoni

Sllajdet 14-22 në PowerPoint

Merrni

Një flipchart dhe markera (ose përdorni një tabelë të bardhë dhe markera)

Një komplet të markerave me ngjyrë ose lapsa (të zi, të kuq, të gjelbër, kalter, portokalli) për çdo grup të vogël me 3-4 studentë (aktiviteti i hartëzimit të rreziqeve)

Përzgjidhni

Një nga katër fotot e Identifikimit të Rreziqeve (Materiali 2-5 i nxënësit) për aktivitetin që do të zhvilloni gjatë orës mësimore.

Fotokopjoni

Fotografinë e Identifikimit të rreziqeve që keni zgjedhur (Materiali 2-5 i nxënësit) Jepni nga një kopje secilit nxënës. Fletë për përgjigje, nga një kopje për çdo nxënës (Materiali 6 i nxënësit).

Plani i orës mësimore

Hapi 1

Përkufizoni termin “rreziku në punë.”

10 minuta

Stuhi idesh, diskutime në klasë

Hapi 2

Identifikoni rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në vende tipike ku punojnë adoleshentët.

10 minuta

Aktiviteti *Identifikimi i rreziqeve*, diskutime në klasë

Hapi 3

Shqyrtoni rreziqet në një vend tipik pune të adoleshentëve.

20 minuta

Aktiviteti *Hartëzimi i rreziqeve**, puna në grupe të vogla, diskutime në klasë

* Për nxënësit me aftësi të kufizuara njohëse (kognitive) apo zotërim të kufizuar të gjuhës amtare, ju mund të vazhdoni me aktivitetin *Identifikimi i rreziqeve* në vend se të përdorni aktivitetin *Hartëzimi i rreziqeve*.

Hapi 4

Shqyrtoni dhe përmbledhni pikat kryesore të mësimi.

5 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Udhëzime për realizimin e njësisë mësimore

Hapi 1:

Përkufizoni termin “rreziku në punë.”

10 minuta



Filloni mësimin duke shfaqur sllajdin 14 në PowerPoint.

Rikujtoni klasën se një rrezik në punë është çdo gjë që mund të ju lëndoj, qoftë fizikisht apo mentalisht.

Shpjegoni se disa nga reziqet e punës janë të dukshme, por disa jo. Në mënyrë që të përgatiten më mirë për të qenë të sigurt në punë, është e nevojshme të kuptojnë se si të identifikojnë llojet e ndryshme të reziqeve.



Shfaqni sllajdet 15 dhe 16 në PowerPoint.

Informoni klasën se reziqet mund të ndahen në katër kategori. Shkruani këto si tituj në kolona në një faqe të flipchartit apo në tabelë.



Shpjegoni:

Rreziqet e sigurisë, si sipërfaqe të nxehta apo dysheme të rrëshqitshme, mund të shkaktojnë aksidente dhe lëndime të menjëhershme.

Rreziqet kimike, si gazra, avuj, lëngje apo pluhur mund t'i shkaktojnë **dëm trupit tuaj**. Këtu hyjnë edhe produktet për pastrim dhe pesticidet.

Rreziqet biologjike, të cilat janë qeniet e gjalla që mund të shkaktojnë grip, HIV/AIDS, hepatit, sëmundje nga rriqrat, tuberkuloz (TB) etj. Shembujt përfshijnë bakteriet, viruset dhe mykun. Në vendin e punës, ju mund të ekspozoheni përmes kontaktit me gjilpëra të përdorura, fëmijë të sëmurë apo kafshë të sëmura.

Rreziqe tjera shëndetësore, zakonisht janë **më pak të dukshme, sepse ato nuk ju shkaktojnë probleme shëndetësore të menjëhershme. Për shembull, zhurmat dhe lëvizjet e përsëritura.**

Kërkoni nga nxënësit të mendojnë për vende në të cilat kanë punuar apo vende të njohura të punës

Kërkoni nga nxënësit t'i përmendin rreziqet e mundshme të vendeve të punës dhe të tregojnë për secilin prej tyre nëse paraqet një rrezik të sigurisë, rrezik kimik, rrezik biologjik apo rreziqe tjera shëndetësore.

Rendisni çdo rrezik në kolonën e duhur nën titujt që keni shkruar me herët, për të krijuar një tabelë.

Tabela juaj mund të jetë e ngjashme me tabelën e mëposhtme. Nxënësit mund t'i ngatërrojnë efektet e rreziqeve me vetë rreziqet p.sh. ata mund t'i përmendin “prerjet” (që në fakt është efekti i rrezikut) në vend të thikave (rrezikut real), të cilat shkaktojnë prerjet. Në tabelë shënohen vetëm shkaqet, respektivisht rreziqet dhe jo efektet e tyre. Nëse nxënësit shënojnë efektet në vend të shkaqeve, pyesni ata se çfarë e shkakton këtë efekt që ata e përmendin. Kjo do t'i ndihmojë më vonë kur nxënësit të diskutojnë se si të eliminojnë ato rreziqe.

| Rreziqet e Sigurisë | Rreziqet⁹ Kimike | Rreziqet¹⁰ Biologjike | Rreziqe të tjera shëndetësore |
|--|------------------------------------|---|--------------------------------------|
| Sipërfaqe të nxehta | Produkte për pastrim | Viruset | Zhurmat |
| Dysheme të rrëshqitshme | Pesticidet | Bakteret | Dridhjet |
| Shkallë | Tretësit | Myku | Rrezatimi |
| Makineri | Acidet | Sëmundjet e kafshëve | Nxehtësia ose të ftohtit |
| Thika të mprehta | Azbesti | Sëmundjet e zogjve | Lëvizjet e përsëritura |
| Yndyra të nxehta | Plumbi | Sëmundjet e insekteve | Qëndrim i papërshtatshëm |
| Qarku elektrik jo i sigurt | Pluhur druri | Gjilpëra të përdorura | Ngarkesa të rënda |
| Mungesa e daljeve në rast zjarri | Mërkuri | | Rtëm i shpejtë i punës |
| Mjetet motorike | Cilësia e dobët e ajrit | | Diskriminim/ngacmim |
| Zonat e rrëmujshme të punës | Benzinë | | Stres |
| Objektet që bien | Produkte për pastrim | | |
| Dhuna | | | |
| Zonat shumë të errëta ose shumë të ndriçuara | | | |

⁹ Lista e agjencive kimik dhe biologjik të cilave nuk guxon t'u ekspozohen personat nën moshën 18 vjeçare është pjesë e UA 05/2013 për Listën e Formave të Rrezikshme të Punës si dhe UA 01/2012

¹⁰ Si më lart

Diskutoni më shumë për kimikatet. Nxitni diskutimin përmes pyetjeve të mëposhtme:

Pyetje: “Si mund të depërtojnë kimikatet në trupin tuaj? “

Përgjigja: Me anë të frymëmarrjes, gëlltitjes apo lëkurës.

Pyetje: “Si mund t’iu dëmtojnë kimikatet?”

Përgjigja: Kimikatet mund të shkaktojnë simptoma të ndryshme si skuqje e lëkurës dhe iritim, marramendje dhe probleme të frymëmarrjes. Ato gjithashtu mund të kenë efekte shëndetësore si djegie, mund të rrisin gjasat për sëmundje të rënda si kanceri, apo mund të shkaktojnë mosfunksionim e organeve vitale siç është mëlçia. Disa kimikate mund të shkaktojnë simptome të menjëhershme dhe disa të tjera mund të shkaktojnë probleme shëndetësore që shfaqen më vonë në jetë. Kjo është veçanërisht e mundshme nëse kimikatet e caktuara përdoren për një kohë të gjatë.

Pyetje: “Si mund të informoheni për dëmet që mund t’iu shkaktoj një produkt kimik dhe masat e mbrojtjes?”

Përgjigja: Kur të përdorni një produkt që përmban kimikate (si solucionet për pastrim apo pesticidet), është e rëndësishme të dini se çfarë efektesh shëndetësore mund të shkaktojë produkti dhe si mund të mbronni veten. Nëse ju keni astmë ose ndonjë problem tjetër shëndetësor, ky informacion mund të jetë edhe më i rëndësishëm.

Për tu informuar rreth kimikateve në një produkt, ju duhet të:

- Kontrolloni etiketën
- Pyesni mbikqyrësin tuaj
- Trajtohuni për përdorimin e sigurtë të kemikatit përkatës
- Thërrisni në telefon prodhuesin ose vizitoni uebfaqen e tij
- Lexoni Fletën e të Dhënave për Sigurinë e produktit.

Shpjegoni klasës se Të Dhënat për Sigurinë e Produktit janë fletët e informacionit që prodhuesit duhet t'i dërgojnë tek kompanitë së bashku me produktet e tyre kimike. Ato ju tregojnë se çfarë përmban produkti, si mund t'iu dëmtojë dhe si të mbroheni nga dëmi që mund të shkaktoj.

Të Dhënat për Sigurinë e Produktit nuk janë të destinuara për konsumatorët. Ato përfshijnë rreziqet e punës me materialin/produktin në një vend pune. Për shembull, informacioni për një ngjyrë nuk është aq i rëndësishëm për dikë që e përdor një kuti ngjyre një herë në vit, por është shumë i rëndësishëm për dikë që lyen në një hapësirë të mbyllur për 40 orë në javë. Formatet e të dhënave mund të ndryshojnë, por ato zakonisht përmbajnë të njëjtin lloj të informacionit themelor.

Pyetni klasën:

“Për kë janë Të Dhënat për Sigurinë e Produktit”

Dëgjoni përgjigjet e nxënësve. Sigurohuni që konkluzionet e diskutimeve të përfshijnë si vijon:

- Për punonjësit të cilët janë të ekspozuar ndaj këtyre kimikateve në mënyrë të vazhdueshme.
- Për punëdhënësit të cilët duhet të jenë të informuar për ruajtjen dhe përdorimin e kimikateve të rrezikshme.
- Për ata të cilët përgjigjen ndaj rasteve emergjente siç janë: zjarrfikësit, skuadra për trajtimin e materialeve të rrezikshme, teknikët e emergjencës mjekësore dhe personeli i trajtimit mjekësor emergjent.

Hapi 2:

Identifikoni rreziqet për shëndetin dhe sigurinë në disa vende tipike të punës - aktiviteti Identifikimi i rreziqeve

10 minuta



Shpërndani materialet. Paraqitni foton e përzgjedhur për *Identifikimin e rreziqeve (Materialet 2-5 të nxënësve)*. Jepni nxënësve një marker me ngjyrë dhe stilolaps. Do të keni kohë të kompletoni vetëm një foto.

Shpjegoni aktivitetin. Nxënësit duhet të shikojnë vendin e punës të prezantuar në material. Ata duhet të përpiqen të identifikojnë dhe të rrethojnë sa më shumë rreziqe të sigurisë ose shëndetit.

Jepuni nxënësve disa minuta për të identifikuar rreziqet në foto.



Shfaqni sllajdet 17-20 në PowerPoint, të cilat korrespondojnë me fotot që nxënësit i kanë parë në materialet e tyre.

Kërkoni nga nxënësit vullnetar t'i prezantojnë rreziqet e identifikuar.

Listoni rreziqet në dërrasë të zezë ose në tabelë.

Pyetni nxënësit tjerë nëse ata kanë identifikuar rreziqe tjera, të cilat vullnetaret nuk i kanë vënë re.

Pyetni nxënësit edhe për rreziqet potenciale në vendin e punës- rreziqe që nuk janë të dukshme.

Gjatë kohës që nxënësit përgjigjen, shtoni këto rreziqe në listë. Nëse klasa harron ndonjë rrezik, plotësojeni ju.


Shënim:

- Materiali 4 për mësimdhënësit (në fund të këtij mësimi), përmban listën e rreziqeve të mundshme për secilin nga katër vendet e përshkruara të punës...ajo do të ju ndihmojë të udhëhiqni diskutimin me nxënësit dhe të plotësoni informacionet/përgjigjet e tyre. Përndryshe, ju mund të zgjidhni edhe vende të tjera të punës, relevante për programin tuaj apo për nxënësit tuaj.

Hapi 3:

Identifikoni rreziqet në një vend tipik pune për adoleshentët- aktiviteti Hartëzimi i Rreziqeve

20 minuta



Shfaqni sllajdin 21 në PowerPoint

Ndajeni klasën në grupe nga tre apo katër nxënës. Grupet do të punojnë për të formuar hartat e rrezikut. Secili grup do të zgjedhë ose do t'i caktohet një profesion. Ata do të shënojnë vendndodhjen dhe llojin e rreziqeve që ndodhen në atë vend pune. Ju dhe nxënësit tuaj mund të zgjidhni vendet ku të rinjtë punojnë më së shpeshti, siç është restoranti i ushqimit të shpejtë, dyqane ushqimore, aktivitete bujqësore, zyra, pikat e karburantit, pishina dhe kafene.

Caktoni apo kërkoni nga grupet që të zgjedhin vendin e punës që ata do të analizojnë

Jepini çdo grupi një fletë të madhe të flipchartit dhe pesë markera me ngjyra të ndryshme (e zezë, e kuqe, e gjelbër, portokalli, e kaltër).

Shpjegoni se grupet duhet të përgatisin planet e tyre të hapësirës së punës me një marker të zi. Plani duhet të tregojë hapësirën, zonat e punës, inventarin, pajisjet, detyrat e ndryshme të punës, dyert dhe dritaret. Shpjegoni se plani mund të jetë shumë i thjeshtë.

Kërkoni çdo grupi të shënoj vendndodhjen e rreziqeve të ndryshme në planet e tyre të hapësirës së punës.

Përdorimi i kodit të mëposhtëm të ngjyrave mund të ndihmojë në përforcimin e kategorive të rreziqeve. Nuk është e nevojshme të aplikohet kodi i ngjyrave për kategoritë në qoftë se duket shumë e komplikuar. Sllajdi 27 jep një shembull të një harte të përfunduar.

- Ngjyra e kuqe tregon rreziqet e sigurisë
- Ngjyra e gjelbër tregon rreziqet kimike
- Ngjyrë portokalli tregon rreziqet biologjike
- Ngjyra e kaltër tregon rreziqet tjera shëndetësore

Kërkoni nga grupet të tregojnë nivelin e rrezikshmërisë për çdo rrezik.

Ata mund të nxjerrin në pah rreziqet që i konsiderojnë veçanërisht të larta ose serioze duke i ngjyrosur ato ose duke i shënuar me një simbol.

Çdo grup duhet të zgjedh një prezantues.

Prezantuesit duhet të përgatiten për të prezantuar hartën dhe për t'i shpjeguar klasës se cilat janë rreziqet kryesore në këtë vend të punës.

Përgjigjuni ndonjë pyetjeje dhe lejoni të fillojnë grupet.

Gjatë punës së grupeve, bëni pyetje dhe ofroni sugjerime të përshtatshme. Sfidoni nxënësit që të mendojnë përtej rreziqeve të dukshme. Pas 10 minutash, bashkoni klasën.


Çdo prezantues le të prezantoj hartën e grupit, duke përfshirë edhe atë se çka shohin ata si rrezik më serioz në secilën kategori (e kuqe, e gjelbër, portokalli, kaltër).

Plotësoni tabelën e krijuar gjatë Hyrjes (në fillim të orës mësimore) me rreziqet e reja që përmenden nga nxënësit.

Hapi 4:

Përsëritja e pikave kryesore të mësimit

5 minuta



Shfaqni sllajdin 22 në PowerPoint.

Përsëritni pikat kryesore të mbuluara në këtë mësim:

- Çdo punë ka rreziqet e shëndetit dhe sigurisë.
- Ju duhet të jeni gjithmonë të vetëdijshëm për këto rreziqe.
- Ju mund të informoheni më shumë rreth kimikateve të përdorura në punë duke kontrolluar etiketat, duke lexuar Të dhënat për Sigurinë e Produktit dhe duke u trajnuar. Punëdhënësi juaj duhet t'ju përgatis që të punoni në mënyrë të sigurtë me kimikate.

Përfundoni orën mësimore duke lexuar këtë mesazh:

“Një rrezik në punë paraqet çdo gjë që mund t’iu lëndoj në punë, qoftë fizikisht ose mentalisht. Disa rreziqe të vendeve të punës janë shumë të dukshme, por disa jo. Për të qenë të sigurt në punë, ju duhet të jeni në gjendje t’i identifikoni llojet e ndryshme të rreziqeve.”

Nëse anashkaloni mësimin 2B:

“Në mësimin e ardhshëm, ne do të mësojmë mënyra për të zvogëluar apo eliminuar rreziqet në punë.”

Detyrë shtëpie

Jepuni nxënësve kopjet e tre fotove të *Identifikimit të Rreziqeve* (materialet e nxënësve 2-5) të cilat nuk i keni përdorur në klasë. Kërkoni nga nxënësit t’i marrin ato në shtëpi dhe t’i rrethojnë rreziqet në çdo foto (duke ndjekur modelin e ngjyrave që ju e përdorët në klasë). Nxënësit duhet të mendojnë për rreziqet që ata kanë identifikuar në çdo skenë dhe për dëmet që mund t’i shkaktojnë ato rreziqe.

Kërkoni nga nxënësit të zgjedhin një foto që ata mund t’a përdorin për të krijuar një fushatë të sigurisë për punëtorët e rinj. Ata mund të përgatisin një poster për të paralajmëruar adoleshentët e punësuar mbi rreziqet e mundshme në vendet e punës (në atë lokacion). Si një alternativë, nxënësit mund të krijojnë një poemë, rast studimor ose aktivitete tjera që ata i gjykojnë si të rëndësishme për të avokuar për vende të sigurta të punës për të rinjtë. Kushtoni disa minuta në fillim të orës së ardhshme mësimore (nëse ju zhvilloni mësimin 2B) që të prezantoni një ose dy nga detyrat kreative.

Materiali 4 për mësimdhënësin

Identifikimi i rreziqeve

Më poshtë paraqiten listat e rreziqeve në vendet e punës (interpretimi i sllajdeve 17-20):

Restoranti i ushqimit të shpejtë



Të dukshme:

Skara ose furra e nxehtë
Avulli
Zjarri
Ushqimi ose lëngje të nxehta
Yndyra e nxehtë
Thikat
Ngarkesat e rënda
Dyshemeja e rrëshqitshme
Kimikate për pastrim
Presioni për të punuar shpejt
Zhurmat
Lëvizjet e përsëritura
Klientë të nervozuar
(dhunë potenciale, abuzim)

Jo të dukshme:

Stresi
Rreziku nga elektriciteti
Ngacmimi seksual Rreziqet biologjike (viruse, baktere, myku) Vjedhjet/dhuna

Dyqan ushqimor



Të dukshme:

Ngarkesa të rënda
Brisku
Makina grirëse e mishit
Kimikate për pastrim/kimikate të pashënuara
Lëvizje e përsëritur
Përkulje ose zgjatje
Qëndrimi i gjatë në këmbë
Stresi

Jo të dukshme:

Ngacmimi seksual
Rreziqet biologjike (viruse, baktere, myku)
Vjedhjet/dhuna (klientë dhe koleg të zemëruar)

Zyra



Të dukshme:

Përdorimi i përsëritur i tastierës
 Rrëmuje në vendin e punës
 Qëndrim i pakëndshëm në tavolinë
 Fotokopjues dhe kimikate tjera
 Stresi
 Lodhje e syve
 Prerësja e letrës/gërshërët
 Lëngje të nxehta
 Kabllo elektrike
 Karrige e papërshtatshme

Jo të dukshme:

Ngacmimi seksual
 Cilësia e ajrit të brendshëm
 Dhuna (klientë dhe koleg të zemëruar)

Pika e Karburantit



Të dukshme:

Benzina/tymi
 Kimikate tjera (si tretësit)
 Mjetet dhe pajisjet
 Puna në vende të errtë
 Stresi
 Automjetet në lëvizje
 Puna vetëm natën (Vjedhje)
 Lëvizje të përsëritura

Jo të dukshme:

Ngarkesa të rënda
 Ngrohtë ose ftohtë
 Ngacmimi seksual
 Dhuna (klientë dhe koleg të zemëruar)

Mësimi 2B

Identifikimi i Rreziqeve

Ndihmon nxënësit të identifikojnë rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në një vend të vërtetë pune



RINIA  **PUNË**

Diskutim për sigurinë

Qëllimi i orës mësimore

Ndihmon nxënësit të identifikojnë rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në një vend të vërtetë pune

Rezultatet e pritura

Në fund të orës mësimore, nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë rreziqet në vendet tipike të punëve që kryhen nga adoleshentët
- Reflektojnë mbi aftësitë e zotëruara për të vlerësuar rreziqet në një vend pune
- Inspektojnë një mjedis real të punës
- Përgatisin një hartë të rreziqeve të identifikuara në një vend pune
- Raportojnë gojarisht gjetjet përpara grupit

Ndërlidhja me rezultatet e përgjithshme të modulit Siguria në Punë: 2, 3.

Ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë-RNSh 4¹¹: # I.1, # I.2, # II.1, # II.7, # III.1, # III.4, # V.6.

Ndërlidhja me RNF Gjuhët dhe komunikimi: # 3.1

Ndërlidhja me RNF Shoqëria dhe Mjedisi: #1.1

Ndërlidhja me RNF Jeta dhe Puna: #6.4 (1), #8.4 (1)

Shënim:

- ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë dhe me RNF vlen për nivelin e mesëm të ulët-shkallën kurrikulare 4;
- për aplikimin e modulit në shkollat profesionale dhe në gjimnaze, respektivisht në nivelin e mesëm të lartë-shkallën kurrikulare 5 luteni që ndërlidhjen ta identifikoni nga Kurrikulat Bërthamë për nivelet përkatëse.

¹¹ Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët

Përgatitja

Shqyrtoni

Mësimin 2

Merrni materialin

Një flipchart dhe markera, ose përdorni një tabelë dhe markera

Fotokopjoni

Bëni kopje të mjaftueshme të materialit të nxënësve nr 6 për aktivitetin *Hulumtimi i rreziqeve* kështu që çdo grup i nxënësve të ketë një kopje.

Aranzhoni

Qasje në hapësirat e punës së ambientit shkollor

Plani i orës mësimore:

Hapi 1

Përsëritni pikat kryesore nga mësimi i kaluar.

5 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Hapi 2

Hulumtoni rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në një vend të vërtetë pune.

35 minuta

Aktiviteti *Hulumtimi i Rreziqeve*, diskutime në klasë

Hapi 3

Bëni një përmbledhje të pikave kryesore të mësimi.

5 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Udhëzime për realizimin e njësisë mësimore

Hapi 1:

Përsëritni pikat kryesore nga mësimi i kaluar

5 minuta

Rikujtoni klasën se një rrezik i punës paraqet gjithçka që mund t'iu lëndo, fizikisht ose mentalisht.

Shpjegoni se disa rreziqe të punës janë të dukshme, por disa jo. Për të qenë të sigurt në punë, ju duhet të jeni në gjendje të identifikoni llojet e ndryshme të rreziqeve (përfshirë rreziqet që nuk janë të dukshme).

Rikujtoni klasën se rreziqet ndahen në katër kategori:

- Rreziqet e sigurisë
- Rreziqet kimike
- Rreziqet biologjike
- Rreziqet tjera shëndetësore

Rezervoni disa minuta për të shqyrtuar detyrën e shtëpisë nga mësimi 2.

Ndani me klasën një ose dy plane të fushatave të sigurisë të cilat janë krijuar nga nxënësit.

Hapi 2:

Hulumtoni rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në një vend të vërtetë pune (aktiviteti i hulumtimit të rreziqeve).

35 minuta

Kontaktoni stafin adekuat të shkollës para se të filloni këtë aktivitet për të siguruar mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre.

Shpjegoni nxënësve se secili do të punojë me një partner në këtë aktivitet.

Ndajeni klasën në çifte.

Shpjegoni aktivitetin duke iu thënë nxënësve se ata tani do të hulumtojnë rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në një vend të vërtetë pune. Nëse lejohet nga shkolla juaj, çiftet e nxënësve do të shkojnë në hapësira të caktuara të shkollës dhe do të përpiqen që të gjejnë rreziqe atje. Ata do të vizitojnë (për shembull) kuzhinën e shkollës, zyrën e administratës dhe/apo ndonjë hapësirë tjetër të shkollës. Nëse shkolla nuk i ka këto hapësira, mësimdhënësi duhet të zgjedh hapësira tjera të punës në shkollë ose të aranzhoj vizitë në ndonjë vend të punës që gjendet pranë shkollës.

Jepini çdo çifti të nxënësve një kopje të formularit ‘Hulumtimi i Rreziqeve’ (Materiali i nxënësve 6)

Sigurohuni që çdo çift ka një stilolaps ose laps.

(Shënim: Aktiviteti *Hulumtimi i Rreziqeve* gjithashtu mund të bëhet si aktivitet i klasës. Shkoni në hapësirat e zgjedhura të punës me nxënësit dhe kërkoni nga ata që të nxjerrin në pah rreziqet që i shohin. Diskutoni në grup se çdo rrezik që ata gjejnë mund të lëndoj dikë).

Kërkoni nga nxënësit të shkojnë në tri zonat e përzgjedhura të shkollës (ose vende tjera të punës), për t'i identifikuar rreziqet e shëndetit dhe sigurisë.

Kërkoni nga nxënësit të listojnë në seksionin adekuat të Materialit të Nxënësve 6 rreziqet që ata i identifikojnë. Për secilin rrezik që ata identifikojnë, duhet të shkruajnë se si mund ta lëndojnë ai rrezik dikë që është duke punuar atje.

Kërkoni nga nxënësit që gjithashtu t'i identifikojnë disa nga këto pajisje të sigurisë:

- Daljet
- Aparatet për fikjen e zjarrit
- Alarmet e zjarrit
- Zorra e ujit për zjarr ose batanijet
- Sistemet spërkatëse
- Detektor tymi
- Defibrilatorë
- Kamerat e sigurisë dhe/ose ndriçimi
- Çdo mjet tjetër me të cilin rreziqet mund të kontrollohen ose të reduktohen.

Rezervoni 25 minuta që nxënësit të shkojnë në tri hapësirat e punës.

Pasi të kenë mbaruar, gruponi së bashku klasën për të raportuar se çfarë kanë identifikuar ata. Listoni në një flipchart ose tabelë të bardhë vërtetimet e tyre.

Hapi 3:

Shqyrtoni dhe përmbliidhni pikat kryesore të mësimi

5 minuta

Shqyrtoni pikat kryesore të trajtuara gjatë këtij mësimi:

- Çdo punë i ka rreziqet e shëndetit dhe sigurisë.
- Ju gjithmonë duhet të jeni të vetëdijshëm për këto rreziqe.

Përfundoni mësimin 2B duke e lexuar këtë mesazh:

Një rrezik në punë është çdo gjë që mund t'iu lëndoj në punë, qoftë fizikisht ose mentalisht. Disa rreziqe të punës janë të dukshme, por të tjerat nuk janë. Për të qenë të sigurt në punë, ju duhet të jeni në gjendje të identifikoni lloje të ndryshme të rreziqeve. Eksplorimi i vendeve të punës në hapësirat e shkollës ju ndihmon të vëreni dhe të identifikoni rreziqet reale që mund të paraqesin kërcënim për njerëzit.

“Në mësimin 3 (dhe 3B), ne do të mësojmë mënyrat për të reduktuar ose eliminuar rreziqet në punë.”

Detyrë shtëpie

Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një raport një faqe me gjetjet e tyre nga aktiviteti ‘Hulumtimi i Rreziqeve’. Ata duhet t’ia drejtojnë shkresën mësimdhënësit ose administratorit përgjegjës për vendin e punës që ata kanë hulumtuar.

Aktivitet zgjedhor

Kërkoni nga nxënësit që të kryejnë hulumtim te ngjashëm në ndonjë vend pune në afërsi të shtëpisë së tyre (dyqan ushqimor, restorant, apo tjetër vend ku publiku ka qasje). U kërkoni atyre të shkruajnë një shkresë një faqëshe ku përshkruajnë gjetjet e tyre.

Mësimi 3

Përmirësimi i sigurisë në punë

Ndihmon nxënësit t'i kuptojnë tri mënyrat kryesore për kontrollimin, reduktimin ose eliminimin e rreziqeve në punë.



RINIA  **PUNË**

Diskutim për sigurinë

Qëllimi i orës mësimore

Ndihmon nxënësit t'i kuptojnë tri mënyrat kryesore për kontrollimin, reduktimin ose eliminimin e rreziqeve në punë

Rezultatet e pritura

Deri në fund të orës mësimore, nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Përshkruajnë tri mënyrat kryesore për t'i reduktuar ose larguar rreziqet në punë;
- Identifikojnë dhe përshkruajnë rreziqet specifike të vendit të punës, efektet e tyre shëndetësore dhe metodat për kontrollin e tyre;
- Reflektojnë se pse disa metoda të kontrollit të rreziqeve janë më efektive se të tjerat;
- Bëjnë një plan për kontrollin e rreziqeve në një vend të veçantë pune;
- Bëjnë një listë të burimeve të informacionit mbi shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

Ndërlidhja me rezultatet e përgjithshme të modulit Siguria në Punë: 1, 2, 3, 4

Ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë-RNSh 4¹²: # I.1, # I.2, # I.8, #II.2, # II.5, # II.7, # II.8, # III.2, # III.4, # III.5, # III.7, # IV.1, # IV.2, # IV.4, # IV.6, # IV.8, # V.3, # V.7, # VI.1, # VI.2, # VI.8

Ndërlidhja me RNF Gjuhët dhe komunikimi: # I.3.4, # III.1

Ndërlidhja me RNF Shkencat e natyrës: # 3.6

Ndërlidhja me RNF Shoqëria dhe Mjedisi: #1.1, #1.2

Ndërlidhja me RNF Shëndeti dhe mirëqenia: #1.3, #7.1, # 7.1

Ndërlidhja me RNF Jeta dhe Puna: # 1.4.(2), # 3.4.(1), # 4.4.(1), # 6.4.(1), # 9.4.(1)

Shënim:

- ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë dhe me RNF vlen për nivelin e mesëm të ulët-shkallën kurrikulare 4;
- për aplikimin e modulit në shkollat profesionale dhe në gjimnaze, respektivisht në nivelin e mesëm të lartë-shkallën kurrikulare 5 luteni që ndërlidhjen ta identifikoni nga Kurrikulat Bërthamë për nivelet përkatëse.

¹² Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët

Çështjet kryesore që duhen të mirren parasysh

Rreziqet në vendin e punës mund të kontrollohen në shumë mënyra, por disa mënyra janë më të mira dhe më efektive se të tjerat.

Masat më të mira të sigurisë mënjanojnë rrezikun nga vendi i punës, ose i mbajnë rreziqet larg nga punëtorët. Në këtë mënyrë, vendi i punës është më i sigurt. Edhe rregullat e mira të sigurisë mund t'iu mbrojnë nga rreziqet në vendin e punës, por jo në atë mënyrë si mënjanimi i rrezikut. Së fundi, ju mund të përdorni pajisje personale mbrojtëse, siç janë maskat, dorezat dhe/apo syzet e sigurisë. Pajisjet mbrojtëse personale nuk iu mbrojnë aq mirë nga rreziqet. Gjithsesi, ju duhet t'i përdorni pajisjet mbrojtëse dhe të ndjekni rregullat dhe procedurat e sigurisë, kur në vendin tuaj të punës ka rreziqe që nuk janë mënjeluar.

Megjithatë, është e rëndësishme se disa pajisje mbrojtëse mund të shkaktojnë rreziqe. Për shembull, respiratorët duhet t'i përshtaten individit dhe të përkasin me përbërjen kimike për të cilën janë të destinuara të ofrojnë mbrojtje. Respiratorët vështirësojnë frymëmarrjen, andaj disa individë nuk duhet t'i përdorin ato.

Një rrezik mund të kontrollohet në shumë mënyra, dhe nganjëherë është më së miri që të kombinohen masat mbrojtëse.

Për shembull, edhe në qoftë se një kuzhinë ka dysHEME rezistuese ndaj rrëshqitjes, punëtorët duhet të mbathin këpucë rezistente ndaj rrëshqitjes për të mbrojtur më shumë veten e tyre.

Ushtrimet në këtë mësim kërkojnë nga nxënësit që të gjejnë mënyra për të parandaluar lëndimet në vendin e punës.

Nxënësit duhet të dinë se në qoftë se gjendja e tyre mund të ndikoj në aftësinë e tyre për punë, ekzistojnë ligje që mund t'i ndihmojnë ata. Ju keni të drejtë të kërkonit nga punëdhënësi juaj të bëj ndryshime në vendin tuaj të punës që t'iu mundësoj të punoni në kushte të sigurta të punës. Kjo quhet "akomodim i arsyeshëm". Ndryshimet duhet të jenë të arsyeshme dhe të mos shkaktojnë shumë vështirësi apo shpenzime për punëdhënësit.

Përgatitja

Lexoni

Materialet për mësimdhënësit, në fund të këtij mësimi.

Përgatitni materialet

Një prezantim i sllajdeve 23-34 në PowerPoint në një kompjuter (me projektor)

Përgatituni për prezantim

Sllajdet 23-34 në PowerPoint

Merrni

Një flipchart dhe markerë (ose përdorni tabelën e bardhë dhe markerët)

Artikujt për lojën *Piramida e Sigurisë 25.000 dollarëshe*:

- 3" x 3" fleta ngjitëse (me ngjyra të ndryshme për çdo ekip nga katër deri pesë lojtarë, varësisht nga madhësia e klasës suaj).
- Një orë ose kohëmatës.
- Lapsa ose stilolapsa.
- Çmimet (siç janë lapsa apo karamelle).
- Ngjitës dekorativ(maskues).

Vizatoni

Një tabelë për lojën *Piramida e Sigurisë 25.000 dollarëshe* (duke përdorur marker dhe letrën e flipchartit ose një pjesë të madhe të tabelës postuese). Ju gjithashtu mund t'a zhvilloni këtë aktivitet pa lojë. Shih Hapin 2.

Fotokopjoni

Materialin e Nxënësit nr. 7 dhe 8 (një kopje për çdo nxënës)

Plani i orës mësimore

Hapi 1

Diskutoni mënyrat më të mira për të reduktuar ose eliminuar rreziqet në punë.

10 minuta

Stuhi mendimesh, Diskutime në klasë

Hapi 2

Mësoni të kontrolloni rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në vendet reale të punës.

20 minuta

Loja Piramida e Sigurisë 25,000 dollarëshe, mini-raste studimi, diskutime në klasë

Hapi 3

Shqyrtoni dhe përmbliidhni pikat kyçe të mësimi. Caktoni raportin përfundimtar (afat deri në orën e parafundit të modulit).

15 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Udhëzime për realizimin e njësisë mësimore

Hapi 1:

Diskutoni mënyrat më të mira për t'i reduktuar ose eliminuar rreziqet në punë
10 minuta



Prezantimi i mësimit duke përdorur sllajdin 23 në PowerPoint

Krijoni një tabelë me dy kolona në një pjesë të flipchart-it. Etiketoni “rreziqet” në kolonën e majtë dhe “zgjidhjet e mundshme” në kolonën e djathtë.

Përzgjedhni një rrezik të punës nga lista e bërë në klasë gjatë Mësimit 2 (Hapi 1). (Ne ju rekomandojmë që j të zgjidhni “dyshemetë e rrëshqitshme”). Shkruani atë në kolonën e Rreziqeve të tabelës . Parashtrojani klasës këtë pyetje:

“Si mund të eliminohet apo të reduktohet ky rrezik në vendin e punës?”

Shkruani përgjigjet në kolonën e zgjidhjeve të mundshme, pranë rrezikut. Nxënësit tuaj mund të sugjerojnë këto zgjidhje për dyshemetë e rrëshqitshme:

- Vendosja e shenjave të “Kujdesit”
- Pastrimi i shpejt i vendeve të lagura
- Instalimi i dyshemesë rezistente ndaj rrëshqitjes
- Përdorimi i rrogosit (fshirëse këmbësh)
- Mbathja e këpucëve rezistente ndaj rrëshqitjes
- Instalimi i mbrojtësit të yndyrërave në pajisje për të penguar derdhjen e yndyrërave në dysheme.

Diskutoni mënyrat më të mira për të reduktuar ose eliminuar rreziqet në punë.

Kërkoni nga nxënësit të shkëmbejnë mes vete atë që kanë mësuar gjatë aktivitetit *Hulumtimi i Rreziqeve* në mësimin e fundit (në qoftë se e keni bërë këtë aktivitet). Në mënyrë specifike, kërkoni vullnetarë që t'i përshkruajnë mënyrat e kontrollimit dhe reduktimit të rreziqeve në vendin e punës që e kanë vizituar.



Shfaqni sllajdin 24 në PowerPoint

Tregoni klasës se ka shumë mënyra për të reduktuar rrezikun, por disa mënyra janë më të mira se të tjerat.

Diskutoni në klasë për tri metodat më të zakonshme të kontrollit të rrezikut: (a) eliminimi i rrezikut, (b) përmirësimi i politikave dhe procedurave të punës, dhe (c) përdorimi i veshjeve dhe pajisjeve që mbrojnë nga rreziku.

Përdorni sllajdin 24 dhe seksionet e më poshtme për të ndihmuar shpjegimin e këtyre metodave. Pasi të diskutoni metodën, aplikojeni atë në listën që e keni krijuar në flipchart, siç është përshkruar.

Eliminimi i rrezikut

Shpjegoni nxënësve se më së miri është që rreziku të eliminohet nga vendi i punës, ose të mbahet larg nga punëtorët ashtu që të mos lëndojnë askënd. Në këtë mënyrë, vendi i punës është më i sigurt dhe përgjegjësia për sigurinë nuk bie mbi punëtorët individual.

Këtu janë disa mënyra për të eliminuar rrezikun:

- Përdorimi i kimikateve më të sigurta, dhe largimi i kimikateve që shkaktojnë rreziqe.
- Përdorimi i perimeve të prera paraprakisht (ashtu që punëtori nuk ka nevojë të përdor thikën).
- Përdorimi i makinave me masa adekuate mbrojtëse në vend të punës me dorë. (Shënim: edhe pse makina mund të jetë një mënyrë e mirë për të eliminuar rrezikun, ajo gjithashtu mund të shkaktoj rreziqe të reja. Ligjet thonë se adoleshentët më të rinj se 18 vjeç nuk duhet të përdorin disa makina - siç janë aparatet për copëtimin e mishit, makinat paketuuese të letrës, dhe ashensorët mekanikë. Për më shumë informacion, shihni Materialin e Nxënësve nr. 13.)
- Vendosni barriera rreth sipërfaqeve të nxehta.

I parashtroni klasës pyetjen e mëposhtme:

“Cila nga zgjidhjet në flipchart eliminon rrezikun e dyshemeve të rrëshqitshme?”
Nxënësit duhet të përgjigjen se dyshemeja rezistente ndaj rrëshqitjes, rrogoza (fshirëse këmbësh) për dysheme dhe mbrojtësit e yndyrave janë artikujt në listë që me të vërtetë e mënjanojnë rrezikun. Në flipchart, vendosni numrin “1” pranë zgjidhjes.

Përmirësimi i politikave dhe procedurave të punës

Shpjegoni nxënësve se në qoftë se rreziku nuk mund të eliminohet tërësisht, politikat adekuate të sigurisë mund të reduktojnë ekspozimin e tyre ndaj rreziqeve.

Këtu janë disa politika të mira të punës që i mbrojnë punëtorët:

- Trajnimi i punëtorëve për realizim sa më të sigurtë të punës së tyre.
- Pushime të rregullta për t'i mbrojtur punëtorët nga të lodhurit e tepërt.
- Numër i mjaftueshëm i punëtorëve për të kryer punën në mënyrë të sigurtë (siç është ngritja e peshave).

I parashtroni klasës këtë pyetje:

“Cila nga zgjidhjet për dyshemetë e rrëshqitshme në flipchart, përdor politikat dhe procedurat e punës?”

Nxënësit duhet të përgjigjen se vendosja e shenjave të “Kujdesit” dhe pastrimi i shpejt i vendeve të lagura janë në këtë kategori. Në flipchart, vendoseni numrin “2” pranë zgjidhjeve.

Përdorimi i veshjeve dhe pajisjeve që mbrojnë kundër rreziqeve

Shpjegoni nxënësve që përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse është mënyrë më pak efektive për kontrollimin e rreziqeve. Përkundër kësaj, ata duhet të përdorin pajisjet personale mbrojtëse sa herë që një punëdhënës u ofron atyre ato pajisje. Punëtorët mund të kenë nevojë për pajisje personale mbrojtëse edhe kur ekzistojnë masa të tjera të sigurisë.

Këtu janë disa shembuj të pajisjeve personale mbrojtëse (PPM):

- Doreza, këpucë që nuk janë të rrëshqitshme, helmata.
- Respiratorët, syze të sigurisë, mbrojtës dëgjimi.
- Mantelet laboratorik dhe mantel pune.

I parashtroni klasës këtë pyetje:

“Pse pajisjet personale mbrojtëse nuk janë aq efektive si masat tjera të sigurisë, siç janë eliminimi i rrezikut ose rregullat e sigurisë?”

Përgjigjet mund të jenë:

- Pajisjet personale mbrojtëse nuk e eliminojnë rrezikun dhe nuk sigurojnë vendin e punës në nivel të kënaqshëm.
- Punëtorët mund të mos dëshirojnë t'i veshin ato, sepse ato mund të jenë të parehatshme, mund të jenë të nxehta, dhe mund të vështirësojnë komunikimin apo kryerjen e punës.
- Ato duhet të përshtaten në mënyrë adekuate dhe të përdoren në kohë të duhur për të funksionuar.
- Ato duhet të përkojnë me rrezikun e veçantë, siç është lloji i duhur i dorëzave, pajisje për mbrojtje të dëgjimit, apo veshje që mbron nga kimikatet që përdoren.

I parashtroni klasës këtë pyetje:

“Cila nga zgjidhjet për dyshemën e rrëshqitshme në flipchart përfshin veshjet dhe pajisjet që mbrojnë nga rreziqet?”

Nxënësit duhet të përgjigjen se mbathja e këpucëve rezistente ndaj rrëshqitjes bën pjesë në këtë kategori. Mbathja e këpucëve jo-rrëshqitëse në një mjedis (siç është restoranti ku është e vështirë të kontrollohen derdhjet mund të jetë shumë efektive). Në flipchart, vendoseni numrin “3” pranë zgjidhjes.

Kur të përfundoni shënimin e tri kategorive në flipchart, tabela juaj e plotësuar mund të duket kështu:

| Rreziku | Zgjidhjet e mundshme |
|--------------------------|---|
| Dyshemetë e rrëshqitshme | <p>Vendosja e shenjave të “Kujdesit” (2)</p> <p>Pastrimi i shpejt i vendeve të lagura (2)</p> <p>Instalimi i dyshemeve rezistente ndaj rrëshqitjes (1)</p> <p>Vendosja e rrogazit për dysheme (1)</p> <p>Mbathja e këpucëve rezistente ndaj rrëshqitjes (3)</p> <p>Instalimi i mbrojtësit të yndyrave (1)</p> |

Hapi 2:

Mësoni t'i kontrolloni rreziqet për shëndetin dhe sigurinë në vendet reale të punës (Loja Piramida e Sigurisë 25,000 dollarësh)


20 minuta

Shënim:

- Shqyrtoni mini-rastet studimore (në Materialin për mësimdhënësit, në fund të këtij mësimi) dhe sllajdet 25-33 në PowerPoint, të cilat shoqërojnë secilin tregim, para se të zhvilloni këtë aktivitet. Zgjidhni tregime që janë më të rëndësishme për nxënësit tuaj, ose përdorni tregimet tuaja.
- Mund të kërkonte nga nxënësit tuaj të diskutojnë rreth këtij materiali në vend se të luajnë lojën. Nëse e zgjidhni diskutimin, shfaqni klasës sllajdet 25-33 dhe kërkonte prej nxënësve që t'i japin idetë e tyre në lidhje me mënyrat për të parandaluar lëndimet e përshkruara në sllajdat e paraqitur.

Nëse përzgjedhni lojën, vizatoni në flipchart tabelën e lojës sikurse kjo më poshtë, dhe ngjiteni në mur.

Loja Piramida e sigurisë 25,000 dollarësh



Shpjegoni se, në çdo raund të lojës, ju do të lexoni me zë të lartë një tregim të vërtetë të një të riu i cili u lëndua në punë.

Tregoni nxënësve se do të punojnë në ekipe. Ekipet duhet të imagjinojnë veten si komitete të sigurisë, përgjegjës për identifikimin e mënyrave për të kontrolluar rrezikun që e ka shkaktuar lëndimin e përsëritur. Ekipeve do t'u jepet një flete ngjitëse për shënimin e zgjidhjeve të tyre.

Vini re se piramida i ndan zgjidhjet në tri kategori:

- Eliminimi i rrezikut (shpesh të quajtura kontrollet inxhinierike).
- Përmirësimi i politikave të punës (shpesh të quajtura kontrolle administrative).
- Veshja e pajisje personale mbrojtëse (PPM).

Shpjegoni se kjo është një lojë me ritëm të shpejt, dhe koha llogaritet. Pasi ta lexoni çdo tregim, ekipet do të kenë nga 1 minutë për të gjetur zgjidhjen. Pasi të përfundojë raundi, ju do të kërkonte nga nxënësit që të postojnë shënimet e tyre në tabelën e lojës.

Zgjidhni (ose kërkonte nga çdo grup që të zgjedh) një anëtar të grupit për mbajtjen e shënimeve. Çdo zgjidhje që ekipi e zgjedh duhet të jetë e shkruar në një fletë të veçantë ngjitëse.

Zgjidhni (ose kërkonte nga çdo grup që të zgjedh) një tjetër anëtar të grupit si “udhëheqës”, i cili udhëheq diskutimet e ekipit dhe poston zgjidhjet e propozuara nga ekipi në kategoritë adekuate në tabelën e lojës pas çdo raundi.

Njoftoni klasën se ju do të vendosni për validitetin e secilës zgjidhje. Për të qenë e vlefshme, zgjidhja duhet të jetë si në vijim:

- të ndërlidhet me rastin
- të jetë realiste
- të jetë specifike për zgjidhjen (për shembull, jo vetëm të përmenden PPM-të, por çfarë lloji i PPM-ve rekomandohet).

Të keni parasysh se disa zgjidhje mund të vendosen në më shumë se një kategori. E njëjta zgjidhje e shkruar në të dy shënimet ngjitëse të vendosura në dy kategori duhet të llogaritet vetëm një herë. Tregoni klasës se nganjëherë një kategori mund të mos ketë asnjë zgjidhje të mirë. Shpjegoni se nëse ekipet vendosin për një zgjidhje të mirë në kategorinë e gabuar, ju do ta lëvizni atë zgjidhje në kategorinë e duhur dhe i jepni atyre gjysmën e pikave të një zgjidhje të vlefshme.

Shpjegoni se, pas çdo raundi, ju do të llogaritni pikët. Çdo zgjidhje e vlefshme në kategorinë Eliminimi i rrezikut është me vlerë prej 2,000\$. Çdo zgjidhje e vlefshme në kategorinë Politikat e Punës është në vlerë prej 1,000 \$ dhe kategoria PPM është me vlerë prej 500\$.

Formoni ekipe me nga 3-5 nxënës. Kërkoni nga nxënësit që të emërtojnë ekipet e tyre. Regjistroni emrat e ekipeve në tabelë apo në një fletë të flipchart-it, ku ju do të monitoroni pikët.

Shpërndani tek secili ekip fletat ngjitëse me ngjyra të ndryshme për shënim.



Shfaqni sllajdin 25 në PowerPoint

Organizoni një raund testues, duke përdorur sllajdin 25. Për këtë raund, ekipet nuk kanë nevojë që të shkruajnë zgjidhjet, por duhet vetëm të përgjigjen me gojë. Shtoni ndonjë zgjidhje që klasa nuk e ka përmendur.

Raundi testues: Tregimi i Jasmines



Lexoni rastin e Jasminës (në Materialin për mësimdhënësit, në fund të këtij mësimi)

Jasmina është një pjatlarëse 17-vjeçare në një kuzhinë të spitalit. Për të pastruar enët për gatim, ajo i zhyt ato në një tretje të fuqishme kimike. Ajo i përdor dorëzat mbrojtëse për duar dhe krahe. Një ditë, në çastin kur Jasmina ishte duke ngritur tri enë të mëdha nga lavamani, ato i rrëshqitën nga duart në lavaman. Tretja për pastrim e spërkati në gjithë fytyrën dhe në syrin e djathtë. Ajo ishte verbuar në atë sy për 2 javë.

I parashtroni klasës pyetjen në vijim:

“Çfarë zgjidhje mund ta parandaloj këtë lëndim që të ndodhë përsëri?”

Përgjigjet e sugjeruara janë:

- **Eliminimi i rrezikut:** Përdorimi i ndonjë produkti më të sigurtë për pastrim. Shfrytëzimi i enëve **për një përdorim. Përdorimi** i makinës **për larjen e enëve.**
- **Përmirësimi i politikave të punës:** Kërkoni nga punëtorët të pastrojnë enët një nga një. Organizoni trajnim për mënyrën se si të mbrojnë veten nga kimikatet gjatë pastrimit.
- **Veshja e pajisjeve personale mbrojtëse:** Syzet.



Filloni lojën duke shfrytëzuar rastet studimore në Materialin për mësimdhënësit, në fund të këtij mësimi, si dhe sllajdet 26-33.

Shqyrtoni zgjidhjet që i kanë postuar ekipet dhe llogaritni totalin e pikëve për përgjigjet e vlefshme në fund të çdo raundi.


Luani aq raunde sa i nevojitet një ekipi për të arritur 25.000 \$, ose aq raunde sa keni kohë në dispozicion.

Shënim: Nëse dëshironi, ju mund t'i jepni nxënësve më shumë informacion mbi rreziqet e identifikuara në punët tipike për adoleshentet dhe zgjidhjet e mundshme. Kopjoni dhe shpërndani Materialin 7 të nxënësve.

Hapi 3:

Shqyrtoni dhe përmbliidhni pikat kryesore të mësimi. Caktoni datën për raportin përfundimtar

15 minuta



Shfaqni sllajdin 34 në PowerPoint

Shqyrtoni pikat kryesore të këtij mësimi.

Rikujtoni nxënësit që keni diskutuar se si mund të kontrollohen rreziqet dhe parandalohen lëndimet. Theksoni se Ligji i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë i obligon punëdhënësit që të gjithë punëtorëve, duke përfshirë adoleshentet, t'u ofrojnë një vend të sigurt dhe të shëndetshëm për punë.

Përsëriteni faktin që punëdhënësi, nëse është e mundur, është i obliguar të eliminoj krejtësisht rrezikun. Nëse punëdhënësi nuk mund të eliminoj rrezikun, punëtorët mund të mbrohen në shumë mënyra tjera. Rikujtoni masat e veçanta të mbrojtjes për punëtorët e moshës së re, përfshirë aktivitetet e ndaluara punuese për ta.

Përfundoni mësimin 3 duke lexuar këtë mesazh:

Si një punëtor i ri, ju keni më shumë gjasa të lëndoheni ose madje të humbni jetën në punë se sa një punëtor i vjetër. Punëtorët e rinj përballen me më shumë rreziqe në vendet ku ata zakonisht punojnë (për shembull, në restorante ku janë të zakonshme dyshemetë e rrëshqitshme, përdorimi i thikave dhe pajisjeve për gatim).

Mungesa e përvojës dhe mungesa e trajnimit mbi sigurinë mund të rrisë shkallën e rrezikshmësisë për punëtorët e rinj. Për këtë arsye, është e rëndësishme që punëdhënësit të gjejnë mënyra për të eliminuar dhe kontrolluar rreziqet në vendin e punës.

Ju jeni gjithashtu përgjegjës për të ditur se si t'i parandaloni lëndimet në vendin e punës dhe se si të mbronin veten dhe punëtorët tjerë nga lëndimi.

(Nëse anashkaloni mësimin 3B: "Në mësimin e ardhshëm, ne do të flasim se çfarë duhet të bëhet në raste emergjente.")

Detyrë shtëpie

Projekti Final (afati deri në orën e para-fundit të modulit Siguria në Punë):

Shpjegoni nxënësve se projekti i tyre final është gjetja e informacioneve për rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës, dhe për mënyrat efektive për t'u ballafaquar me rreziqet.

Nxënësit hulumtojnë një problem të shëndetit dhe sigurisë dhe shkruajnë një raport prej tre deri pesë faqeve (ose krijojnë një prezantim në PowerPoint). Ata gjithashtu do të dorëzojnë fletën e plotësuar të punës (Pjesa A e Materialit të Nxënësve Nr. 8). Projekti duhet të dorëzohet një ditë para përfundimit të këtij moduli.

Kërkoni nga nxënësit të mendojnë rreth asaj se ku do të mund të gjejnë informacione, nëse dëshirojnë të dinë në lidhje me problemet e shëndetit dhe sigurisë në punë. Sugjeroni shembuj të problemeve për të cilët ata mund të mësojnë, siç janë dhimbja e kyçit të dorës kur përdoret kompjuteri ose rreziqet e kimikateve. Lista e juaj mund të përfshijë me sa vijon:


Burimet në vendin e punës

- Punëdhënësi ose mbikëqyrësi
- Koleget
- Përfaqësuesi i punëtorëve
- Të dhënat mbi sigurinë e produktit, për informata rreth kemikateve
- Etiketat dhe shenjat paralajmëruese
- Manuali i orientimit të punonjësit apo materiale tjera trajnuese
- Politikat dhe procedurat e shkruara të punës.

Burimet jashtë vendit të punës

- Prindërit apo mësimdhënësit.
- Hulumtimi në internet
- Institutionet/Agjencitë qeveritare siç janë Inspektorati i Punës, Instituti i Mjekësisë së Punës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-Reperti i mjekësisë së punës, etj.
- Sindikatat e punëtorëve
- Kompanitë e sigurimit të punëtorëve
- Grupet e punëdhënësve apo shoqatat tregtare
- Grupet profesionale të shëndetit dhe të sigurisë
- Mjekët, infermierët, apo ofruesit tjerë të kujdesit shëndetësorë.

Shpjegoni nxënësve se detyra e tyre është të gjejnë informacion në lidhje me një problem specifik në një vend pune. Ata do të përqendrohen në burimet jashtë vendit të punës.



Shpërndani nxënësve nga një kopje të Materialit 8 të nxënësve

Shpjegoni se materiali ka tri seksione: (A) Pasqyrën e punës, (B) Burimet: Ku do të marrin informacionin, dhe (C) Skenarët. U thoni nxënësve se duhet të përfundojnë Pjesën A dhe ta dorëzojnë atë se bashku me detyrën e tyre përfundimtare. Pjesa B do t'u japë atyre ide ku të orientohen për informacione në lidhje me sigurinë dhe shëndetin. Pjesa C u jep nxënësve më shumë informata për problemin specifik dhe vendin të cilin ata e hulumtojnë dhe për të cilin do të shkruajnë.

Udhëzimet tjera për realizimin e projekteve

Nxënësit duhet të:

- kompletojnë Pjesën A të Materiali të Nxënësve Nr. 8 (Flete pune)
- përdorin përgjigjet e shtatë pyetjeve në Fletën e punës si bazë për raportin e tyre me shkrim.
- shfrytëzojnë të paktën tri burime të ndryshme informacioni. Këto duhet të përfshijnë së paku një agjenci qeveritare dhe së paku një organizatë jo-qeveritare. Nxënësit në raportet e tyre duhet gjithashtu të diskutojnë se cilat burime të informacionit ata i gjetën si më të dobishme, dhe pse. Disa ueb faqe të sugjeruara dhe numra të telefonit paraqiten në pjesën B të materialit 8.
- dorëzojnë raport me shkrim tri deri pesë faqe (ose prezantim në PoëerPoint) dhe fletën e përfunduar të punës (Pjesa A e Materialit të Nxënësve Nr. 8) orën e parafundit të përfundimit të modulit.

Në orën e parafundit të përfundimit të modulit, nëse koha lejon, diskutoni raportet/projektet e nxënësve. Flisni për çdo pikë të rëndësishme që nxënësit mund ta kenë anashkaluar (duke përdorur përgjigjet e sugjeruara në Materialin e mësimdhënësit, në fund të këtij mësimi).

Materiali 5 për mësimdhënësin

Mini-rastet studimore për Lojën *Piramida e Sigurisë 25.000 dollarësh*

Raundi 1: Tregimi i Uillit



Lexoni tregimin me zë të lartë:

Uilli është një 16 -vjeçar i cili punon në një restorant të ushqimit të shpejtë. Një ditë, Uilli rrëshqiti në dysheme të yndyrshme. Për të parandaluar rënien, ai u përpoq që të mbahet për shufrën pranë skarës. Uilli nuk arriti ta kap shufrën por preku skarën e nxehtë. Ai pësoi djegie të shkallë së dytë në pëllëmbë të dorës.

I parashtroni pyetje ekipeve:

“Çfarë zgjidhje mund të aplikohet që ky lëndim të mos ndodhë përsëri?”

Ofroni ekipeve nga 1 minutë për të shkruar zgjidhjet e tyre dhe vendosni ato në tabelë. Pastaj i krahasoni ato me përgjigjet e sugjeruara më poshtë.

- **Eliminimi i rrezikut.** Vendosni skarën ashtu që shufra të mos jete aq afër saj. Mbuloni dyshemenë me një rrogë rezistent ndaj rrëshqitjes. Instaloni dyshemenë jo-rrëshqitëse. Kur skara nuk është në përdorim vendosni një mburojë, që të pengohet prekja aksidentale. Vendosni një kapak mbi shportën për fërgimin e patateve ashtu që yndyrat të mos të spërkatin jashtë.
- **Politikat e punës.** Kërkoni nga punëtorët që yndyrërat të derdhura t'i pastrojnë menjëherë. Dizajnoni shtegun e kalimit në atë mënyrë që punëtorët të mos të ecin pranë skarës.
- **Pajisjet mbrojtëse personale.** Kërkoni nga punëtorët që të veshin këpucë dhe doreza të parrëshqitshme.

Raundi 2: Tregimi i Andreas



Lexoni tregimin me zë të lartë:

Andrea është një 17 vjeçar i cili punon në një dyqan ushqimor. Një ditë ndërsa po shkarkonte një kuti të rëndë nga kamioni në paletë druri, ai ndjeu një dhimbje të fortë në pjesën e poshtme të shpinës. Andrea u përpoq që të vazhdoj punën. Shpina e tij vazhdoi ta bezdiste atë, kështu që ai më në fund shkoi te mjeku. Andrea është dashur të mungoj nga puna për një javë, në mënyrë që të shërohet. Ai vazhdon të ndien dhimbje në shpinë.

I parashtroni pyetje ekipeve:

“Çfarë zgjidhje mund të aplikohet që ky lëndim të mos ndodhë përsëri?”

Kërkoni nga ekipet t’i postojnë zgjidhjet e tyre dhe krahasoni ato me përgjigjet e sugjeruara më poshtë.

- **Eliminimi i rrezikut.** Përdorni një pajisje mekanike për ngritje. Paketoni kutitë në pesha më të ulëta. Zbrazni kamionët në një zonë të mbuluar në mënyrë që punëtorët të mos ekspozohen ndaj motit, erës, ose sipërfaqeve me lagështi.
- **Politikat e punës.** Cakto dy njerëz për të kryer punën. Trajtoni punëtorët se si t’i ngrisin peshat në mënyrë adekuate. Sigurohuni që të rinjtë të mos ngrisin më shumë se 15 kg, siç përcaktohet me UA 05/2013.
- **Pajisjet mbrojtëse personale.** Mbatni këpucë jo të rrëshqitshme. (Shënim: Një studim i Instituti Kombëtar për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë(NIOSH) nuk gjeti evidenca se rripat e shpinës mund të ndihmojnë).

Pyetni klasën:

“Cila është mënyra e duhur për ngritjen e ngarkesave të rënda?”

Tregoni klasës rregullat për ngritje të sigurt:

- Mos i ngritni vet objektet që peshojnë më shumë se 15 kg për djem dhe 10 kg për vajza.
- Mbani ngarkesën afër trupit tuaj.
- Peshoni ngarkesën në këmbët tuaja. Përkulni gjunjët dhe strukuni poshtë, mbani shpinën drejt, dhe pastaj ngriteni peshën pasi të filloni të ngriheni.
- Mos e lakoni belin tuaj. Në vend të kësaj lëvizni këmbët tuaja.

Raundi 3: Tregimi i Mollit



Lexoni tregimin me zë të lartë:

Mollie është një 16 vjeçare që punon në një dyqan ushqimesh. Mbikëqyrësi i saj kërkoi nga ajo që ta pastroj aparatën për copëtimin e mishit, edhe pse ajo nuk e kishte kurrë më parë këtë punë dhe nuk kishte qenë e trajnuar për të bërë këtë punë. Mollie mendoi se aparatë për copëtimin e mishit ishte i fikur. Posa filloi t'i pastroj tehet e brisqeve, aparatë u aktivizua. Tehu i briskut ia këputi Mollit një gisht në dorën e majtë.

Pyetni ekipet:

“Çfarë zgjidhje mund të aplikohet që ky lëndim të mos ndodhë përsëri?”

Kërkoni nga ekipet që t'i postojnë zgjidhjet e tyre dhe krahasoni ato me përgjigjet e sugjeruara më poshtë.

- **Eliminimi i rrezikut.** Aparatë duhet të ketë një mbrojtëse për mbrojtjen e gishtave nga tehet e brisqeve. Aparatë duhet të ketë një fikje automatike.
- **Politikat e punës.** Një rregull duhet të kërkoj që aparatë të jetë i shkyçur para pastrimit. Askush nën moshën 18 vjeçare nuk duhet të përdorë ose të pastroj këtë aparat, kryerja e kësaj punë bie në kundërshtim me ligjet që rregullojnë sigurinë dhe shëndetin në punë.
- **Pajisjet mbrojtëse personale.** Bartja e dorezave për mbrojtje nga prerjet.

Raundi 4: Tregimi i Krisit



Lexoni tregimin me zë të lartë:

Krisi punon për departamentin e punëve publike të qytetit. Një pasdite të nxehtë, temperatura jashtë ishte shumë e lartë. Gjersa Krisi ishte duke hequr me lopatë baltën nga një ngastër boshe, ai filloi të ndjehet i trullësuar dhe i dezorientuar. Atij i ra të fikët nga të nxehtit.

Pyetni ekipet:

“Çfarë zgjidhje mund të aplikohet që ky lëndim të mos ndodhë përsëri?”

Kërkoni nga ekipet që t’i postojnë zgjidhjet e tyre dhe krahasoni ato me përgjigjet e sugjeruara më poshtë.

- **Eliminimi i rreziqut.** Kufizimi i punës në hapësirë të hapur gjatë ditëve shumë të nxehta.
- **Politikat e punës.** Pushime të shpeshta në një vend të freskët. Mbani ne dispozicion sasi të madhe të ujit. Trajtoni punëtorët mbi simptomat e stresit të nxehtësisë dhe si të mbrohen nga nxehtësia e tepruar. Punoni në ekipe për të vëzhguar njëri-tjetrin përkitazi me simptomat e nxehtësisë së tepruar (siç është dezorientimi dhe trullësja).
- **Pajisjet mbrojtëse personale.** Kërkoni nga punëtorët që të veshin një kapelë për të ofruar hije, dhe një jelek ftohës.

Raundi 5: Tregimi i Xhejmsit



Lexoni tregimin me zë të lartë:

Xhejmsi është një 16 vjeçar i cili punon në një piceri shumë të frekuentuar. Detyra e tij është të shtrijë brumin në tigan. Ai përgatit disa tiganë për një minutë. Kohëve të fundit Xhejmsi ka vërejtur se ka dhimbje në duart, supet, dhe shpinën e tij nga lëvizjet e përsëritura dhe qëndrimit në këmbë për periudha të gjata.

Pyetni ekipet:

“Çfarë zgjidhje mund të aplikohet që ky lëndim të mos ndodhë përsëri?”

Kërkoni nga ekipet që t’i postojnë zgjidhjet e tyre dhe krahasoni ato me përgjigjet e sugjeruara më poshtë.

- **Eliminimi i rrezikut.** Sigurohuni të keni sipërfaqe të përshtatura për punë, ashtu që Xhejmsi mund të shtrijë brumin në atë lartësi që shkakton më pak tendosje në supet dhe shpinën e tij. Për tendosje të duarve, përdorni një hollues brumi të picave - qoftë manual ose elektrik – në vend se të shtrini brumin me dorë. (Shënim: sipas Ligjit 04/L161 për Siguri dhe shendet ne pune, personat nën moshën 18 vjeçare nuk mund të operojnë, instalojnë, aranzhojnë, riparojnë, lubrifikojnë ose të pastrojnë holluesit e picave. Nëse jeni nën moshën 18 vjeçare, ju nuk mund të operoni me këto aparate).
- **Politikat e punës.** Planifikoni punën ashtu që askush të mos jetë i detyruar t’i bëjë të njëjtat lëvizje në mënyrë të përsëritur. Ofroni pushime të rregullta.
- **Pajisjet mbrojtëse personale.** Asnjë.

Raundi 6: Tregimi i Maries



Lexoni tregimin me zë të lartë:

Puna e Maries është të mbledh dredhëza në një fermë prej 16 ari. Një ditë ajo u dërgua në fushë pasi fusha ishte spërkatur. Askush nuk i tha asaj që lagështia në bimë ishte një pesticid shumë toksik. Menjëherë pasi ajo e filloi punën, duart dhe këmbët e Maries filluan të dridhen. Kur ajo u ngrit, u trullas dhe u rrëzua. Ajo ishte dërguar nga punëtorët tjerë të fermës në një klinikë aty pranë. Tre javë më vonë ajo vazhdon të ketë dhimbje koke, ngërçe barku dhe probleme me frymëmarrje.

Pyetni ekipet:

“Çfarë zgjidhje mund të aplikohet që ky lëndim të mos ndodhë përsëri?”

Kërkoni nga ekipet që t’i postojnë zgjidhjet e tyre dhe krahasoni ato me përgjigjet e sugjeruara më poshtë.

- **Eliminimi i rreziqut.** Përdorni metodat bujqësore pa pesticide ose përdorni pesticide më pak toksike.
- **Politikat e punës.** Prisni për disa ore apo ditë pasi të spërkaten fushat, para se t’u lejoni punëtorëve të hyjnë në fushë. Koha e nevojshme e pritjes duhet të jetë në etiketën e pesticideve. Kur përdoren pesticidet, ligji kërkon nga punëdhënësit që t’i njoftojnë punëtorët për këtë. Punëdhënësit duhet të postojnë shenjat paralajmëruese ose të njoftojnë punëtorët. Punëtorët duhet të jenë të trajnuar dhe të informuar për format e mbrojtjes nga kimikatet ndaj të cilave ata mund të ekspozohen.
- **Pajisjet mbrojtëse personale.** Vishni dorëzat dhe rrobat e punës që mbrojnë kundër pesticideve që janë përdorur. Nëse është e nevojshme, përdorni një respirator të adoptuar për individin që ofron mbrojtje kundër pesticideve të përdorura.

Raundi 7: Tregimi i Xhadas



Lexoni tregimin me zë të lartë:

Xhada punon si një ndihmës-infermiere në një spital lokal. Ajo pastron pajisjet e shtratit për të palëvizshmit dhe nganjëherë çarçafët kërkojnë ngritjen e pacientëve. Kohëve të fundit Xhada ndien dhembje shpine kur përkulet apo me rastin e ngritjes së gjërave. Ajo e di se duhet të marre ndihme me rastin e ngritjes së ndonjë pacienti, por të gjithë në njësi janë shumë të zënë dhe ajo heziton që të kërkoj ndihmë. Në shtëpi, kur Xhada shkon për të fjetur, ndjen dhimbje të forta në shpinë, qafë dhe supe. Këto dhimbje duket se po përkeqësohen çdo ditë.

Pyetni ekipet:

“Çfarë zgjidhje mund të aplikohet që ky lëndim të mos ndodhë përsëri?”

Kërkoni nga ekipet që t’i postojnë zgjidhjet e tyre dhe krahasoni ato me përgjigjet e sugjeruara më poshtë.

- **Eliminimi i rrezikut.** Mos ngritni pesha vetëm. Ngritni pacientët vetëm kur të tjerët janë në dispozicion për të ndihmuar ose përdorni një pajisje mekanike për ngritje. Shënim: Operimi me pajisje për ngritjen e pacientëve mund të paraqes rrezik për personat nën moshën 18 vjeçare. Ata mund të lëvizin pacientët, vetëm si pjesë e një ekipi në të cilin operatori i ngritjes është mbi moshën 18 vjeçare.
- **Politikat e punës.** Sigurohuni që punëtorët të cilët tashmë janë lënduar nuk iu kërkohet të ngritin pesha. Aplikoni politika që punëtorët mund të ngritin pacientët vetëm në ekipe dhe kur përdorin një pajisje ngritëse. Trajtoni punëtorët për mënyrat e sigurta të ngritjes së pacientëve.
- **Pajisjet mbrojtëse personale.** Asnjë.

Raundi 8: Tregimi i Anitës



Lexoni tregimin me zë të lartë:

Anita është një banakiere 16 vjeçare në një kafene të vogël. Një mëngjes, kafeneja kishte me pak personel, sepse një punonjës ishte sëmurë. Gjatë kohës më të frekuentuar të mëngjesit, Anita punonte ne arke dhe merrte porositë nga konsumatorët. Ajo gjithashtu nxitoi për të bërë një ibrik me kafe.

Ajo nuk e kishte kuptuar se banakieri tjetër tashmë kishte filluar të bej kafenë dhe e tërhoqi jashtë ibrikun derisa aparati vlonte. Uji i vluar dhe kokrrat e kafes rrodhen në gjithë dorën e saj, duke shkaktuar djegie të shkallës së dytë. Ajo shkoi në dhomën e urgjencës për trajtim. Anitës iu desht të ndërpres aktivitetet e saja të përditshme për 3 muaj, dhe ajo ende ka ndjeshmëri në dorën e saj si dhe shenja nga djegia.

Pyetni ekipet:

“Çfarë zgjidhje mund të aplikohet që ky lëndim të mos ndodhë përsëri?”

Kërkoni nga ekipet që t’i postojnë zgjidhjet e tyre dhe krahasoni ato me përgjigjet e sugjeruara më poshtë.

- **Eliminimi i rrezikut.** Aparati mund të dizajnohet në atë mënyrë që ibriku përvëlues nuk mund tërhiqet jashtë kur është në përdorim.
- **Politikat e punës.** Kafeneja duhet të ketë një plan që të sjellë në punëtor shtesë kur dikush lajmëron se është i sëmurë në mënyrë që kafeneja të mos mbes me personel të pamjaftueshëm. Një punonjës i vetëm duhet të caktohet për të punuar me aparatit e kafes, në mënyrë që personi të mund të përcjell zierjen e kafes. Shefi do të mund të vendos një shenjë që varet pranë aparatit të kafes që tregon nëse aparati është në përdorim apo jo.
- **Pajisjet mbrojtëse personale.** Asnjë.

Materiali 6 për mësimdhënësin

Projekti përfundimtar i nxënësve: shembuj të mirë

Skenari 1: Kuti të rënda ushqimore

Jakobi punon në një magazinë. Ai është 17 vjeçar. Një ditë, kur ai ishte duke shkarkuar disa kuti 15 kg nga një paletë druri, papritmas ndjeu një dhimbje të mprehtë në pjesën e poshtme të shpinës. Jakobit i është dashur të mungojë nga puna për një javë që të shërohet, dhe ende ndonjëherë ka dhimbje në shpinë. Ai është i shqetësuar për mundësinë e lëndimit të serishëm të shpinës dhe përpiqet të jetë i kujdesshëm, por ai dëshiron të mësoj më shumë për ngritjen e sigurt dhe mënyra tjera për të parandaluar lëndimet e shpinës.

Cili është problemi (rreziku) shëndetësor dhe i sigurisë në këtë skenar ?

- Kutitë e rënda.

Shënim: pesha maksimale e lejuar për ngritje dhe bartje të vazhdueshme (ngarkim-shkarkim) është 10 kg për djem dhe 5 kg për vajza.

Çfarë informacioni mund të gjeni në vendin e punës? Ku do ta gjeni atë?

- Trajtohuni për ngritje adekuate të objekteve nga mbikëqyrësi ose kolegu.
- Merrni udhëzimet me shkrim për ngritje adekuate të objekteve nga punëdhënësi ose mbikëqyrësi.
- Pyetni për informacion mbi pajisjet mekanike në dispozicion për ngritje.

Cilat janë efektet afatshkurtra shëndetësore?

- Ndrydhje, tendosje, ose shkëputje e muskujve.

Cilat janë efektet afatgjata shëndetësore?

- Dhimbja
- Lëvizja e kufizuar
- Mungesa e koncentrimit, për shkak të dhimbjes
- Dëmtime nervore
- Plogështi
- Gjasat të për t'u lënduar serish.

Cilat janë disa zgjidhje të mundshme për punëtorit dhe punëdhënësit?

- Përdorni një paletë me spirale ose hidraulike që ngrit kutitë deri në lartësi të belit. Shënim: Ky lloj i makinës NUK është elektrik, kështu që mund të përdoret nga punëtorët e moshës 15 vjeçare dhe më të vjetër. Puna me pajisje hidraulike elektrike ndalohet për personat nën moshën 18 vjeçare.
- Përdorni vinçin, pirunierin ose mjet të ngjashëm ashtu që ngarkesa të mos manovrohet në mënyrë manuale. Shoferi i vinçit, pirunierit DUHET të ketë së paku 18 vjet dhe të jete i trajnuar në mënyrë adekuatë!
- Ulni peshën e kutive (për personat 15-18 vjeç, pesha maksimale e lejuar për ngritje dhe bartje të vazhdueshme është e kufizuar në 10 kg për djem dhe 5 kg për vajza; pesha maksimale e lejuar për ngritje dhe bartje të kohëpaskohshme është 15 kg për djem dhe 10 kg për vajza)
- Trajtohuni për ngritje të sigurt të peshave.
- Kërkoni ndihmë në ngritjen e peshave.

Skenari 2: Tavolinë e papërshtatshme e punës me kompjutor

Asifi, 16 vjeçar, është duke punuar si asistent administrativ në një zyrë të madhe. Ai është nëpunësi më i ri në zyrë, dhe me sa duket të gjitha pajisjet i ka të vjetruara. Tastiera dhe mausi gjenden në tavolinën e punës së tij, së bashku me monitorin e kompjuterit. Leva për të rregulluar lartësinë e karriges së tij nuk punon. Asifi punon pjesën më të madhe të ditës në kompjuterin e tij. Ai e di se një person në zyrë mban proteza në kyçet e duarve dhe ajo nuk mund të bëjë shumë gjëra në shtëpi, sepse shtrëngimin në shuplakën e dorës e ka të dobët. Asifi nuk dëshiron të ketë probleme të tilla, dhe ai dëshiron të dijë se çfarë mund të bëjë.

Cili është problemi (rreziku) shëndetësor dhe i sigurisë në skenar?

- Ngarkesa nga veprimet e përsëritura në tastierë.

Çfarë informacioni mund të merr në vendin e punës? Ku do ta merr atë?

- Trajnime dhe ndihmë në aranzhimin e vendit të punës, nga mbikëqyrësi ose ndonjë kolegë
- Informata nga kolegja e lënduar se çka ka mësuar ajo për parandalimin e lëndimit.
- Udhëzime nga punëdhënësi ose mbikëqyrësi për të aranzhuar në mënyrë ergonomike tavolinën e kompjuterit të punës.

Cilat janë efektet afatshkurtra shëndetësore?

- Dhimbje të kyçit të dorës
- Mpirje apo ndjenjë e therjes
- Skuqje dhe ënjtje.

Cilat janë efektet afatgjata shëndetësore?

- Sindromi i tunelit të kyçit të dorës
- Tendiniti
- Vështirësi në lëvizjen e nyjave
- Inflamacion i nyjave
- Dhimbje afatgjate, mpirje, ndjesi të therjes ose djegies.

Cilat janë disa zgjidhje të mundshme për punëtorët dhe punëdhënësit?

- Pushime të shpeshta (“mikro” pushime çdo 10 minuta, 5-10 minuta pushim çdo orë).
- Sigurohuni që qëndrimi dhe pozita e trupit në tavolinën e kompjuterit të jetë korrekte.
- Kini në konsideratë tavolinën e kompjuterit, pajisjet dhe mobilet. Ato duhet të mbështesin qëndrimin korrekt të trupit. Shikoni dizajnin dhe lartësinë e karriges, lartësinë e ekranit kompjuterik, lartësinë e tastierës, ndriçimin, reflektimin dhe rrëmujën në vend të punës.
- Sigurohuni që kërkesat e punës të jenë të arsyeshme.
- Bëni ushtrime për lehtësimin e stresit dhe tendosjes fizike.

Skenari 3: Zhurma në punë

Hose është 18 vjeç, dhe ka një vit që punon për një kompani ndërtimi. Pjesën më të madhe të kohës ai punon me sharrë elektrike. Veshët zakonisht i kumbojnë për një kohë në mbrëmje, por kumbimi zhduket deri në mëngjes. Ai është pak i shqetësuar rreth asaj nëse zhurma e dëmton dëgjimin e tij, por nga ana tjetër ka përshtypjen se kjo ndjenjë nuk është më e ndryshme nga ajo e kumbimit të veshëve pas një koncerti. Ai dëshiron të gjen disa informacione për dëmin që mund t'i shkaktoj zhurma dhe veprimet që mund t'i ndërmerr.

Cili është problemi (rreziku) shëndetësor dhe i sigurisë në këtë skenar?

- Puna me sharë elektrike
- Ekspozimi ndaj zhurmës.

Çfarë informacioni mund të merrni në vendin e punës? Ku do të merrni atë?

- Pyesni punëdhënësin tuaj për matjet e nivelit të zhurmës
- Trajtohuni mbi mbrojtjen e të dëgjuarit
- Trajtohuni për ndikimin e zhurmës në shëndetin punëtorëve, nga punëdhënësi ose mbikëqyrësi juaj. Për shembull, zhurma nga sharrat elektrike mund të jetë deri në 110 decibel. Zhurma më e lartë se 90 decibel mund të dëmtojë dëgjimin tuaj dhe ju duhet të keni mbrojtëse për këtë nivel të lartë të zhurmës.

Cilat janë efektet shëndetësore afatshkurtra?

- Kumbime të kohëpaskohshme në vesh
- Humbje e kohëpaskohshme e dëgjimit (veshët ndjehen të mbyllur)
- Presion i lartë i gjakut dhe probleme të tjera që lidhen me zemrën

Cilat janë efektet shëndetësore afatgjata?

- Kumbime në vesh që nuk kalojnë.
- Humbja e dëgjimit për nivele të caktuara ose lloje specifike të zërit.
- Ulja e kualitetit të jetës tuaj. Kjo shpesh shpie në një lloj shurdhimi që aparatet e dëgjimit nuk mund ta kompenzojnë.

Cilat janë disa zgjidhje të mundshme për punëtorët dhe punëdhënësit?

Shënim: për personat nën moshën 18 vjeçare, operimi me sharrë elektrike është i ndaluar. Zgjidhja e vetme në këto raste është mos operimi me sharrë.

Tani që Hose ka arritur moshën 18 vjeçare, disa nga zgjidhjet mund të jenë:

- Gjeni pajisje më të qeta që nuk bëjnë zhurmë të lartë
- Përdorni një shurdhues mbi sharrën elektrike për të reduktuar zhurmën
- Vendosni mbrojtëse për vesh
- Rrini larg nga zonat e zhurmshme sa më shumë të jetë e mundur. Kufizoni kohën e qëndrimit afër zhurmës së lartë
- Trajtohuni se si të menaxhohen mjetet dhe detyrat e zhurmshme, dhe mësoni se si t'i përdorni veshjet mbrojtëse
- Matni nivelet e zhurmës dhe mësoni se cilat janë mjetet dhe detyrat më të zhurmshme
- Bëni teste mjekësore (teste të dëgjimit) për të kontrolluar dëgjimin çdo vit. Ndërmerrni masa në qoftë se vërehet keqësim

Skenari 4: Siguria në minimarket

Shanisa, 17 vjeç, punon në një dyqan. Ajo dhe punonjësit e tjerë punojnë me rradhë në ndërrimin e natës. Shanisa nuk ndihet e sigurtë kur punon në ndërrimin e natës, por ajo e di se në qoftë se nuk e pranon ndërrimin pronari thjesht do t'a zëvendësojë me dikë tjetër. Ajo e mban një topuz në çantë dhe pronari e ka udhëzuar që t'i dorëzojë paratë nëse ajo përballet me ndonjë grabitës. Ajo dëshiron të dijë se çfarë tjetër mund të bëjë që të ndjehet e sigurt.

Cili është problemi (rreziku) shëndetësor dhe i sigurisë në këtë skenar?

- Puna natën
- Kërcënimi nga dhuna.

Çfarë informacioni mund të merrni në vendin e punës? Ku do ta merrni atë?

- Trajtohuni nga mbikëqyrësi ose punëdhënësi juaj për atë se çfarë të bëni kur të jeni sulmuar apo kërcënuar me dhunë.
- Pyesni punëdhënësin tuaj për masat e sigurisë në vendin ku punoni.
- Pyesni punëdhënësin tuaj nëse vendi ku punoni ka pasur ndonjëherë probleme të sigurisë.

Cilat janë efektet shëndetësore afatshkurtra?

- Lëndimi i mundshëm.
- Stresi.

Cilat janë efektet shëndetësore afatgjata?

- Një lëndim që kurrë nuk do të shërohet plotësisht.
- Vdekja.
- Stresi shkaktuar nga dhuna.

Cilat janë disa zgjidhje të mundshme për punëtorët dhe punëdhënësit?

Shënim: Puna natën (pas orës 22.00) është e ndaluar për personat e moshës 15-18 vjeçare

Zgjidhjet e mundshme për punëtorët tjerë, apo për Shanisën nëse orari i saj nuk kalon orën 22.00:

- Trajtoni parat e gatshme në mënyrë të sigurt. Për shembull, mbani kasafortat të mbyllura dhe bëni të dukshëm faktin se në arkë mbahen vetëm pak të holla;
- Ndani vendin e punës nga publiku. Punonjësit mund të punojnë prapa një dritare qelqi që mund të ndalojë plumbat, apo prapa banaqeve të larta;
- Sigurohuni që të ketë ndriçim të mirë, pasqyra, shenja të ulëta dhe dritare që nuk janë të bllokuara nga ndonjë gjë;
- Të ketë rregulla për të mos punuar vetëm;
- Kufizoni numrin e hyrjeve të hapura për klientët/konsumatorët (por mbani qasje të mjaftueshme për dalje në rast të një emergjence);
- Përdorni pajisjet e sigurisë, siç janë kamerat me qark të mbyllur, alarme, butona paniku;
- Trajtohuni se si trajtohet një rast urgjent. Mësoni se si të reagoni në një situatë të dhunshme;
- Bisedoni me oficerët policor se si të filloni një program për të parandaluar dhunën.

Mësimi 3B

Përmirësimi i sigurisë në punë

Përforcimi i informatave për mënyrat kryesore të menagjimit të rreziqeve në situata reale të punës



RINIA  **PUNË**

Diskutim për sigurinë

Qëllimi i orës mësimore

Përforcimi i informacionit për mënyrat kryesore të menagjimit të rreziqeve në situata reale të punës

Rezultatet e pritura

Deri në fund të orës mësimore, nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Përshkruajnë rolin e profesionistëve të sigurisë dhe shëndetit në punë në reduktimin/mënjanimin e rreziqeve në punë.
- Përshkruajnë problemet e mundshme të shëndetit dhe sigurisë, burimet e informacionit, efektet shëndetësore dhe zgjidhjet që kanë të bëjnë me rreziqet në vendin e punës.

Ndërlidhja me rezultatet e përgjithshme të modulit Siguria në Punë: 3, 4, 7

Ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë-RNSh 4¹³: # I.1, # I.2, # I.8, #II.2, # II.5, # II.7, # II.8, # III.2, # III.4, # III.5, # III.7, # IV.1, # IV.2, # IV.4, # IV.6, # IV.8, # V.3, #V.7, # VI.1, # VI.2, # VI.8

Ndërlidhja me RNF Gjuhët dhe komunikimi: # I.3.4, # III.1

Ndërlidhja me RNF Shkencat e natyrës: # 3.6

Ndërlidhja me RNF Shoqëria dhe Mjedisi: #1.1, #1.2

Ndërlidhja me RNF Shëndeti dhe mirëqenia: #1.3, #7.1, # 7.2

Ndërlidhja me RNF Jeta dhe Puna: # 1.4.(2), # 3.4.(1), # 4.4.(1), # 6.4.(1), # 9.4.(1)

Shënim:

- ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë dhe me RNF vlen për nivelin e mesëm të ulët-shkallën kurrikulare 4;
- për aplikimin e modulit në shkollat profesionale dhe në gjimnaze, respektivisht në nivelin e mesëm të lartë-shkallën kurrikulare 5 luteni që ndërlidhjen ta identifikoni nga Kurrikulat Bërthamë për nivelet përkatëse.

¹³ Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët

Çështjet kryesore që duhen të mirren parasysh

Shfrytëzoni këtë mësim për të inkurajuar nxënësit që të përforcojnë informatat e përvetësuara deri më tani mbi:

- Identifikimin dhe kontrollimin e rreziqeve
- Rolin e profesionistëve të sigurisë dhe shëndetit
- Identifikimin/gjetjen e burimeve të informacionit për shëndetin dhe sigurinë në punë
- Adresimin e problemeve reale të shëndetit dhe sigurisë në vendet e punës

Me rastin e ligjërimit të këtij mësimi, theksoni faktin se “rregullimi i shpejt” nuk është gjithmonë zgjidhja më e mirë. Në anën tjetër, zgjidhja më e “mirë “ nuk mund të jetë gjithmonë teknikisht dhe financiarisht e realizueshme.

Përgatitja

Përgatitni materialet

Një prezantim për sllajdat 24 - 34 në PowerPoint në një kompjuter (me projektor)

Shfaqni

Sllajdat 24-34 në PowerPoint

Merrni

Fletë të mëdha të letrës ose tabelë,

Marker me ngjyra

Fotokopjoni

Materialin e nxënësve nr. 9, Siguria dhe Shëndeti në punë. Nga një kopje për çdo nxënës.

Plani i orës mësimore:

Hapi 1

Shqyrtoni mënyrat më të mira për të reduktuar ose mënjanuar rreziqet në punë.

5 minuta

Ligjëratë e shkurtër, diskutim klase

Hapi 2

Shpjegoni çfarë bëjnë profesionistët e sigurisë dhe shëndetit në punë (OSH).

10 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Hapi 3

Stuhi mendimesh për projektin final të nxënësve (të caktuar në fund të mësimi 3)

25 minuta

Stuhi mendimesh, diskutim klase

Hapi 4

Shqyrtoni dhe ofroni një përmbledhje të pikave kryesore të mësimi.

5 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Udhëzime për realizimin e njësisë mësimore

Hapi 1:

Shqyrtoni mënyrat më të mira për të reduktuar ose eliminuar rreziqet në punë
5 minuta



Rikujtoni klasës që ka disa mënyra për të kontrolluar një rrezik, por disa janë më të mira se të tjerat.

Rishikoni në klasë të tri metodat kryesore të kontrollit të rreziqeve: eliminimi i rrezikut, përmirësimi i politikave dhe procedurave të punës, dhe përdorimi i veshjeve dhe pajisjeve që mbrojnë nga rreziku.

Pyetni klasën për masat më të mira të kontrollit për eliminimin e rrezikut nga vendi i punës, ose për ta mbajtur atë të izoluar (larg nga punëtorët). Në këtë mënyrë, vendi i punës është më i sigurt dhe punëtorët individual nuk duhet të marrin gjithë përgjegjësinë për sigurinë.


Shpjegojuni nxënësve se në qoftë se rreziku nuk mund të mënjanohet tërësisht, politikat e mira të sigurisë mund të zvogëlojnë shkallën e rrezikshmërisë.

U thoni nxënësve që pajisjet mbrojtëse personale (shpesh të quajtura “PMP”) janë mënyra më pak efektive për të kontrolluar rreziqet. Megjithatë, ju duhet të përdorni ato sa herë që u ofrohen nga punëdhënësi juaj.

Hapi 2:

Shpjegoni çfarë bëjnë profesionistët e sigurisë dhe shëndetit në punë

10 minuta



Shpërndani materialin 9 të nxënësve

Shpjegojuni nxënësve se profesionistët e sigurisë dhe shëndetit në punë ndihmojnë në parandalimin e lëndimit të punonjësve, mjedisit dhe publikut në përgjithësi. Për shembull, ata mund të aranzhojnë hapësira të sigurta të punës, të studiojnë apo trajtojnë sëmundjet e lidhura me punën, të inspektojnë makina, ose të testojnë cilësinë e ajrit.

Tregoni nxënësve të klasës që profesionistët e sigurisë dhe shëndetit në punë punojnë në mjedise të ndryshme, nga zyra deri në fabrika e miniera. Puna e tyre ndryshon varësisht nga industria, vendi i punës, si dhe llojet e rreziqeve që ndikojnë tek punonjësit.

Ofroni klasës tuaj shembuj dhe përshkrime të profesioneve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës

- **Punëtorët e higjienës industriale:** parashikojnë, njohin, vlerësojnë, komunikojnë dhe kontrollojnë ekspozimet në vendin e punës që mund të rezultojnë në lëndime ose sëmundje të punësorëve. Ata ofrojnë fakte për punëtorët dhe punëdhënësit mbi aspekte të shëndetit dhe sigurisë dhe zhvillojnë politika për t'i bërë punëtorët më të sigurt.
- **Mjekët e shëndetit në punë** trajtojnë njerëzit që janë të sëmurë ose të lënduar për shkak të punës së tyre. Ata studiojnë sëmundjet për të kuptuar se si të identifikojnë njerëzit e rrezikuar nga sëmundjet në vendet e ndryshme të punës, për të planifikuar masat e parandalimit të sëmundjeve në punë si dhe ofrojnë shërbime mjekësore për personat që janë lënduar ose sëmurë në punë.
- **Infermieret e shëndetit në punë** trajtojnë punëtorët të cilët janë të sëmurë ose të lënduar në punë dhe parandalojnë efektet shëndetësore të shkaktuara nga puna.
- **Specialistët e sigurisë dhe shëndetit në punë** zhvillojnë programe trajnimi për punonjësit dhe promovojnë sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës. Ata ofrojnë fakte për punëtorët dhe punëdhënësit mbi aspekte të shëndetit dhe sigurisë dhe zhvillojnë politika për t'i bërë punëtorët më të sigurt.
- **Profesionistët e sigurisë** parashikojnë, njohin, vlerësojnë, komunikojnë dhe kontrollojnë rreziqet e sigurisë në vendin e punës për të gjetur dhe korrigjuar kushtet e pasigurta dhe praktikatat e punës. Ata ofrojnë trajnime për përmirësimin e sigurisë dhe për zbatimin e programeve të sigurisë, si dhe masin e studiojnë efikasitetin e këtyre përpjekjeve.

- **Epidemiologët** studiojnë modelet e sëmundjeve, rreziqet e shëndetit, ose lëndimet e grupeve të caktuara të njerëzve apo kulturave.
- **Ergonomistët** projektojnë mjete, mobile, makineri dhe procese punuese që mbrojnë shëndetin e punëtorëve duke ulur tendosjen fizike, lodhjen operuese dhe paretatë.
- **Psikologët e shëndetit në punë:** punojnë në fushën e psikologjisë për të përmirësuar cilësinë e jetës në punë, dhe për të mbrojtur dhe promovuar sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e punëtorëve.

Hapi 3:

Stuhi mendimesh për projektin final të nxënësve (e caktuar në fund të Mësimi nr. 3)

25 minuta

Tregoni nxënësve që do të diskutoni idetë mbi projektet e tyre të fundit.

Ndajeni klasën në grupe të vogla prej tre apo katër nxënësve.

Kërkoni nga grupet që të diskutojnë dhe shënojnë:

- disa shembuj të problemeve në punë, siç janë dhimbja e kyçeve të dorës me rastin e përdorimit të kompjuterit, dhimbja e shpinës me rastin e përkuljes së shpeshtë apo ngritjes së objekteve të rënda, zhurma e madhe, djegiet, rrëshqitjet dhe rrëzimet (të zakonshme në restorante), rreziqet e kimikateve të caktuara, apo dhunës në vendin e punës. Të përcaktohen për një rast.
- disa ide se ku ata do të gjejnë informacion të sigurisë dhe shëndetit në punë në lidhje me rastin e zgjedhur.

Mblidheni prapë klasën së bashku pas 10 minutave.

Jepni çdo grupi 2 deri 3 minuta për të ndarë idetë e tyre me klasën.


Shpenzoni pjesën tjetër të kohës duke u përgjigjur pyetjeve të nxënësve në lidhje me projektin.

Ju gjithashtu mund të analizoni skenarët në Materialin e nxënësve nr. 8, Seksioni C (të caktuar në orën e fundit). Nga ana tjetër, si klasë, ju mund të ndaleni në njërin nga tregimet në këtë material. Skenarin që e përdorni në klasë mos e zgjidhni/propozoni për raportin përfundimtar.

Hapi 4:

Shqyrtoni dhe jepni një përmbledhje të pikave kyçe të mësimi

5 minuta



Shfaqni sllajdin 34 në PowerPoint

Shqyrtoni çështjet kryesore të mbuluara me këtë mësim.

Përfundoni mësimin 3B duke e lexuar këtë mesazh:


“Punëtorët e rinj, si ju, kanë dy herë më shumë gjasa që të lëndohen në punë se sa punëtorët më të vjetër. Me ligj, punëdhënësit duhet të sigurohen që vendet e tyre të punës janë të sigurta. Por ju jeni gjithashtu përgjegjës për të ndjekur politikat dhe praktikat e punëdhënësit tuaj për punë të sigurt”.

“Në mësimin e ardhshëm, ne do të flasim çfarë të bëhet në raste të urgjencës.”

Mësimi 4

Emergjencat në punë

Informimi i nxënësve për llojet e emergjencave që mund të ndodhin në punë dhe veprimet/masat e nevojshme për t'iu përgjigjur emergjencave në punë.



RINIA  **PUNË**

Diskutim për sigurinë

Qëllimi i orës mësimore

Informimi i nxënësve për llojet e emergjencave që mund të ndodhin në punë dhe veprimet e nevojshme për t'iu përgjigjur emergjencave në punë

Rezultatet e pritura

Deri në fund të orës mësimore nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë një gamë të gjerë të emergjencave të mundshme në vendin e punës
- Listojnë mënyrat për t'u përballur me lloje të ndryshme të emergjencave
- Njohin hapat e planifikimit që mund të ndihmojnë punëtorët e rinj të reagojnë si duhet në situata të paparashikuara
- Analizojnë skenarët e vërtetë të emergjencave dhe japin idetë e tyre për përgatitje më të mirë
- Krijojnë strategji për t'iu përgjigjur urgjencave të ndryshme në punë.

Ndërlidhja me rezultatet e përgjithshme të modulit Siguria në Punë: 2, 3, 5

Ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë-RNSh 4¹⁴: # I.1; II.2; # II.4; # III.2; # IV.3; # IV.4;

Ndërlidhja me RNF Gjuhët dhe komunikimi: # I.2; # I.3; # I.4; # I.5; # II.1; # III.1; # IV.1

Ndërlidhja me RNF Matematika: # VIII.1

Ndërlidhja me RNF Shkencat e natyrës: # 3.2

Ndërlidhja me RNF Shoqëria dhe Mjedisi: # 1.1, # 2.1;

Ndërlidhja me RNF Shëndeti dhe mirëqenia: # I.1; # I.3; # II.1; # VI.1

Ndërlidhja me RNF Jeta dhe Puna: # I.2; # III.1; # III.2; # IV.1; # VI.1

Shënim:

- ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë dhe me RNF vlen për nivelin e mesëm të ulët-shkallën kurrikulare 4;
- për aplikimin e modulit në shkollat profesionale dhe në gjimnaze, respektivisht në nivelin e mesëm të lartë-shkallën kurrikulare 5 luteni që ndërlidhjen ta identifikoni nga Kurrikulat Bërthamë për nivelet përkatëse.

¹⁴ Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët

Çështjet kryesore që duhen të mirren parasysh

Askush nuk pret që një mëngjes të zgjohet, të shkojë në punë dhe të përballet me një krizë.

Duke zhvilluar këtë orë mësimore, ju mund të ndihmoni nxënësit tuaj të kuptojnë se emergjencat në punë mund të ndodhin në çdo kohë, në çdo vend, dhe mund të prekin çdonjërin - duke përfshirë edhe ata.

Më e rëndësishmja “për të marrë” nga ky mësim është përgatitja e adoleshentëve për të mbrojtur veten e tyre nëse ndodh një rast urgjent në punë.

Nxënësit duhet të marrin pjesë në të gjitha praktikat e trajnimeve / ushtrimeve në punë. Në këtë mënyrë, ata do të përgatiten për t'iu përgjigjur në mënyrë të duhur situatave emergjente.

Përgatitja

Lexoni

Materialin 7 dhe 8 për mësimdhënësit në fund të këtij mësimi.

Përgatitni materialet

Një prezantim në PowerPoint për sllajdet 35-41 në një kompjuter (me projektor)

Merrni

Një tabelë dhe markerë, ose përdorni një tabelë të bardhë dhe markerë

Fotokopjoni

Materialet 11 dhe 12 (Emergjencat në lajme, Planet e Veprimit të Emergjencës) për çdo nxënës

Plani i orës mësimore:

Hapi 1

Definojeni termin “emergjencë.” Diskutoni shembuj të emergjencave që mund të ndodhin në një vend pune.

10 minuta

Stuhi mendimesh, diskutim në klasë

Hapi 2

Vlerësoni ngjarjet e vërteta në lidhje me emergjencat që kanë ndodhur në punë dhe mënyrat e reagimit të punëtorëve.

30 minuta

Punë në grupe të vogla, diskutim në klasë

Hapi 3

Shqyrtoni dhe bëni një përmbledhje të pikave kryesore të mësimit.

5 minuta


Ligjëratë e shkurtër

Udhëzime për realizimin e njësisë mësimore

Hapi 1:

Definoni termin “emergjencë.” Diskutoni shembuj të emergjencave që mund të ndodhin në një vend pune

10 minuta



Shfaqni sllajdin 36 dhe 37 në PowerPoint

Shpjegoni klasës se tani do të flisni për emergjencat në punë.



Jepni përkufizimin e emergjencës:

Një rast emergjencë është çdo ngjarje e paplanifikuar që përbën një kërcënim. Një rast urgjencë mund të kërcënojë punonjësit, klientët dhe/apo publikun. Ajo mund të mbyllë punën në një biznes. Ajo mund të shkaktojë dëme, ose mund ta dëmtojë mjedisin.

Shpjegoni se emergjencat mund të jenë natyrore ose të shkaktuara nga njeriu.

Pyetni klasën:

“Cilat janë disa nga emergjencat që mund të ndodhin në një vend pune ose që mund të ndikojnë një vend të punës?”

Kërkoni nga nxënësit të japin shembuj të rasteve emergjente derisa ju i shkruani në tabelë. Lista juaj mund të përfshin këto emergjenca:

| | | |
|--------------------------------------|--------------------------|--------------------|
| Sëmundje ose lëndime të rënda | Zjarret | Vërshimet |
| Uraganet | Tornadot | Tërmetet |
| Ndërprerjet e rrymës | Derdhjet kimike | Shpërthimet |
| Rrjedhja e lëndëve toksike | Terrorizmi | Dhuna |
| Stuhitë | Stuhitë e akullit | |
| | Orteqet e borës | |

Shpjegoni se mënyra më e mirë për t'u marrë me një emergjencë është të dini para kohe çfarë të bëni nëse kjo ndodh. Për të qenë të përgatitur, ju duhet të ushtroni hapat që duhet ndërmarrë. Pak njerëz mund të mendojnë në mënyrë të qartë gjatë një krize, kështu që ju duhet ta mendoni dhe praktikoni atë çfarë duhet bërë para se të ndodh një situatë urgjence.

Tregoni nxënësve që kur ata të fillojnë një punë të re, punëdhënësi i tyre duhet t'i informojë rreth llojeve të emergjencave që mund të ndodhin në atë vend të punës dhe çfarë duhet të bëjnë ata për të qenë të sigurtë. Administrimi i sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës u kërkon punëdhënësve të kenë një Plan veprimi emergjent. Shih Materialin 7 për mësimdhënësit në fund të këtij mësimi.

Hapi 2:

Vlerësoni rastet e vërteta të emergjencave që kanë ndodhur në punë dhe reagimet e punëtorëve

30 minuta

Pyetni klasën:

“Çfarë do të donit të dini në lidhje me emergjencat?”

Përgjigjet e nxënësve mund të përfshijnë këto pyetje:

- Çfarë mund të ndodhë dhe si mund ta mbrojt veten?
- A do të më njoftoj alarmi? Si duket apo si tingëllon alarmi?
- Kush është përgjegjës gjatë emergjencës?
- Në qoftë se dikush lëndohet, çfarë duhet të bëjë?
- Kush është në gjendje të ofroj ndihmën e parë?
- Cilat janë përgjegjësitë e mia?
- Si do ta kuptoj se emergjenca ka përfunduar?

Shpjegoni nxënësve se ata do të punojnë në grupe të vogla, të lexojnë lajmet në lidhje me emergjencat që kanë ndodhur në punë, dhe të reflektojnë mbi reagimin e punëtorëve në ato situata.

Shpjegoni se, në grupe të vogla, ata do të lexojnë ngjarjet dhe do të vendosin se çfarë ka shkuar mirë dhe çfarë nuk ka shkuar mirë. Ata pastaj do të listojnë pikat e veprimit për këtë vend të punës për të mbrojtur dhe përgatitur më mirë punëtorët për rastet emergjente në të ardhmen. Grupet do të paraqesin mendimet e tyre para pjesës tjetër të klasës.



Shpërndani kopje të materialit 11 dhe 12 për çdo nxënës. Materiali 11 është një grup i lajmeve. Materiali 12, Planet e Veprimit të emergjencës, përshkruan elementet kryesore të gatishmërisë ndaj emergjencave.

Cakto nga një lajm të ndryshëm nga Materiali 11 për secilin grup të vogël. Secili grup të zgjedhë nga një nxënës për të udhëhequr diskutimin duke lexuar me zë të lartë rrëfimin dhe pyetjet e skenarit. Një tjetër nxënës duhet të shkruaj përgjigjet e grupit për pyetjet. Një nxënës i tretë do t'i raportojë klasës përgjigjet e grupit.

Jepni grupeve të vogla rreth 15 minuta për të lexuar rrëfimet e tyre dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve nga Materiali nr 11 i nxënësve. Nëse i përfundojnë më herët, atëherë mund t'i diskutojnë lajmet e tjera nga materiali.

Mblidheni klasën bashkë pas 15 minutash. Grupet e vogla le të raportojnë lajmin e tyre, vlerësimin e tyre se si punëtorët janë përgjigjur dhe idetë e tyre për hapat që duhen marrë për të mbrojtur dhe përgatitur më mirë punëtorët.

Sigurohuni që grupet të trajtojnë çdo pikë në prezantimet e tyre. Nëse është e nevojshme, trajtoni vet pikat kryesore. Një përgjigje është dhënë në Materialin 8 për mësimdhënësit, në fund të këtij mësimi.

Ndihmoni nxënësit të kuptojnë se planifikimi i reagimit ndaj rasteve emergjente është jetik. Mund të zvogëloj rrezikun nga lëndimet apo edhe nga vdekja. Inspektorati i Punës u kërkon punëdhënësve që të kenë të shkruar një Plan Veprimi të Emergjencave. Punëtorët duhet të trajnohen në lidhje me veprimet që duhet të ndërmerren në raste të ndryshme të emergjencave që mund të ndodhin. Duhet gjithashtu të kryhen stërvitje të rregullta.

Hapi 3:

Shqyrtoni dhe bëni një përmbledhje të pikave kryesore të mësimi

5 minuta

Rikujtoni klasën se çdo vend pune duhet të ketë një plan veprimi për raste emergjente (i referoheni përsëri sllajdit 37). Plani duhet të përfshijë informacionin që vijon dhe punëtorët duhet të marrin trajnim për zbatimin e tij:

- Kush është përgjegjës gjatë një emergjence?
- Ku janë strehimoret?
- Cilat janë mënyrat më të mira për të dalë jashtë?
- Ku janë vendet që punëtorët duhet të takohen?
- Çfarë duhet të bëni nëse dikush lëndohet?
- Ku gjendet kutia e ndihmës së parë?
- Kush ka trajnim të ndihmës së parë?
- Si dhe kur do të mbahen stërvitjet praktike?

Riujtoni nxënësit se kur ata fillojnë një punë të re, kanë të drejtë të informohen për planin e emergjencave.

Materiali 7 për mësimdhënësin

Një Plan Veprimi i emergjencës në vendin e punës duhet të përfshijë informacion në lidhje me:

- Llojet e emergjencave dhe se si të reagohet.
- Vend-takimet gjatë një emergjence.
- Mënyrat më të mira për të dalë nga ndërtesa ose për t'u larguar nga rreziku.
- Pajisjet e emergjencës dhe sistemet e alarmit.
- Njerëzit kyç që do të jenë përgjegjës.
- Çfarë duhet të bëjnë nëse dikush është lënduar.
- Çfarë duhet të bëjnë çdo punëtor.
- Praktikat e stërvitjeve.

Materiali 8 për mësimdhënësin

“Emergjencat në lajme”: Përgjigjet

Rasti 1: Zjarri nga yndyrat në restorant djeg punonjësin

Një zjarr shpërtheu në një restorant familjar mbrëmjen e së martës duke lënduar në mënyrë kritike një punonjës dhe duke shkaktuar dëme materiale. Zjarri nisi kur një tigan i mbushur me vaj në një shporet të nxehtë ishte lënë i pambikëqyrur. Zjarri u përhap shpejt në peshqirët varur aty pranë. Një punonjës e pa zjarrin dhe u përpoq që ta shuante atë duke derdhur ujë në furrë. Kjo bëri që yndyra e djegur t’ia spërkat fytyrën, krahët dhe gjoksin e tij! Një koleg, pasi dëgjoi britmat, bërtiste që të gjithë të largoheshin menjëherë nga restoranti dhe telefonoi policinë dhe zjarrfikësit. Zjarrfikësit e shuan zjarrin dhe u kujdesën për punëtorin e djegur. I lënduari u dërgua në spital me lëndime të rënda.

Çfarë shkoi mirë?

Kolegu bërtiti që të gjithë të largoheshin nga restoranti menjëherë dhe thirri policinë.

Çfarë shkoi keq?

Kuzhinieri nuk duhet të kishte lënë shporetin të pambikëqyrur. Peshqirët e enëve nuk duhet të vendosen aq afër me shporetin. Nuk duket se punonjësi që u përpoq ta shuante zjarrin ishte i trajnuar mirë. Ai nuk duhej të provonte që ta shuaj me ujë zjarrin e shkaktuar nga yndyra. Në vend të ujit duhet të përdoret një zjarrfikës ose sodë buke. Duket se nuk kishte asnjë detektor tymi ose sistem spërkatës.

Çfarë mund të bëhet për të mbrojtur dhe përgatitur më mirë punonjësit?

Një detektor tymi me një alarm dhe një sistem spërkatës duhet të instalohen. Punonjësit duhet të trajnohen në lidhje me rreziqet nëse lihet një shporet i pambikëqyrur, çfarë lloji të zjarrfikësve të përdorin, se si ta përdorin atë, dhe se si ata duhet të largohen menjëherë nga ndërtesa në qoftë se një zjarr fillon të dalë nga kontrolli. Pasi të kenë dalur të gjithë nga ndërtesa, duhet thirrur departamentin e zjarrfikësve. Praktikat, stërvitjet duhet të mbahen në mënyrë që të gjithë të dinë rrugën e evakuimit dhe ku të mbliidhen në mënyrë që të jenë të sigurt që të gjithë kanë dalë jashtë ndërtesës.

Rasti 2: Grabitësi kërcënon me armë punonjës in e ri

Një punonjës 16-vjeçar i një dyqani, ishte kërcënuar me armë të enjten mbrëma nga një person i maskuar i cili kërkonte të holla. Punonjësi ishte duke punuar vetëm, dhe ishte duke e mbyllur dyqanin për atë natë. Më vonë, punonjësi i tha policisë se, derisa po e zbrazte arkën, grabitësi e kishte lidhur atë, dhe u largua me të holla. Edhe pse grabitja e tronditi punonjës in, ai nuk ishte lënduar fizikisht. Emri i punonjës it po mbahet i fshehur për shkak të moshës së tij.

Çfarë shkoi mirë?

Punonjësi ka bashkëpunuar me grabitësin, gjë e cila ndoshta e ka shpëtuar që të mos lëndohet.

Çfarë shkoi keq?

Grabitësi kishte mundur të vjedhë dyqanin dhe ta lidhte punonjës in për shkak se nuk ekzistonin masat e sigurisë. Puna natën është ndaluar për personat nën moshën 18 vjeçare.

Çfarë mund të bëhet për të mbrojtur dhe përgatitur më mirë punonjës it?

Punonjës it, e sidomos punonjës it e rinj, nuk duhet të punojnë të vetëm gjatë natës. Duhet të ekzistoj një alarm i heshtur që do të sinjalizonte policinë, apo një roje e sigurisë duhet të jetë në detyrë. Dyqani duhet të jetë i ndriçuar mirë dhe të ketë kamera të sigurisë. Të gjithë punonjës it duhet të trajnohen se si të reagojnë ndaj grabitjeve ose kërcënimeve tjera.

Rasti 3: Një punonjës i ri ndërtimi rrëzohet nga shkalla

Një bojaxhi 18-vjeçar, që po ngjyrote katin e dytë të shtëpisë, u rrëzua dje nga shkalla duke thyer të dyja këmbët e tij. Ai gjithashtu pësoi prerje të rënda kur e zuri krahun në një gardh metalik. Kolegët nxituan për ta ndihmuar dhe thirrën një ambulancë. Teknikët e emergjencës mjekësore thanë se kolegët kanë bartur punonjësin e lënduar në oborr dhe pastaj kanë aplikuar presion në plagë të hapur për të ndaluar gjakderdhjen.

Çfarë shkoi mirë?

Kolegët thirrën emergjencën. Ata dinin se si të aplikonin presion mbi plagën.

Çfarë shkoi keq?

Punonjësit nuk duhet ta kishin lëvizur punonjësin e lënduar, sepse ata mund ta kishin lënduar edhe më shumë duke e lëvizur. Vetëm punonjësit e trajnuar duhet të japin ndihmën e parë. Punonjësit që po i jepnin ndihmën e parë duhet të kishin vënë dorëza (në qoftë se kanë pasur), para se ta preknin punëtorin që kishte gjakderdhje.

Çfarë mund të bëhet për të mbrojtur dhe përgatitur më mirë punonjësit?

Punonjësit duhet të trajnohen që të thërrasin 112 ose personelin mjekësor sa herë që dikush lëndohet. Ata duhet të mësohen që të mos e lëvizin një koleg i cili mund të ketë eshtra të thyer, sepse kjo mund ta keqësojë lëndimin. Për të ndaluar gjakderdhjen, ata duhet t'ia ofrojnë punonjësit të lënduar një fashë që ta vendos në krahun e tij ose, vet ata të ushtrojnë presion duke përdorur një leckë të trashë, të pastër. Ata nuk duhet ta lënë vet kolegun e lënduar, përveç kur duhet ta thërrasin ndihmën e parë. Punonjësit, gjithmonë duhet të kenë çantën e ndihmës së parë afër, dhe disa njerëz duhet të trajnohen në ndihmën e parë. Artikujt që duhet të gjinden në kutinë e ndihmës së parë janë: fasha, antiseptikë, qetësues, aspirina/ qetësues të dhimbjeve, termometër, doreza, mbrojtës nga rrezet e diellit, pinceta, gërshtë, shurup (që shkakton të vjella), gaza sterile, rrip dhe mbërthyeset e sigurisë.

Rasti 4: E ëma e punëtorit të ri me aftësi të kufizuara flet për reagimet e punëdhënësit gjatë tërmetit

Punonjësit e një Qendre Tregtare u grumbulluan nën tavolina dhe korridore, meqë një tërmet i shkallës 6.1 tronditi ndërtesën e tyre. Kur tërmeti u ndal, punëtorët ndjekën shenjat ndriçuese dalëse për tek shkallët. Ata i kaluan 10 palë shkallë dhe dolën në rrugë. Marie Krasniqi nga Drenasi ka një djalë, Jonin, i cili është një punonjës i kompanisë. Ajo është ankuar se djali i saj, i cili ka sindromin Doën, kishte mbetur i vetëm gjatë dhe pas tërmetit. Punonjësi dhe mbikëqyrësit nuk kishin ide se Joni kishte mbetur në katin e 11-të. Kompania zotohet që të shikoj Planin e Veprimit të Emergjencës dhe siguron që plani i përgatit dhe i mbron të gjithë punonjësit, duke përfshirë edhe ata që mund të kenë nevojë për më shumë ndihmë.

Çfarë shkoi mirë?

Ndërtesa kishte të ndriçuara shenjat për dalje emergjente. Punonjësit përdoren shkallët në vend të ashensorit. Ata nuk bënë panik, kështu që nuk kanë shkelur njëri tjetrin. Kompania ka një Plan Veprimi të Emergjencës me shkrim dhe do të bën ndryshime pasi të vlerësohet se çfarë nuk ka funksionuar mirë.

Çfarë shkoi keq?

Joni kishte mbetur vetëm në vend se të ndihmohej deri te shkallët. Nuk duket se punonjësit e tjerë janë trajnuar apo kanë marrë pjesë në stërvitje që të dinin se çfarë duhet bërë në raste tërmeti. Nuk duket se ekzistonte një plan për një vend takimi apo një plan për të bërë numërimin e të gjithë punëtorëve.

Çfarë mund të bëhet për të mbrojtur dhe përgatitur më mirë punonjësit?

Punonjësit duhet të trajnohen që të hyjnë nën tavolina të rënda gjatë tërmeteve. Stërvitjet duhet të mbahen në mënyrë që të gjithë të dinë mënyrat më të mira për të dalë jashtë dhe ku të takohen për numërim të punëtorëve. Dikujt duhet t'i caktohet detyra që të sjellë fletë-regjistrin e punëtorëve që të sigurohet se të gjithë punonjësit janë numëruar. Kompania duhet të ketë një sistem shoqërues apo ndonjë mënyrë tjetër që të siguroj punonjësit që kanë nevojë për më shumë ndihmë të dalin nga ndërtesa në mënyrë të sigurt.

Rasti 5: Era e fortë i thyen dritaret e një dyqani lokal

Një erë e fortë shpërtheu dje në qytet duke lënë pa energji zona të mëdha dhe duke dëmtuar shumë ndërtesa. Era theu shumicën e dritareve në një dyqan. Derisa xhamat binin, punonjësit i tubuan konsumatorët në sektorët e çdo kati të ndërtesës tre-katëshe. Konsumatorët ishin mirënjohës për ndihmën që punonjësit iu dhanë në largimin e të gjithëve nga dritaret.

Çfarë shkoi mirë?

Punonjësit dinin si t'i largonin njerëzit larg nga dritaret. Punonjësit u përpoqën që ti sjellin klientët në zonë të sigurte.

Çfarë shkoi keq?

Punonjësit dhe klientët duhet të kishin shkuar në vendin më të ulët të ndërtesës. Bodrumi do të ishte vendi më i mirë për të shkuar.

Çfarë mund të bëhet për të mbrojtur dhe përgatitur më mirë punonjësit?

Punonjësit duhet të trajnohen mbi Planin e Veprimit të Emergjencës. Të gjithë duhet të shkojnë në nivelin më të ulët të ndërtesës gjatë erërave të forta dhe të qëndrojnë larg nga dritaret. Praktikrat e stërvitjeve duhet të mbahen në mënyrë që punonjësit të dinë mënyrat më të mira për t'u larguar, për tu mbledhur në mënyrë që të bëhet numërimi i punonjësve. Një mbikëqyrës duhet të sjellë fletë-regjistrimin e nënshkrimeve të punonjësve për të siguruar se të gjithë punonjësit janë numëruar.

Shënim: Më poshtë është lista e kontakteve të emergjencës; informoni nxënësit për këto kontakte

| | |
|---|-----------------------------------|
| Policia | 92 ose 112 nga Vala |
| FSK (Shtabi i përgjithshëm) | 038 543 555 |
| Zjarrfikësat | 93, ose 933 nga Vala, 038 548 005 |
| Ndihma e shpejtë | 038 500 094, 038 542 404 |
| Drejtorati për mbrojtje civile dhe emergjence | 038 245 666, 038 245 777 |

Mësimi 4B

Emergjencat në punë

Përforcim i informacionit për llojet e emergjencave që mund të ndodhin në punë dhe veprimet/masat e nevojshme për t'iu përgjigjur emergjencave në punë.



RINIA  **PUNË**

Diskutim për sigurinë

Qëllimi i orës mësimore

Përforsim i informacionit për llojet e emergjencave që mund të ndodhin në punë dhe veprimet/masat e nevojshme për t'iu përgjigjur emergjencave në punë

Rezultatet e pritura

Deri në fund të orës mësimore nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin hapat e planifikimit që mund të ndihmojnë punëtorët e rinj të reagojnë si duhet në situata të paparashikuara
- Analizojnë një plan të vërtetë të reagimit ndaj emergjencave në një vend pune
- Prezantojnë idetë e tyre për përmirësim të masave të reagimit

Ndërlidhja me rezultatet e përgjithshme të modulit Siguria në Punë: 2, 3, 5

Ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë-RNSH 4¹⁵: # I.1; II.2; # II.4; # III.2; # IV.3; # IV.4;

Ndërlidhja me RNF Gjuhët dhe komunikimi: # I.2; # I.3; # I.4; # I.5; # II.1; # III.1; # IV.1

Ndërlidhja me RNF Matematika: # VIII.1

Ndërlidhja me RNF Shkencat e natyrës: # 3.2

Ndërlidhja me RNF Shoqëria dhe Mjedisi: # 1.1, # 2.1;

Ndërlidhja me RNF Shëndeti dhe mirëqenia: # I.1; # I.3; # II.1; # VI.1

Ndërlidhja me RNF Jeta dhe Puna: # I.2; # III.1; # III.2; # IV.1; # VI.1

Shënim:

- ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë dhe me RNF vlen për nivelin e mesëm të ulët-shkallën kurrikulare 4;
- për aplikimin e modulit në shkollat profesionale dhe në gjimnaze, respektivisht në nivelin e mesëm të lartë-shkallën kurrikulare 5 luteni që ndërlidhjen ta identifikoni nga Kurrikulat Bërthamë për nivelet përkatëse.

¹⁵ Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët

Përgatitja

Përgatisni

Sllajdet 36 dhe 37 në një kompjuter me projektor

Shqyrtoni

Mësimin 4 dhe Planin e Reagimit Emergjent në shkollën tuaj

Merrni materialin

Një flipchart dhe markera, ose përdorni një tabelë dhe markera

Fotokopjoni

Bëni kopje të mjaftueshme të Materialit të nxënësve nr 11 (nga një për secilin nxënës) si dhe të Planin për Reagim Emergjent të shkollës tuaj (poashtu nga një për secilin nxënës).

Plani i orës mësimore

Hapi 1

Përsëritni pikat kryesore nga mësimi i kaluar.

5 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Hapi 2

Analizoni planin e shkollës tuaj për reagim në situata emergjente

35 minuta

Punë në grupe

Hapi 3

Bëni një përmbledhje të pikave kryesore të mësimi.

5 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Udhëzime për realizimin e njësisë mësimore

Hapi 1:


Përsëritni pikat kryesore nga mësimi i kaluar
5 minuta



Shaqni sllajdin 36 në PowerPoint

Shqyrtoni termin “emergjence” dhe pikat kyçe të mësimi të kaluar.

Rikujtoni nxënësit se mënyra më e mirë për të trajtuar një rast emergjent është që të dini para kohe se çfarë duhet bërë. Verifikoni informatat e nxënësve për veprimet që duhet bërë nëse ndodh një rast emergjent në punë.



Shaqni sllajdin 37 në PowerPoint

Rikujtoni nxënësit për përmbajtjen e një plani të veprimit në situata emergjente

Hapi 2:

Analizoni planin e shkollës tuaj për reagim në situata emergjente

35 minuta

Kontakttoni stafin adekuat të shkollës para se të filloni këtë aktivitet për të siguruar mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre.

Shpjegoni nxënësve se ata do të punojnë në grupe.

Ndajeni klasën në grupe me nga 5-7 nxënës.

Shpjegoni aktivitetin duke iu thënë nxënësve se ata tani do të analizojnë planin e shkollës së tyre për reagim në situata emergjente.

Shënim: nëse shkolla nuk posedon me një plan të tillë, nxënësit mund të propozojnë një plan në bazë të orijentimit të ofruar në sllajdin 37.



Jepini çdo grupi të nxënësve një kopje të Planit të shkollës për reagim në situata emergjente dhe nga një kopje të Materialit të nxënësve nr 11.

Kërkoni nga grupet që për 10 minuta të analizojnë përmbajtjen e Planit të shkollës për reagim në situata emergjente dhe të përgjigjen në pyetjet e mëposhtme:

- A i përmban plani të gjitha informacionet e nevojshme?
- Cilat informacione mungojnë në plan?

Kërkoni nga grupet që për 10 minuta të tjera të analizojnë masat e planifikuara të reagimit dhe të japin propozimet e tyre për përmirësimin e atyre masave.

Shënim: nëse vlerësoni se koha është e limituar, caktoni detyra të ndryshme për grupet e ndryshme në mënyrë që të kenë më shumë kohë për të reflektuar. P.sh. dy grupe mund të merren me përmbajtjen ndërsa një grup me masat e parapara në planin e shkollës.

Mblidheni prapë klasën së bashku.

Jepni çdo grupi 5 minuta për të raportuar vlerësimet dhe rekomandimet e tyre. Listoni në një flipchart ose në tabelë çështjet kryesore sa i përket problemeve të identifikuara dhe zgjidhjeve të propozuara.

Shënim: për këtë pjesë të orës mësimore mund të ftoni personin përgjegjës për sigurinë në shkollë që të dëgjoj vlerësimet dhe rekomandimet e nxënësve për përmirësimin e planit për reagim në situata emergjente.

Hapi 3:

Shqyrtoni dhe përmbliidhni pikat kryesore të mësimi

5 minuta

Përfundoni mësimin 4B duke lexuar këtë mesazh:

“Emergjencat mund të ndodhin dhe ndodhin gjatë gjithë kohës. Zakonisht ndodhin kur më së paku i presim. Mënyra më e mirë për të mbrojtur veten dhe të tjerët është që të jemi të përgatitur.

“Në mësimin e ardhshëm ne do të flasim për të drejtën për një vend të sigurtë pune, si dhe për të drejtat tjera ligjore që ju i keni në punë.”

Detyrë shtëpie

Caktoni nxënësve të gjejnë pagën minimale në shtetit tuaj. Atyre do t’ju duhet ky informacion për mësimin 5.

MËSIMI 5

Dini të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja

Informimi i nxënësve për të drejtat e rëndësishme ligjore që ata kanë në vendin e punës.



RINIA  **PUNË**

Diskutim për sigurinë

Qëllimi i orës mësimore

Të edukohen nxënësit për të drejtat e rëndësishme ligjore që ata kanë në vendin e punës.

Rezultatet e pritura

- Deri në fund të orës mësimore nxënësit do të jenë në gjendje të:
- Evidentojnë dhe përshkruajnë të drejtat e veçanta ligjore të adoleshentëve në vendin e punës
- Të arsyetojnë që krahas të drejtave ligjore ata kanë edhe përgjegjësi personale për sigurinë e tyre në punë
- Të reflektojnë mbi rëndësinë e ligjeve që rregullojnë kushtet e punës dhe sigurinë në punë
- Të sigurojnë informacionin vijues nga legjislacioni i punës (Ligji i Punës dhe aktet nënligjore):
 - Kufizimet e punëve të rrezikshme për të rinjtë nën moshën 18 vjeçare.
 - Kufizimet për orarin e punës (ditor dhe javor) për të rinjtë që punojnë nën moshën 18 vjeçare

Ndërlidhja me rezultatet e përgjithshme të modulit Siguria në Punë: 6, 7

Ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë-RNSh 4¹⁶: #I.8; # II.2; # II.5; #II.7; # II.8; # III.2; # IV.2; # IV.6; # V.3; # V.7; # VI.1; # VI.2; # VI.8;

Ndërlidhja me RNF Gjuhët dhe komunikimi: # I.2; # III.1;

Ndërlidhja me RNF Shkencat e natyrës: # III.6

Ndërlidhja me RNF Shoqëria dhe Mjedisi: # 1.1, # I.2

Ndërlidhja me RNF Shëndeti dhe mirëqenia: #III.1; # IV.1;# VI.1

Ndërlidhja me RNF Jeta dhe Puna: # I.1; # I.2; # III.1; # III.2; # IV.1; # V.1; # VI.1

Shënim:

- ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë dhe me RNF vlen për nivelin e mesëm të ulët-shkallën kurrikulare 4;
- për aplikimin e modulit në shkollat profesionale dhe në gjimnaze, respektivisht në nivelin e mesëm të lartë-shkallën kurrikulare 5 luteni që ndërlidhjen ta identifikoni nga Kurrikulat Bërthamë për nivelet përkatëse.

¹⁶ Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët

Çështjet kryesore që duhen të mirren parasysh

Ligjet e punës që mbrojnë të rinjtë në disa raste janë të ndryshme nga ato që zbatohen për të rriturit.

Ligji i punës përcakton masat mbrojtëse për punonjësit e moshës 15-18 vjeçare (përfshirë mbrojtjen nga puna natën, nga punët e rrezikshme dhe kufizimet në orarin e punës). UA 01/2012 sistemon format e lejuara dhe të ndaluara të punës për personat e moshës 15-18 vjeçare në sktorin formal ndërsa UA 05/2013 përcakton format e rrezikshme të punës së fëmijëve me prioritet për tu ndaluar në Republikën e Kosovës.

Punëdhënësit kanë për detyrë të mbajnë punëtorët e tyre të sigurt duke mbajtur vendin e punës të sigurte nga rreziqet.

Punonjësit adoleshent, gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e tyre dhe të tjerëve nga lëndimi dhe sëmundjet. MËSIMI 5B jep më shumë informacion mbi përgjegjësitë e të rinjve në punë.

Përgatitja

Lexoni

Materialin Nr. 9 të mësimdhënësit, në fund të këtij mësimi.

Përgatitni materialet

Prezantimin e sllajdeve 38-41 në PowerPoint, në kompjuter (me projektor)

Shfaqni

Sllajdet 38-41 në PowerPoint

Pasqyra e të dhënave A jeni një adoleshent i punësuar? (Materiali i nxënësve nr. 13)

Merrni

Një flipchart dhe markerë ose përdorni një tabelë të bardhë dhe markerë.

Shpërblime (të tilla si karamelë) për lojën “A i dini të drejtat tuaja”

Fotokopjoni

Materialin e nxënësve nr. 13 për secilin nxënës. Kërkoni nga nxënësit që secili ta ruajnë kopjen e tij/saj: Ata do ti përdorin këto me vone në mësimet 5B, 6 dhe 6B)

Materialin 9 për mësimdhënësit (në fund të këtij mësimi)

Kërkoni

Pagën minimale të shtetit tuaj. Shih Materialin 9 të mësimdhënësit në fund të këtij mësimi. Nxënësit, po ashtu, është dashur të hulumtojnë për këtë informacion, si pjesë e detyrave të tyre të shtëpisë për mësimin 4.

Plani i orës mësimore

Hapi 1

Shqyrtoni me klasën të drejtat e rëndësishme ligjore mbi mbrojtjen e të rinjëve në punë

5 minuta

Diskutim në klasë

Hapi 2

Diskutoni ligjet e veçanta të punës që ndikojnë në punën e adoleshentëve (Pasqyra e të dhënave, Materiali i nxënësve nr. 13).

5 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Hapi 3

Shqyrtoni dhe përforconi informacionet kryesore në lidhje me ligjet e punës për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së të rinjëve në punë.

30 minuta

Loja me pyetje Dini të drejtat tuaj

Hapi 4

Shqyrtoni dhe bëni një përmbledhje të pikave kryesore të mësimi.

5 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Udhëzime për realizimin e njësisë mësimore

Hapi 1:

Shqyrtoni me klasën të drejtat e rëndësishme ligjore mbi mbrojtjen e të rinjëve në punë

5 minuta

Shfaqni sllajdin 39.

Shpjegoni klasës se adoleshentët kanë të drejta të rëndësishme ligjore në punë.

Ligjet e punës për fëmijë mbrojnë adoleshentët që të mos punojnë me orë të gjata ose në orët e vona dhe është kundërligjore që adoleshentët të bëjnë disa punë të caktuara të rrezikshme. Ligji i shëndetit dhe sigurisë mbron nga rreziqet e punës të gjithë punëtorët, duke përfshirë edhe adoleshentët.

Shtroni pyetjet vijuese dhe diskutoni me nxënësit:

“Cila është paga minimale në vendin tonë?”

Përgjigje: Sipas Kontratës Kolektive paga minimale për të punësuarit deri në moshën 35 vjeçare është 130 Euro, ndërsa për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeçare është 170 Euro

Gjithashtu, kini parasysh se paga minimale mund të pësoj ndryshime me kohë prandaj konsultohuni edhe në ueb faqen e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale <http://www.rks.gov.net/mpms>. Diskutoni edhe përgjigjet e nxënësve, si pjesë të detyrave tyre shtëpiake nga mësimi 4 dhe interesohuni për burimet e informacionit që kanë shfrytëzuar nxënësit.

“A keni dëgjuar për ndonjë rast të lëndimit të adoleshenteve në punë?”

Diskutim

“Cilën agjenci mund ta thirrni për ta raportuar një problem të shëndetit dhe të sigurisë në punë?”

Përgjigje: Inspektoriat i Punës

Tregoni nxënësve se në aktivitetin vijues do të mësojnë më shumë për të drejtat e tyre ligjore.

Hapi 2:

**Diskutoni ligjet e veçanta të punës që ndikojnë në punën e adoleshentëve
(Pasqyra e të dhënave, Materiali i nxënësve nr. 13)**

5 minuta

Përgatisni klasën për lojën *Mësoni të drejtat tuaja*

Shpërndani materialin e nxënësve nr. 13 dhe kërkoni që ata ta analizojnë materialin për pak kohë.

Njoftoni nxënësit me temat që mbulohen në pasqyrën e të dhënave.

Hapi3:

Shqyrtoni dhe përforconi informacionet kryesore në lidhje me ligjet e shëndetit dhe sigurisë për punëtorët e rinj (*Loja- Mësoni të drejtat tuaja*)

30 minuta



Ndajeni klasën në grupe me nga tre deri në pesë nxënës.

Çdo grup/ekip duhet të zgjedh një emër. Shkruani emrat e ekipeve në krye të tabelës, duke bërë një kolonë për çdo ekip. Tabela do të shfrytëzohet për evidentimin e rezultateve (nga mësimdhënësi apo një nxënës vullnetar).

Shfaqeni sllajdin 40 dhe lejeni të shfaqur gjatë gjithë zhvillimit të lojës.

Shpjegoni rregullat në klasë:

Për përgjigjet, ekipet mund t'i referohen materialit nr. 13 të nxënësve.

Ekipi i parë do të zgjedh një kategori dhe shumën në euro nga tabela e lojës. Instruktori do të bëj pyetjen përkatëse.

Ekipi ka rreth 30 sekonda për të diskutuar çështjen dhe të dalë me një përgjigje.

Nëse ekipi i parë përgjigjet saktë, ai merr shumën e eurove për këtë pyetje. Mbajtësi i rezultatit do t'i shënojë rezultatet në kolonën e ekipit, në tabelë. Pastaj ekipi tjetër zgjedh një kategori dhe shumën eurove.

Nëse ekipi i parë përgjigjet gabimisht, ekipi tjetër në radhë do të thirret për t'iu përgjigjur të njëjtës pyetje. Kjo do të vazhdojë deri sa një ekip të jep përgjigjen e saktë, ose derisa të gjitha ekipet të pyeten. Ekipi që përgjigjet saktë fiton shumën e eurove. Nuk ka dënim për përgjigje të gabuara.

Nëse të gjitha ekipet gabojnë, instruktori do të japë përgjigjen e saktë.

Cilido që jep përgjigjen e saktë: ekipi apo vet mësimdhënësi, kaloni kohën e duhur për të shpjeguar përgjigjen. Disa pyetje mund të kenë disa përgjigje korrekte apo të plota.

Luani lojën. Ndiqni rregullat e mësipërme.

Mblidheni shumën e poenave që secili ekip ka fituar në fund të lojës.

Jepni shpërblime (të tilla si, karamelle, lapsa, postera) ekipit fitues.

Hapi 4:

Shqyrtoni dhe përmbledhni pikat kyçe të mësimi.

5 minuta



Shfaqni sllajdin 41 dhe diskutoni çështjet kryesore që janë trajtuar në këtë mësim.

Shqyrtoni këtë informacion me nxënësit:

Ligji i punës dhe UA i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale Nr. 01/2012 caktojnë një moshë minimale për lloje të caktuara të punëve të rrezikshme; përcaktojnë punët e detyrat e lejuara si dhe ato të ndaluara për personat nën moshën 18 vjeçare. Ato gjithashtu kufizojnë orarin e punës dhe punën e natës.

Ligji për siguri dhe shëndet në punë thotë që çdo punëdhënës duhet të kujdeset të posedoni atë që nevojitet për të qenë të sigurt:

- Një vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm.
- Trajnim, që të dini se si të trajtoni kimikatet dhe të merreni me rreziqet e tjera shëndetësore dhe të sigurisë në punë (në shumicën e rasteve).
- Pajisjet e nevojshme të sigurisë.

Qeveria vendos ligjet themelore të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës.

Me ligj, punëdhënësit nuk mund ti pushojnë nga puna punonjësit për arsye të raportimit të një problemi të sigurisë.

Rikujtoni nxënësit që të ruajnë materialin nr. 13 të kopjuar. Do ta përdorin përsëri për të përfunduar aktivitetet për mësimet 5B, 6, dhe 6B.

Përfundoni Mësimin 5 duke lexuar këtë mesazh:

“Legjislacioni për punën e fëmijëve mbron adoleshentët nga orët e gjata të punës, puna në orët e hershme të mëngjesit ose në orët e vona të natës dhe nga detyrat e rrezikshme në punë. Ligjet e shëndetit dhe sigurisë mbrojnë punëtorët nga rreziqet në punë. Të rinjtë mund të punojnë në mënyrë më të sigurt në qoftë se ata dinë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre! ”

(Në qoftë se anashkaloni mësimin 5B: “Në njësinë e ardhshme mësimore, ju do të mësoni se si të bisedoni me punëdhënësin tuaj për problemet që mund të dalin në punë.”)

Detyrat e shtëpisë

Në këtë njësi, nxënësit mësuajnë për të drejtat e tyre në punë, të përcaktuara nga ligjet e punës. Mësimi u fokusua në atë se çka punëdhënësit duhet të bëjnë për të mbajtur punëtorët të shëndetshëm dhe të sigurt.

Për detyrat e shtëpisë, nxënësit duhet të përdorin të paktën tri burime për të mësuar në lidhje me përgjegjësitë e rëndësishme që ata kanë në punë. Shembuj të përgjegjësiave të punëtorëve të rinj në punë përfshijnë këto:

- Të dinë dhe ndjekin të gjitha rregullat e sigurisë dhe të shëndetit.
- Të dinë se çfarë të bëjnë nëse ndodh një rast emergjent në punë.
- Të raportojnë të gjitha problemet në punë.
- Të ngrisin zërin nëse ka kërcënime, rrezik, apo ngacmim në punë.
- Të kërkojnë ndihmën e parë menjëherë, nëse lëndohen.
- Të përdorin veshje mbrojtëse dhe pajisje kur është e nevojshme.
- Të shmangin sjelljen e papërshtatshme / rrezikshme në punë.
- Të qëndrojnë të kthjellët dhe pa drogë në punë.

Më pas nxënësit duhet të shkruajnë një ese një faqe lidhur me këto përgjegjësi për një punë të supozuar. Nxënësit mund të intervistojnë dikë që punon (si p.sh. një prind, mësimdhënës) në lidhje me përgjegjësitë e tyre të shëndetit dhe sigurisë.

Nëse ju ligjëroni Mësimin 5B, ju mund të përfshini një diskutim të shkurtër të ideve të nxënësve rreth përgjegjësiave të tyre në punë (në Hapin 2).

TË DREJTAT TUAJA: KUIZI

PYETJET

| Vlera | Të drejtat në punë | Punët e lejuara dhe të ndaluara për personat 15-18 vjeçar | Kufizimet në orarin e punës | Puna e sigurtë |
|----------|---|---|---|---|
| 100 Euro | Përshkruaj një rast/situatë kur punëdhënësi nuk ka të drejtë të ju dënoj | Operimi me makineri bujqësore ndalohet për personat nën moshën... vjeç (plotëso) | Cilat ligje/akte nënligjore përcaktojnë masat mbrojtëse për punëtorët e moshës së re? | Në rast lëndimi në punë, ju duhet të ndërmirni këta hapa (plotëso dy) |
| 200 Euro | Cila është paga minimale në Kosovë? | Për personat nën moshën 18 vjeçare ndalohet operimi me këto pajisje (listo dy) | Deri në çfarë moshe gëzoni të drejta të veçanta të mbrojtjes në punë? | Cilat janë të drejtat tuaja në rast të lëndimit në punë? |
| 300 Euro | Numëro dy të drejta të punëtorit në rast se lëndohet në punë | Cilat punë janë të ndaluara për personat e moshës 15-18 vjeçare (listo 3) | Në sektorin formal, punonjësit e moshës 15-18 vjeçare nuk guxon të punojnë para orës ... në mëngjes (plotëso) | Cilat masa duhet aplikuar për të qenë i sigurtë në punë? (numëro dy) |
| 400 Euro | Numëro dy masa mbrojtëse të cilat punëdhënësi duhet të ju siguroj në punë | Cila është pesha maksimale e lejuar të ngritet nga personat e moshës 15-18 vjeçare | Në sektorin formal, punonjësit e moshës 15-18 vjeçare nuk guxon të punojnë pas orës ... në mbrëmje (plotëso) | Ku mund të lajmëroni rastet e shkeljes së orarit të kufizuar të punës dhe pagës minimale? |
| 500 Euro | Listo dy të drejta të punëtorëve në punë | Cilat janë aktivitetet e ndaluara për personat e moshës 15-18 vjeçare në sektorin e ndërtimitarisë? | Sa është numri i lejuar i orëve të punës në javë, për një person të moshës 15-18 vjeç? | Ku mund të lajmëroni rastet e rrezikut në punë, në rast se nuk keni mbështetjen e punëdhënësit? |

PËRGJIGJET

| Vlera | Të drejtat nëpunë | Punët e lejuara dhe të ndaluara për personat 15-18 vjeçar | Kufizimet në orarin e punës | Puna e sigurtë |
|----------|---|---|--|---|
| 100 Euro | Raportimi i një problemi të sigurisë në punë | 18 vjeçare | Ligji i Punës Ligji mbi Shëndetin dhe Sigurinë në Punë UA 01/2012 mbi Sistemimin e Punëve të lejuara dhe të Ndalura për personat 15-18 vjeç UA 05/2013 për parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës | Informo shëfin; merr trajtim mjekësor; plotëso një formë ankese |
| 200 Euro | Sipas Kontratës Kolektive paga minimale për të punësuarit deri në moshën 35 vjeçare është 130 Euro, ndërsa për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeçare është 170 Euro | Motorsharrë, motokultivator, traktor | 18 vjeç | Kompenzimi nga punëdhënësi |
| 300 Euro | E drejta për kompenzim të trajtimit mjekësor dhe e drejta për rrogat në mungesë (gjatë trajtimit mjekësor) | 1. Puna në ndërtimtari; 2. Puna në eksploatimin e pasurive natyrore (thëngjillit, gurit, rërës, zhavorit); 3. Puna në rrugë; 4. Puna në bastore dhe diskoteka; | 06.00 në mëngjes | Raportimi i kushteve të pasigurta të punës; Trajnimi për sigurinë në punë; Respektimi i rregullave të sigurisë; Veshja e pajisjeve personale mbrojtëse |
| 400 Euro | Vend punë të sigurtë; Trajnim për punë të sigurtë, për sektorë të caktuar; Pajisje personale mbrojtëse; | Ngritja dhe bartja e kohëpaskohshme e peshave të rënda mbi 15 kg (M) dhe 10 kg (F); Ngritja dhe bartja e vazhdueshme e peshave mbi 10 kg (M) dhe 5 kg (F); | 22.00 në mbrëmje | Inspektorati i Punës |
| 500 Euro | E drejta për të raportuar problemet e sigurisë; e drejta për mos diskriminim; e drejta për organizim të punëtorëve në sindikatë; | Gërmimi i dheut, transportimi i peshave të rënda, sitja e rërës dhe çimentos, puna në skela, përpunimi i metaleve. | 30 orë në javë | Inspektorati i Punës |

MËSIMI 5B

Dini të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja

Përforcimi i informacioneve të përvetësuara në lidhje me ligjet e sigurisë në punë dhe punës së të rinjëve. Ndhmoni nxënësit të kuptojnë përgjegjësitë e tyre në punë.



RINIA  **PUNË**

Diskutim për sigurinë

Qëllimi i orës mësimore

Përforcimi i informacioneve të përvetësuara në lidhje me ligjet e sigurisë në punë dhe punës së të rinjve

Rezultatet e pritura

Deri në fund të orës mësimore nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Diskutojnë për obligimet dhe përgjegjësitë në krijimin e një vendi të sigurt pune.
- Reflektojnë mbi nevojën për të konsideruar njëherazi si të drejtat edhe përgjegjësitë, kur të promovojnë sigurinë në vendin e punës.
- Evidentojnë dhe japin shembuj të përgjegjësive që promovojnë sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.

Ndërlidhja me rezultatet e përgjithshmetë modulit Siguria në Punë: 4, 5, 6, 7

Ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë-RNSh 4¹⁷: #I.1; # I.2; I.5; # I.8; # II.2; # II.4; # II.5; #II.7; # II.8; # III.1; # III.3; # III.7; # IV.2; # IV.3; # IV.4; # IV.7; # V.1; # V.3; # V.6; # VI.1; # VI.3; # VI.4; # VI.5; # VI.6; # VI.8;

Ndërlidhja me RNF Gjuhët dhe komunikimi: # I.1; # I.2; # II.2; # III.1;

Ndërlidhja me RNF Shkencat e natyrës: # III.5; # III.6;

Ndërlidhja me RNF Shoqëria dhe Mjedisi: # I.1, # III.1; IV.1;

Ndërlidhja me RNF Shëndeti dhe mirëqenia: # I.1; # I.3; #VII.1

Ndërlidhja me RNF Jeta dhe Puna: # I.1; # III.1; # VI.1; # VII.1

Shënim:

- ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë dhe me RNF vlen për nivelin e mesëm të ulët-shkallën kurrikulare 4;
- për aplikimin e modulit në shkollat profesionale dhe në gjimnaze, respektivisht në nivelin e mesëm të lartë-shkallën kurrikulare 5 luteni që ndërlidhjen ta identifikoni nga Kurrikulat Bërthamë për nivelet përkatëse.

¹⁷ Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët

Çështjet kryesore që duhen të mirren parasysh

Mësimi 5 fokusohet në detyrimet ligjore të punëdhënësve për të ofruar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të punës për të gjithë punonjësit, përfshirë punëtorët e rinj. Në këtë mësim, ju do të ndihmoni nxënësit të kuptojnë se edhe ata kanë përgjegjësi në punë për të mbajtur veten dhe të tjerët të sigurtë dhe për t'iu shmangur lëndimeve ose sëmundjeve.

Punëtorët e rinj kanë të drejta, por ata gjithashtu kanë përgjegjësi të ndjekin rregullat e sigurisë dhe shëndetit ku ata punojnë. Për shembull, në situatat kur punëtorët duhet të mbrojnë dëgjimin nga zhurma e madhe, punëdhënësit e kanë obligim t'i pajisin punëtorët me mbrojtëse të veshëve. Nga ana tjetër, punëtorët janë të obliguar që ti vendosin kufjet që punëdhënësi u ka dhënë atyre.

Përgatitja

Lexoni

Tabelat e lojës Bingo e Ligjit të Punës (nga #1 deri 13#), në Materialin 14 të nxënësit

Shfaqni

Sllajdin 41- 44 në PowerPoint

Përgatitni materialet

Një prezantim në PowerPoint për sllajdet 41 - 44 në një kompjuter (me projektor)

Merrni

Një flipchart dhe markerë, ose përdorni një tabelë të bardhë dhe markerë

Shpërblime (si karamelle) për lojën *Bingo të Ligjit të Punës*

OSE

Nëse jeni duke përdorur aktivitetin Njoftimi për Shërbime Publike në vend të lojës Bingo, disa fletë të tabelës për poster (ose letra të mëdha).

Fotokopjoni

Tabelat e lojës *Bingo të Ligjit të Punës* (nga #1 deri #13), të ofruar në Materialin 14 të Nxënësit. (Çdo ekip do të marrë një tabelë.)

Bëni kopje shtesë të Materialit 13 të nxënësit (*A jeni një adoleshent që punon?* Pasqyra e të dhënave) për nxënësit të cilët kanë gabuar renditjet e materialeve të tyre nga mësimi 5. Shënim: Kujtojuni nxënësit që t'i ruajnë këto kopje. Ato do t'i përdorin përsëri në mësimet 6 dhe 6B.

Shënim i instruktorit: Informacioni në Materialin 13 të nxënësit pasqyron ligjet e punës. Konsultohuni me agjencitë e shtetit tuaj të listuara në faqen 6 të pasqyrës së të dhënave.

Shqyrtoni

Pagën minimale të shtetit tuaj (shih: ueb faqen e internetit të MPMS-së: <http://www.rks-gov.net/mpms> ose kontaktoni Inspektoratin e Punës).

Plani i orës mësimore

Hapi 1

Shqyrtoni pikat kryesore nga mësimi i mëparshëm

5 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Hapi 2

Shqyrtoni përgjegjësitë që të rinjtë kanë në punë

10 minuta

Ligjëratë e shkurtër, diskutim në klasë

Hapi 3

Përforconi njohuritë e nxënësve ndaj çështjeve të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës dhe shqyrtoni mbrojtjet ligjore që kanë të rinjtë në punë. Aplikoni në një projekt atë që nxënësit tashmë dinë për sigurinë në vendin e punës dhe ligjet e punës

25 minuta

Loja Bingo e Ligjit të Punës ose Aktiviteti* Njoftim për Shërbime Publike

*Si një alternativë, në vend të lojës ju mund të zhvilloni aktivitetin NjShP (të përshkruar në seksionin e Detyrave të shtëpisë).

Hapi 4

Shqyrtoni dhe jepni një përmbledhje të pikave kryesore të mësimit

5 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Udhëzime për realizimin e njësisë mësimore

Hapi 1:

Shqyrtoni me klasën të drejtat e rëndësishme ligjore mbi mbrojtjen e të rinjëve në punë

5 minuta



Shfaqni sllajdin 41 në PowerPoint.

Rikujtoni nxënësit në lidhje me ligjet që zbatohen për mbrojtjen e tyre nëpunë:

Ligjet e punës caktojnë një moshë minimale për lloje të caktuara të punës së rrezikshme. Ato caktojnë punët e lejuara dhe të ndaluara për personat nën moshën 18 vjecare si dhe mbrojtje adoleshentët nga orët e gjata të punës, puna natën dhe puna në orët e hershme të mëngjesit.

Legjislacioni i punës obligon çdo punëdhënës që të siguroj kushte të sigurta pune, përfshirë:

- Një vend të sigurtë dhe të shëndetshëm pune
- Trajnim mbi përdorimin e kimikateve dhe rreziqeve tjera për shëndetin dhe sigurinë në punë
- Pajisjet mbrojtëse për punëtorët të cilët duhet të bëjnë punën

Me ligj, punëdhënësit nuk mund të largojnë apo të ndëshkojnë punonjësit për raportimin e një problemi të sigurisë në punë.

Hapi 2:

Shqyrtoni përgjegjësitë që të rinjtë kanë në punë.

10 minuta

Informoni nxënësit se të gjithë duhet të punojnë së bashku për të parandaluar lëndimet

Punëdhënësit duhet t'i japin punëtorëve të rinj trajnimin për sigurinë që ligji e kërkon. Punëtorët e rinj duhet të kenë mbikëqyrjen e duhur në punë. Punëdhënësit gjithashtu duhet të iu binden të gjitha ligjeve dhe rregullave shtetërore që zbatohen për punëtorët e rinj. Mbikëqyrësit duhet të sigurohen që punonjësit ndjekin të gjitha rregullat dhe rregulloret e sigurisë.

Nxënësit, gjithashtu, duhet ta kuptojnë pjesën e tyre të përgjegjësisë

Kërkoni nga vullnetarët që të flasin shkurtimisht për përgjegjësitë në punë që ata kanë shkruar në esetë një faqeshe të detyrave të shtëpisë.

Mbani një listë të ideve që prezantohen nga nxënësit në tabelë ose në një flipchart.

Më poshtë janë dhënë disa nga përgjegjësitë që adoleshentët kanë në punë:

- Të dinë dhe ndjekin të gjitha rregullat e sigurisë dhe të shëndetit.
- Të ndjekin praktika të sigurt në punë, sipas udhëzimeve të punëdhënësit ose mbikëqyrësit.
- Të dinë se çfarë duhet bërë nëse ndodh një rast emergjent në punë
- Të raportojnë të gjitha lëndimet. Të marrin ndihmën e parë menjëherë.
- Të përdorin veshjet dhe pajisjet mbrojtëse. Për shembull, të mbajnë kufje për vesh kur punojnë në vende me zhurmë të lartë.
- Të përdorin mjetin e duhur për punë. Ta përdorin atë saktë dhe sigurt.
- T'i tregojnë dikujt nëse vërejnë pajisjen ose makinën e thyer
- Të kërkojnë ndihmë në ngritjen e peshave të rënda. Të përkulen në gjunjë me rastin e ngritjes së peshave.
- Të marrin iniciativën. Të bëjnë sugjerime që përmirësojnë sigurinë në punë.
- T'i kushtojnë vëmendje mjedisit. Të jenë të kujdesshëm në çdo kohë. Të mos rrezikojnë.
- Të shmangin egërsinë ose sjelljet e papërshtatshme /të rrezikshme në punë.

- Të qëndrojnë esëll dhe pa drogë. Përdorimi i drogës dhe alkoolit nuk janë kurrë të pranueshme në vendin e punës. Punëtorët që pinë apo përdorin drogë kanë më shumë gjasa që të lëndohen në punë.

Besoni instinkteve tuaja. Kurrë mos bëni diçka që duket e pasigurt ose e pakëndshme. Diskutoni me një mbikëqyrës, një tjetër punonjës, ose zyrtar të sigurisë para se të bëni një detyrë që është e re për ju.

Kërkoni përgjigje në pyetjet tuaja nëse jeni të hutuar apo të pasigurt se si të punohet në mënyrë të sigurt. Bëni pyetje të tilla si:

- Çfarë trajnimi të sigurisë në punë do të marr?
- Cilat janë rreziqet e mundshme?
- Cilat janë planet emergjente për këtë vend pune?
- A do të më duhet të vesh pajisje mbrojtëse? Nëse po, si duhet t'i përdorë ato?
- Kujt mund t'i drejtohem në lidhje me shqetësimet e mia shëndetësore dhe të sigurisë?
- Çfarë duhet të bëj nëse lëndohem në punë?

Bisedoni me mbikëqyrësin! Ose nëse është e nevojshme me prindin ose një të rritur në qoftë se ju shihni rreziqe në punë.

- Nëse një punëdhënës nuk i adreson shqetësimet e sigurisë, raportoni kushtet e rrezikshme në IP (nëse kufizimi i moshës për punë të rrezikshme është duke u shkelur), ose agjencitë shtetërore të listuara në Materialin 13 të Nxënësve.
- Raporto diskriminimin. Kjo përfshin ngacmimin për shkak të racës, ngjyrës, fesë, gjinisë (përfshirë shtatzëninë), origjinës kombëtare, aftësisë së kufizuar, apo tjetër. Ju mund të kontaktoni IP.
- Mos harroni, ligji ju mbron nga dënimi për raportimin e shqetësimeve të sigurisë ose diskriminimit. Duke lëvizur përpara dhe duke thënë diçka, ju i ndihmoni vendit tuaj të punës të jete me i sigurt për ju dhe koleget tuaj.

Hapi 3:


Shqyrtoni dhe përforconi njohuritë e nxënësve në lidhje me ligjet për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së të rinjëve në punë

25 minuta



Shfaqni sllajdin 40 në PowerPoint. Informoni nxënësit se tani do të luajnë një lloj të veçantë të lojës *Bingo*.

Shpjegoni se secili nxënës do të punojë me një partner në këtë aktivitet. Ndajeni klasën në cifte.




Jepini secilit çift një tabelë *Bingo* nga Materiali 14 i Nxënësit.

Shënimi: Tabelat 2, 3, 4, dhe 5 do të japin fituesin pas 10 pyetjeve të para; tabelat 9 dhe 11 do të japin fituesit pas pyetjes 21. Sigurohuni që të përshkruani së paku një tabelë fituese për çdo raund të lojës.

Furnizoni secilin ekip me pjesët e lojës.

Lojtarët do t'i përdorin për të mbuluar katrorët në tabelën e tyre, pasi të kërkojnë përgjigjet.

TREGIMI I ELENES



Diskutim për sigurinë
Mësimi 5B për mësimin

SKENA: Dyqan sandoçesh. Elena është një 15 vjeçare, moshëzotë e shkollës së mesme, Z. Xhonsori është mbikëqytari i saj dhe Xhori është një nga kolegët e saj. Është e orjës mbrëmje.

Z. Xhonsori: Elena, Andre kalimëruar se nuk mund t'ju bërë punëgjatë është i sëmurë, kështu që kam nevojë që të punosh disa orë shtesë. Sotmë duhet të qëndrosh deri në orën 22.00.

Elena: Por, Z. Xhonsori, unë kam test nesër dhe më duhet të jem në shtëpi për të studiuar.

Z. Xhonsori: Më të vërtetë më vjen keq, por ky është rast urgjent. Nëse don të punosh këtu, duhet të jesh e gatimë që të punosh kur kemi nevojë për ty.

Elena: Por unë kam një kushinë të quajtur Andre më parë.

Z. Xhonsori: Si për, s'kujtohet prapa barikut dhe merri me porositë e sendiqeve për një kushinë. Kështu nga Xhori që të tregoj se si përdori mallin për prapen e riutit. Pastaj, kur të përfundosh prapen, s'kujtohet prapen në ditën e furnizimit. Disa nga pajisjet për prapen janë dorëzuar dhe bari bari mënyrë.

Më vonë: Elena merr lekat dhe shkon në dhomën e furnizimit.

Elena: Ha, Xhori! A e din se çka bari dorëzuar në dyqanin?

Xhori: Nuk kam idë. Vëdim kë kujtë që të moshë e prekë me dur. Duhet të bari dorëzuar në goftë se gen. Andre mori një skuqe të shkurtë nga ato gjëra për të kaluar.

ZHVILLIMI I ROLIT TUAR

- Diskutoni me klasën cilat nga juat janë detyra e shkolës tuaj.
- Punoni me grupin tuaj të vogël për të dalë me një fletë për të kësaj tregim. Zgjidhni një problem në tregim dhe përqendroni në të. Mendoni për këto tre pyetje:
 - Si duhet të qaset Elena mbikëqytari të saj në kthje me këto probleme?
 - Si mund të reagoj mbikëqytari i saj?
 - Ku gjë mund të merri Elena?
- Ushtroni skenën tuaj, ju do të performoni për klasën më vonë.

Rinia në punë: Diskutim për sigurinë 237

Shpjegoni lojën.

Vini re se pyetjet kanë të bëjnë me ligjet e sigurisë së punës dhe punën e fëmijëve. Pas çdo pyetje, nxënësit duhet t'i kujtojnë përgjigjet e mundshme. Për të gjetur përgjigje, ata mund t'i referohen Materialit 13 të Nxënësit, *A jeni një adoleshent që punon?* Pasqyra e të dhënave. Nëse klasa nuk ka përgjigje të saktë, mësimdhënësi duhet të japë përgjigjen (shih: Materialin 10 për mësimdhënësit, në fund të këtij mësimi).

Tregoni ekipeve se në qoftë se ata kanë një përgjigje të saktë në tabelën e tyre, ata duhet ta mbulojnë atë me një nga pjesët e tyre të lojës. Vini re se disa pyetje kanë disa përgjigje të sakta.

Shpjegoni se ekipi i parë që ka një rresht të përgjigjeve të sakta fiton. Rreshti mund të jetë horizontal, vertikal apo diagonal. Gjithkush mund të llogarisë qendrën kryesore të tabelës së tij ose të saj, e cila është një "hapësirë e lirë."

Hapi 4:

Përmbliidhni pikat kryesore të mësimi.

5 minuta

Rikujtoni nxënësit se të rinjtë gëzojnë të drejta dhe mbrojtje të veçantë në punë.

Përsëritni faktin se edhe ata kanë përgjegjësi të rëndësishme në punën që do të iu ndihmojë atyre të mbajnë veten dhe koleget e tyre të sigurt dhe të shëndetshëm.

Rikujtoni nxënësit që të mbajnë fotokopjet e Materialit 13 të nxënësit. Ato do t'i përdorin përsëri për t'i përfunduar aktivitetet e Mësimi 6 dhe 6B.

Përfundoni mësimin 5 duke lexuar këtë mesazhi:

“Ligjet shtetërore të shëndetit dhe sigurisë mbrojnë adoleshentët nga rreziqet në punë. Punëdhënësit kanë një përgjegjësi për të mbajtur punëtorët e tyre të sigurt.

Punëtorët adoleshent, gjithashtu, janë përgjegjës për të mbrojtur veten dhe të tjerët nga lëndimi dhe sëmundjet në punë.”

Të rinjtë mund të punojnë më sigurt në qoftë se ata dinë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre!

Në mësimin e ardhshëm, ju do të mësoni se si të bisedoni me punëdhënësin tuaj për problemet që mund të dalin në punë.

Detyrat e shtëpisë

Aktiviteti *Informimi i publikut*

Nxënësit duhet të krijojnë një njoftim në lidhje me të drejtat e punëtorëve të rinj, për shtyp ose për media elektronike. Njoftimi mund të jetë i shkruar, 30-sekonda video për televizion apo radio, apo një dizajn për një billboard apo poster. Nëse jeni duke përdorur këtë aktivitet si një caktim detyrash të shtëpisë, zgjidhni një apo dy njoftime për t'i ndarë me klasën, herën tjetër kur të takoheni.

Pyetje dhe Përgjigje Bingo për Ligjin e Punës

Filloni raundin e parë. Lexoni pyetjet e Bingos më poshtë.

1. Sa është paga minimale në shtetin tonë?

Paga minimale në Kosovë për të punësuarit deri në moshën 35 vjeçare është 130 Euro, ndërsa për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeçare është 170 Euro (kërkoni nga nxënësit të plotësojnë në tabelat e Bingos informacionin për pagat minimale të shtetit tuaj, gjetur në Materialin #14 të Nxënësit).

2. Përmendni një lloj të makinerive që ju nuk mund të përdorni në qoftë se jeni nën moshën 18 vjeçare.

Përgjigjet (e gjetura në tabela) përfshijnë prerësen e mishit, pirun vinçin, grirësen e letrës.

3. Përmendni një rrezik të zakonshëm në punët e pastrimit.

Përgjigjet (e gjetura në tabela) përfshijnë produktet për pastrim, gjilpërat e hedhura.

4. Përmendni një detyrë që një punëtor më i ri se 18 vjeç nuk mund ta bëjë me ligj.

Përgjigjet (e gjetura në tabela) përfshijnë ngarkimin ose shkarkimin e kamionëve, operim me makineri bujqësore, prerje të drunjëve, miniera (UA i MPMS-së Nr. 01/2012).

5. Nëse jeni të moshës 15-18 vjeçare në shtetin tonë, sa orë mund të punoni në një ditë të shkollës?

Fondi javor maksimal i lejuar për personat e moshës 15-18 vjeçare është 30 orë. Për personat të cilët ndjekin shkollimin, orari ditor nuk guxon të intereferoj me vijimin e shkollës.

6. Përmendni një rrezik të zakonshëm në punën në zyrë.

Përgjigjet (e gjetura në tabela) përfshijnë performancën e dobët të kompjuterëve punues, stresin, lëvizjet e përsëritura.

7. Nëse i përkisni moshës 15 vjeçare në shtetin tonë, deri sa orë mund punoni gjatë një jave shkollore?

30 orë.

8. Përveç përdorimit të pajisjeve personale mbrojtëse përmendni një gjë që ju mund të bëni për të parandaluar një lëndim në punë.

Përgjigjet (e gjetura në tabela) përfshijnë ndjekjen e rregullave të sigurisë, trajnimet për siguri, raportimin e kushteve të pasigurta, vlerësimin e rreziqeve në vendin tuaj të punës.

9. Me ligj, kush është përgjegjës për të siguruar një vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm?

Punëdhënësi.

10. Sa vonë mundet një 16 dhe 17 vjeçar në shtetin tonë të punoj në një ditë ditë pune?

22:00.

Jepni çmimet për fituesit e raundit të parë. Kërkojuni ekipeve t'i pastrojnë tabelat e tyre të *Bingos*.

Filloni raundin e dytë. Lexoni pyetjet e Bingos më poshtë.

11. Gjatë vitit shkollor, sa vonë mundet një 15 vjeçar të punoj gjatë natës në shtetin tonë?

22:00

12. Në shtetin tonë, në qoftë se jeni nën moshën 18 vjeçare a ju duhet një leje pune përpara se të filloni një punë të re?

Po.

13. Çfarë duhet të bëni në qoftë se lëndoheni në punë?

Tregoni mbikëqyrësit tuaj menjëherë, merrni trajtim të përshtatshëm, plotësoni formularin e kërkesës së punonjësve për kompensim (një përgjigje).

14. Kush ka më shumë gjasa të lëndohet në punë, punëtorët e rinj apo punëtorët e rritur?

Punëtorët e rinj.

15. Cilat janë disa nga punët që legjislacioni thotë se ju mund t'i bëni edhe nëse jeni nën moshën 18 vjeçare?

Punët që nuk i takojnë profesioneve bujqësore dhe industriale, në shërbimet postare dhe të telekomunikacionit, ndërmarrjet e gazetave (shpërndarja dhe shërbimet e shpërndarjes);

16. Cila është koha më e hershme që një 16 apo 17 vjeçar në shtetin tonë është i lejuar të fillojë punën në mëngjes?

06.00

17. Cila është agjencia shtetërore me të cilën mund të konsultoheni për orarin e lejuar të punës dhe llojin e punës që ju mund të bëni?

Inspektorati i Punës

18. Cila është agjencia shtetërore që merret me ankesat për sigurinë në vendin e punës?

Inspektorati i Punës

19. Çfarë emri ka agjencia shtetërore që merret me ankesat për diskriminim racor apo ngacmim seksual?

Inspektorati i Punës

20. Çka mbulohet me kompenzimin e punëtorëve?

Trajtimi mjekësor dhe pagat e humbura (një përgjigje).

21. Përmendni disa lloje të pajisjeve personale mbrojtëse që mund të ju mbrojnë nga lëndimet apo sëmundjet në punë.

Përgjigjet (e gjetura në tabela) përfshijnë kufjet për vesh, dorezat, syzet e sigurisë, dhe veshjet mbrojtëse.

Dhënia e çmimeve për fituesit e raundit të dytë.

MËSIMI 6

Ndërmarrja e Veprimit

Ndihmon nxënësit të aplikojnë atë që kanë mësuar në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës. Jepni mundësi nxënësve që të ushtrjnë komunikimin me punëdhënësit për problemet në punë.



RINIA  PUNË

Diskutim për sigurinë

Qëllimi i orës mësimore

Zbatimi i informacioneve të përvetësuara për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.

Rezultatet e pritura

Deri në fund të orës mësimore nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë se diskutimet e hapura me të tjerët për problemet në vendin e punës shpjen në zgjidhje;
- Kuptojnë se punëdhënësit duhet të ju ofrojnë një vend të sigurtë dhe të shëndetshëm pune;
- Kuptojnë se punonjësit e rinj kanë përgjegjësi të flasin me punëdhënësit, kolegët, përfaqësuesit e sindikatave, ose përgjegjësit tjerë për problemet; në qoftë se ndihen të pasigurt në punë, apo nëse kanë pyetje duhet të ndalojnë dhe kërkojnë këshilla;
- Demonstrjnë aftësinë për të zgjidhur një problem në punë dhe për të luftuar për sigurinë personale dhe të kolegëve;
- Komunikojnë për të gjetur zgjidhje për problemet e përbashkëta të cilat cenojnë sigurinë personale dhe të kolegëve.

Ndërlidhja me rezultatet e përgjithshme të modulit Siguria në Punë: 3, 4, 8

Ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë-RNSh 4¹⁸: #I.1; # I.3; # I.4; # I.7; # II.1; # II.4; #II.6; # II.7; # III.2; # III.4; # III.8; # IV.1; # IV.2; # IV.6; # V.3; # V.6; # V.9; # VI.1; # VI.3; # VI.4; # VI.8.

Ndërlidhja me RNF Gjuhët dhe komunikimi: # I.4(2); # II.4(2)

Ndërlidhja me RNF Shkencat e natyrës: # I.1

Ndërlidhja me RNF Shoqëria dhe Mjedisi: # IV.1; # V.1

Ndërlidhja me RNF Shëndeti dhe mirëqenia: #II.2; # V.2;# VI.1

Ndërlidhja me RNF Jeta dhe Puna: # 1.4(1); # 1.4(2), # 3.4(1); # 4,4(1); # 6,4(1); # 7,4(1);

Shënim:

- ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë dhe me RNF vlen për nivelin e mesëm të ulët-shkallën kurrikulare 4;
- për aplikimin e modulit në shkollat profesionale dhe në gjimnaze, respektivisht në nivelin e mesëm të lartë-shkallën kurrikulare 5 luteni që ndërlidhjen ta identifikoni nga Kurrikulat Bërthamë për nivelet përkatëse.

¹⁸ Kurrikulabërthamëpërsimim e mesëmtëulët

Çështjet kryesore që duhen të mirren parasysh

Të rinjtë zakonisht përqipen shumë për ta realizuar punën sa më mirë

Ata mezi presin ta dëshmojnë veten e tyre. Për fat të keq, ky tipar pozitiv mund t'i lëndoj ata në qoftë se marrin punë ose detyra që i ndalon ligji, ose nëse bëjnë punë për të cilat nuk janë përgatitur që t'i ushtrojnë në mënyrë të sigurtë.

Në këtë mësim, vazhdimisht rikujtoni nxënësit se ata kanë të drejta në punë

Ata kurrë nuk duhet të hezitojnë për të kërkuar ndihmë ose për të bërë pyetje në lidhje me një detyrë që duket e rrezikshme, e pakëndshme, ose potencialisht e paligjshme. Adoleshentët shpesh kanë instinkte të mira.

Nëse të rinjtë kanë një problem në punë, ata zakonisht hezitojnë që të përballen me punëdhënësin e tyre.

Kjo është në rregull. Inkurajoni nxënësit tuaj që t'i diskutojnë shqetësimet e tyre me ndonjë të rritur - prind, mësimdhënës, drejtor, ose koleg. Këta njerëz mund t'iu japin nxënësve këshilla të mira dhe udhëzime se ku duhet të drejtohen për ndihmë. Në disa raste, ata mund të jenë në gjendje që t'i ndihmojnë drejtpërdrejt.

Nxënësit duhet të kuptojnë se ata nuk duhet të jenë të heshtur kur përballen me probleme në punë.

Problemet mund të përkeqësohen dhe ata, apo të tjerët përreth, mund të lëndohen.

Përgatitja

Lexoni

Materialin Nr. 11 për mësimdhënësit, në fund të këtij mësimi

Përgatitni materialet

Një prezantim në PowerPoint për sllajdet 42-44 në një kompjuter (me projektor)

Shfaqni

Sllajdet në 42-44 në PowerPoint

Skeçet e shkurtra në Materialin Nr.11, në fund të këtij mësimi

Merrni

Një tabelë dhe markerë, ose përdorni një tabelë të bardhë dhe markerë

Fotokopjoni

Materialin 13 të Nxënësit, A jeni një adoleshent që punon? Pasqyra e të dhënave (përdorur në Mësimin 5 dhe 5B), një për secilin nxënës

Shënim: Nëse ligjëroni Mësimin 6B, kërkoni nga nxënësit që të mbajnë kopjet e tyre të Materialit 14 të Nxënësit për t'i përdorur në orën e ardhshme.

Materiali 16 i Nxënësit, Raporti i Vlerësimit, një për secilin nxënës

Shënim: Nëse planifikoni për të ligjëruar Mësimin 6B, ju do të shpërndani nga një kopje të raportit të vlerësimit në fund të mësimit të ardhshëm.

Plani i orës mësimore

Hapi 1

Diskutoni disa hapa të cilët ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve në punë.

10 minuta

Diskutim në klasë

Hapi 2

Reagoni në situatat që mund të paraqesin probleme për sigurinë dhe shëndetin në punë

20 minuta

Skeçe të shkurtra*

* Luajtja e roleve të përfshira në Hapin 2 mund të jetë sfiduese për disa mësimdhënës. Ju mund të vendosni që ta përdorni ose jo këtë teknikë. Si një alternativë, ju mund t'i lexoni skenarët me zë të lartë dhe t'i diskutoni ato në grup.

Hapi 3

Shqyrtoni dhe jepni një përmbledhje për pikat kryesore të mësimi. Shkurtimisht diskutoni projektet përfundimtare.

10 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Hapi 4

Shpërndani nxënësve testin që t'aplotësojnë, vlerësoni nivelin e njohurive të përvetësuar

5 minuta

Udhëzime për realizimin e njësisë mësimore

Hapi 1:

Diskutoni disa hapa të cilët ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të sigurisë në punë

10 minuta

Filloni orën duke kërkuar nga një ose dy nxënës që të prezantojnë detyrat e shtëpisë për njoftimin publik mbi sigurinë e punëtorëve të rinj



Prezantoni Mësimin, duke përdorur sllajdin 42 në PowerPoint.

Tregoni nxënësve se tani ata do të praktikojnë se çfarë duhet të bëjnë kur një problem i sigurisë lind në punë. Ata me këtë rast do të përdorin informacionet dhe shkathtësitë e përvetësuar për identifikimin e rreziqeve, kontrollimin e rreziqeve për t'i parandaluar lëndimet, informatat mbi të drejtat ligjore, dhe agjencitë/institucionet ku mund të drejtohen për ndihmë.


Kjo mund të ndihmojë për t'ia përkujtuar nxënësve tuaj se punëtorët e rinj zakonisht përpiqen shumë për të bërë një punë të mirë për punëdhënësit. Për fat të keq, kjo mund të shpie në lëndim. Një punëdhënësi mund të përfitoj nga vullneti i tyre për të bërë gjithçka, si edhe ato punë që nuk janë ligjore për ata ose për të cilat ata nuk janë të trajnuar si duhet. Shumica e punëdhënësve nuk do t'i vënin të rinjtë në rrezik, por ka shumë raste kur punëdhënësit kanë lejuar punëtorët e rinj që të bëjnë detyra për të cilat nuk janë përgatitur. Ndonjëherë rezultatet kanë qenë fatale. (Shih ngjarjet në Mësimin 3).

Diskutoni me klasën njërin prej shembujve. Shembulli mund të jetë edhe nga përvoja e vet nxënësve apo ndonjë rast real për të cilin ata kanë dëgjuar.

Filloni me pyetjen:

Çfarë hapash duhen ndërmarrë për të zgjidhur këtë problem?

Në tabelë, bëni një listë të hapave që nxënësit përmendin. Përpiquni që shënimet tuaja të jenë të përgjithsuara, si hapa të përgjithshëm që mund të vlejshëm në cdo situatë të ngjajshme.



Shfaqni sllajdin 43 në PowerPoint.

Sllajdi liston disa nga hapat për zgjidhjen e problemeve në vendin e punës.

Diskutoni ata me klasën.

Përshkruani qartë problemin ose problemet. Ky është hapi i parë drejt zgjidhjes.

Merrni këshilla nga prindi, mësimdhënësi, ndonjë person tjetër i rritur ose kolegë. Shih nëse ai person ka ide se si duhet të trajtohet problemi dhe si do të ndihmojë. Nëse ka një sindikatë në vendin tuaj të punës, ju mund gjithashtu të kërkonti ndihme nga sindikata¹⁹.

Vendosni qëllimet tuaja. Mendoni për atë që ju doni të arrini.

Njihni të drejtat tuaja. Familjarizohuni me orarin e lejuar të punës dhe llojet e punës që mund të kryhen nga punonjësit e moshës 15-18 vjecare. Familjarizohuni gjithashtu me të drejtat tuaja për mbrojtje dhe siguri në punë.

Zgjidhni mënyrën më të mirë për të diskutuar me mbikëqyrësin. Përgatituni çfarë të thoni dhe nëse do të merrni dikë kur të bisedoni me mbikëqyrësin.

Kontaktoni një agjenci të jashtme për ndihmë (nëse është e nevojshme). Në qoftë se vazhdoni të keni probleme edhe pasi të keni biseduar me mbikëqyrësin tuaj, merrni ndihmë nga dikush që i besoni. Nëse gjithë të tjerët dështojnë, ju mund të kontaktoni institucionin përkatës (p.sh. inspektoratin e punës).

¹⁹ Sindikata është një organizim i punëtorëve në ndërmarrje, për një sektor apo më gjerë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Hapi 2:

Reagoni në situatat që mund të paraqesin probleme shëndetësore dhe të sigurisë për punëtorët e rinj (skeçe të shkurtra).

20 minuta

Përgatisni klasën për lojën *Mësoni të drejtat tuaja* duke mësuar më shumë për të drejtat që adoleshentët e punësuar kanë në punë.

Shpërndani materialin e nxënësve nr. 13 dhe kërkoni që ata ta analizojnë materialin për pak kohë.

Njoftoni nxënësit me temat që mbulohen në pasqyrën e të dhënave.

Shpjegoni aktivitetin.

Tregojuni nxënësve se klasa do të bëjë disa skeçe në lidhje me punën.

Shpjegoni se ju (mësimdhënësi), do të luani rolin e “shëfit.” Për çdo skeç, ju do të kërkoni një vullnetar për të luajtur rolin e një “punëtori”.

Filloni me një praktikë të luajtjes së roleve.

Kërkoni nga një vullnetar që t’iu ndihmoj të aktroni ngjarjen e mëposhtme.

Mësimdhënësi: Ju punoni në një dyqan ushqimor si një paketues. Unë jam menaxher i dyqanit. Unë kërkoh nga ju për të ndihmuar në dyqan duke bërë pastrimin e prerësit të mishit. Ju kurrë nuk e keni bërë këtë punë më parë dhe ju jeni nën moshën 18 vjeçare. Cili është problemi këtu? Çfarë do të më thoni?

Nxënësi (roli i punëtorit): Unë nuk di se si ta bëjë këtë punë, dhe nuk jam i sigurt se si duhet bërë kjo, sepse unë jam nën moshën 18 vjeçare. Unë do të isha i gatshëm për të ndihmuar në tjetër mënyrë pasi që ky aktivitet është i ndaluar me ligj për personat nën moshën 18 vjeçare.

Sigurohuni që nxënësit kanë ende kopjet e tyre të materialit 13 për nxënësin, pasqyra e të dhënave të përdorura në mësimin e mëparshëm.

Duhet të keni më shumë kopje në dispozicion. Le të dinë nxënësit se ata mund t'i përdorin këto gjatë luajtjes së rolit nëse është e nevojshme.

Gjeni ngjarjet në Materialin 11 përmësimdhënësit, në fund të këtij mësimi.

Filloni me luajtjen e roleve.

Së pari, lexoni ngjarjen në klasë dhe flisni pak për çështjet që ajo ngrit. Më pas, kërkoni nga nxënësi vullnetar që të reagoj ndaj kërkesës tuaj. Atëherë ju duhet të përgjigjeni në një mënyrën që një shef i vërtetë do të përgjigjej.

Prezantoni sa më shumë ngjarje brenda kohës në dispozicion. Kërkoni vullnetar të rinj që të luajë rolin e «punëtorit» çdo herë që ju prezantoni një ngjarje të re në klasë.

Pas përfundimit të secilës ngjarje, pyesni klasën nëse ata kanë ndonjë gjë tjetër për të thënë.


Hapi 3:

Bëni një përmbledhje të pikave kryesore të mësimi. Diskutoni shkurtimisht projektet përfundimtare që janë caktuar në fund të mësimi 3

10 minuta

Rikujtoni nxënësit se gjatë këtij mësimi ata kanë mësuar se si të shprehen në mënyrë efektive kur kanë një problem në punë.

Rikujtoni nxënësit se ata duhet të dinë të drejtat e tyre, por ata gjithashtu duhet të mendojnë se si t'i qasen mbikëqyrësit të tyre kur përballen me një problem. Ata mund të dëshirojnë të bisedojnë së pari me prindërit e tyre, mësimdhënësit, koleget, përfaqësuesin e punëtorëve (nëse ekziston) apo dikë tjetër të cilit ata i besojnë. Në qoftë se ata kanë nevojë për ndihmë, ata mund të kontaktojnë IP i cili mbikëqyrë zbatimin e ligjit për sigurinë dhe shëndetin nëpunë.



Shaqni sllajdin 44 në PowerPoint. Rikujtoni nxënësit se duhet të mbajnë mend:

- Të drejtat e tyre
- Përgjegjësitë e tyre
- Që ligji thotë se punëdhënësi juaj duhet të mbajë të sigurt vendin tuaj të punës
- Si t'iu përgjigjen problemeve që mund të dalin

Diskutoni (në qoftë se keni kohë), për projektet përfundimtare të caktuara në fund të Mësimi 3

Përfundoni Mësimin 6 duke lexuar këtë mesazh:

“Në këtë mësim, ju mësuar se si të flisni me shefin tuaj, kur përballeni me një problem në punë. Ju duhet t'i dini të drejtat tuaja si një punëtor i ri dhe të keni një plan për të biseduar me punëdhënësin tuaj. Nëse ju nuk ndiheni rehat kur flisni me shefin tuaj, flisni së pari me një të rritur tjetër të besuar. Ju mund gjithashtu të merrni ndihmë nga IP.” Mos kini frikë të shpreheni!

(Në qoftë se anashkaloni Mësimin 6B: “Ky ishte mësimi i fundit për Sigurinë në punë. Aftësitë që ju keni mësuar do t'iu ndihmojnë që të jeni të sigurt dhe të shëndetshëm në punë, tani dhe gjatë gjithë jetës suaj të punës.”)

Hapi 4:

Nëse anashkaloni Mësimin 6B, shpërndani raportin vlerësues të mësimit dhe kërkoni prej nxënësve që ta përfundojnë atë.

5 minuta

Jepni nga një kopje të Materialit 16 të nxënësit dhe Raportin e Vlerësimit për secilin nxënës në klasë.

Kërkoni nxënësve t'i kompletojnë dhe t'i kthejnë formularët. Formularët janë anonim.

Informoni nxënësit se komentet dhe idetë e tyre janë të rëndësishme dhe do të ndihmojnë për ta përmirësuar mësimin për nxënësit e ardhshëm.

Materiali 11 për mësimdhënësin

Skenarët e skeçeve të shkurtra

Skenari 1

Ju punoni në një klinikë të kafshëve, duke ndihmuar për kujdesin për kafshët. Unë jam shefi juaj. Unë kërkoh nga ju që të pastroni një nga dhomat ku një qen ka bërë rrëmujë. Unë ju them që të përdorni një kimikat të fortë mbi dysheme dhe tavolina. Ju keni astmë dhe shqetësoheni se kimikati mund t'iu vështirësojë frymëmarrjen. Çfarë do të më thoshit mua?

Skenari 2

Ju punoni në magazinën e një supermarketi të pajisjeve. Unë jam mbikëqyrësi juaj. Unë ju them të tërhiqni artikuj nga raftet për të plotësuar një radhë, por unë flas shpejt dhe nuk i bëj të qarta udhëzimet e mia. Çfarë do të më thoshit mua?

Skenari 3

Ju punoni në një ekip të pastrimit për Parqet e qytetit. Unë jam mbikëqyrësi juaj. Një ditë temperatura shënon rreth (42 C) jashtë dhe ju keni punuar shumë për disa orë. Ju filloni të keni me të vërtetë të nxehtë dhe të lodheni, dhe brengoseni se mund të ligështoheni. Çfarë do të më thoshit mua?

Skenari 4

Detyra juaj është që të paloni librat në raftet, në një librari në qendër të qytetit. Unë jam mbikëqyrësi juaj. Është ora 9:30, e mërkurë mbrëma dhe dyqani është ende shumë i zënë. Unë ju them që një nga punëtorët tjerë shkoi në shtëpi pasi që ishte i sëmurë dhe ju kërkoh që të qëndroni për të më ndihmuar që ta mbyll dyqanin në mesnatë. Ju jeni 15 vjeç dhe e dini që nuk duhet të punoni kaq vonë pasi që neser duhet të shkoni në shkollë. Çfarë do të më thoshit mua?

Skenari 5

Detyra jote është t'i bashkoni pjesët e ndryshme në një fabrikë lokale. Ju keni dëgjuar se fabrikat mund të jenë vende të rrezikshme dhe duket sikur ka shumë rreziqe në punën tuaj.

Unë jam mbikëqyrësi juaj. Kur keni filluar këtë punë, unë ju kam dhënë disa materiale të shkruara për sigurinë që t'i lexoni. Por ju ende nuk keni idenë se çfarë rregulla të sigurisë duhet të ndiqni. Tani unë dua që ju të nënshkruani një letër ku thuhet se ju keni qenë të trajnuar në lidhje me sigurinë. Çfarë do të më thoshit mua?

Nëse dëshironi, ju mund të krijoni dhe përdorni edhe ngjarje të tjera më të përshtatshme për veçoritë e lokalitetit ku vepron shkolla juaj apo për profilin e shkollës tuaj.

MËSIMI 6B

Ndërmarrja e Veprimit

Përforcimi i informacioneve të përvetësuara për të drejtat e të rinjëve në punë. Shqyrtoni mundësitë e reagimit nëse shfaqet një problem i sigurisë në punë. Praktikoni format efektive të komunikimit me punëdhënësit në lidhje me shqetësimet shëndetësore dhe të sigurisë në vendin e punës.



RINIA  **PUNË**

Diskutim për sigurinë

Qëllimi i orës mësimore

Konsolidimi i njohurive paraprahe të nxënësve për të drejtat e tyre në punë. Ushtrimi i formave të komunikimit me punëdhënësit në lidhje me shqetësimet për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

Rezultatet e pritura

Deri në fund të orës mësimore nxënësit do të jenë në gjendje të:

- Definojnë problemet, vendosin qëllimet dhe të bëjnë plane për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me rreziqet në vendin e punës;
- Reflektjnë në aftësinë për të identifikuar situatat e rrezikshme në vendin e punës dhe për të ndërmarr veprime për t'i eliminuar rreziqet nëpunë;
- Demonstrojnë mënyra efektive për të krijuar një vend pune të sigurt.

Ndërlidhja me rezultatet e përgjithshme të modulit Siguria në Punë: 2, 3, 4, 8

Ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë-RNSh 4²⁰: # I.1; # I.3; # I.4; # I.7; # II.1; # II.4; # II.6; # II.7; # III.2; # III.4; # III.8; # IV.1; # IV.2; # IV.6; # V.3; # V.6; # V.9; # VI.1; # VI.3; # VI.4; # VI.8;

Ndërlidhja me RNF Gjuhët dhe komunikimi: # I.3; # IV.1;

Ndërlidhja me RNF Shkencat e natyrës: # I.1; # I.3;

Ndërlidhja me RNF Shoqëria dhe Mjedisi: # III.1; # III.4;

Ndërlidhja me RNF Shëndeti dhe mirëqenia: # I.1; # II.2; # V.2; # VI.1

Ndërlidhja me RNF Jeta dhe Puna: # I.1; # I.2; # III.1; # III.2; # IV.1; # V.1; # VI.1

Shënim:

- ndërlidhja me kompetencat kryesore të Kurrikulës Bërthamë dhe me RNF vlen për nivelin e mesëm të ulët-shkallën kurrikulare 4;
- për aplikimin e modulit në shkollat profesionale dhe në gjimnaze, respektivisht në nivelin e mesëm të lartë-shkallën kurrikulare 5 luteni që ndërlidhjen ta identifikoni nga Kurrikulat Bërthamë për nivelet përkatëse.

²⁰ Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët

Çështjet kryesore që duhen të mirren parasysh

Mësimdhënësit që kanë përdorur këtë kurrikulë kanë identifikuar se Tregimi i Elenës, i përdorur në Hapin 2 të këtij mësimi, paraqet shumë çështje të shëndetit dhe sigurisë në të njëjtën kohë.

Kështu, skeçet e shkurtra të përdorura në Mësimin 6 i ofrojnë nxënësve një bazë të mirë për të kuptuar mbivendosjen e çështjeve komplekse të përfshira në Mësimin 6B.

Në këtë mësim, vazhdimisht rikujtoni nxënësit se ata kanë të drejta në punë.

Ata kurrë nuk duhet të ndihen keq për të kërkuar ndihmë ose për të bërë pyetje. Ata duhet të marrin më shumë informacion kur u kërkohet të bëjnë punë të cilat nuk i kuptojnë ose iu duken të rrezikshme, të pakëndshme, ose potencialisht jo-ligjore.

Nëse të rinjtë kanë një problem në punë, ata nuk duhet të heshtin.

Problemi mund të përkeqësohet dhe ata, apo dikush tjetër, do të mund të lëndohet. Inkurajoni nxënësit tuaj për të diskutuar shqetësimet e tyre me ndonjë të rritur - prind, mësimdhënë, drejtor, ose koleg.

Përgatitja

Lexoni

Materialin Nr. 12 për mësimdhënësit, në fund të këtij mësimi.

Përgatitni materialet

Një prezantim i sllajdeve 43-44 në PowerPoint në një kompjuter (me projektor)

Shfaqni

Tregimin e Elenës (Materiali 15 i Nxënësit)

Merrni

Një flipchart dhe markerë, ose përdorni një tabelë të bardhë dhe markerë

Fotokopjoni

Tregimi i Elenës (Materiali 15), një kopje për secilin nxënës

Materiali 14 i Nxënësit, *A jeni një adoleshent që punon?* Pasqyrat e të dhënave (nga mësimet 5, 5B, dhe 6), një për secilin nxënës

Materiali 16 i Nxënësit, Raporti Vlerësues, një për secilin nxënës

Plani i orës mësimore

Hapi 1

Shqyrtoni pikat kryesore nga mësimi i mëparshëm.

10 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Hapi 2

Praktikoni të drejtat e punëtorëve të rinj në një skenar të vërtetë (Tregimi i Elenës, Materiali 15 i nxënësit).

25 minuta

Luajtja e roleve, puna në grupe të vogla, diskutim në klasë

Hapi 3

Shqyrtoni dhe përmbliidhni pikat kryesore të mësimi.

5 minuta

Ligjëratë e shkurtër

Hapi 4

Shpërndani raportin vlerësues të mësimi dhe kërkoni nxënësve që ta plotësojnë

5 minuta

Formulari i vlerësimit

Udhëzime për realizimin e njësisë mësimore

Hapi 1:

Shqyrtoni pikat kryesore nga mësimi paraprak

5 minuta



Shfaqni sllajdin 43

Shqyrtoni hapat për t'i zgjidhur problemet në vendin e punës (si problemet e sigurisë ashtu edhe lloje të tjera). Verifikoni nëse nxënësit kujtojnë hapat për të reaguar në situatat e përballjes me probleme në punë:


- **Përshkrimi i qartë i problemit ose problemeve.** Ky është hapi i parë drejt zgjidhjes.
- **Këshillimi me prindin, mësimdhënësin, ndonjë person tjetërtë rritur ose koleg.** Shih nëse ai person ka ide se si duhet të trajtohet problemi dhe si do të ndihmojë. Nëse ka një sindikatë në vendin tuaj të punës, ju mund gjithashtu të kërkon ndihmë nga sindikata²¹.
- **Vendosja qëllimeve tuaja.** Mendoni për atë që ju doni të arrini.
- **Njohja e të drejtave tuaja.** Familjarizohuni me orarin e lejuar të punës dhe llojet e punës që mund të kryhen nga punonjësit e moshës 15-18 vjeçare.. Familjarizohuni gjithashtu me të drejtat tuaja për mbrojtje dhe siguri në punë.
- **Zgjedhja e mënyrës më të mirë për të diskutuar me mbikëqyrësin.** Përgatituni çfarë të thoni dhe nëse do të merrni dikë kur të bisedoni me mbikëqyrësin.
- **Kontaktimi i një agjencie të jashtme për ndihmë (nëse është e nevojshme).** Në qoftë se vazhdoni të keni probleme edhe pasi të keni biseduar me mbikëqyrësin tuaj, merrni ndihmë nga dikush që i besoni. Nëse gjithë të tjerët dështojnë, ju mund të keni nevojë për të thirrur institucionin përkatës (p.sh. inspektoratin e punës).

²¹ Sindikata është një organizim i punëtorëve në ndërmarrje, në një sektor apo më gjerë, për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve

Hapi 2:

Praktikoni të drejtat e punëtorëve të rinj në një skenar të vërtetë (Tregimi i Elenës, Materiali 15 i nxënësit).

25 minuta



Shpërndani kopjet e Materialit 16 të Nxënësit, Tregimi i Elenës. Shih Materialin Nr. 12 për mësimdhënësit, në fund të këtij mësimi.

Kërkoni vullnetarë që të luajnë rolin e Elenës, z. Xhonsonit dhe Xhoit.

Kërkoni nga vullnetarët të dalin para klasës dhe të lexojnë pjesët e tyre me zë të lartë.

Pyesni nxënësit se cilat situata janë në kundërshtim me ligjet në këtë tregim.

Sugjeroni që nxënësit të shikojnë Materialin 14 të Nxënësit, pasqyrën e të dhënave, nëse është e nevojshme. Posa vullnetarët të përgjigjen, shkruani përgjigjet e tyre në flipchart ose në tabelë.

Këtu janë disa nga situatat në kundërshtim me legjislacionin në Kosovë:

- Elenës nuk iu është dhënë informacion në lidhje me kimikatet e pastrimit.
- Punëdhënësi nuk i kishte dhënë Elenës veshje mbrojtëse (dorëza).
- Asnjë punëtor nën moshën 18 vjeçare nuk mund të përdorë makinën për prerjen e mishit.
- Askush që ka moshën nën 18 vjeçare nuk mund të punojë kaq vonë.

Ndani klasën në grupe me nga tre deri në gjashtë-nxënës.

Shpjegoni se secili grup duhet të shkruaj njëpërfundimtetjet (alternativ) të tregimit të Elenës, duke treguar se çfarë do të mund të bënte Elena për problemet shëndetësore dhe të sigurisë.

Inkurajoni grupet të mendojnë për këto pyetje:

- Si është dashur Elena t'i qaset mbikëqyrësit të saj në lidhje me këtë problem?
- Cilat janë mënyrat e ndryshme që mbikëqyrësi i saj do të mund t'i përgjigjej?
- Ku tjetërmund të drejtohet Elena?

Referoni grupet në pasqyrën e të dhënave (Materiali 14 i Nxënësit), nëse është e nevojshme.

Shpjegoni se ata do të luajnë/aktrojnëpërfundimin alternativ të zhvilluar.

Ata duhet t'i caktojnë rolet dhe t'i ushtrojnë.

Gruponi klasën së bashku pas rreth 15 minutash.

Kërkoni nga grupet vullnetare (ose të gjitha, në qoftë se ka kohë) që të aktrojnë përfundimet e tyre alternative për tregimin e Elenës.

Më poshtë janë dhënë disa opsione të mundshme për përfundimin e tregimit të Elenës:

- Elena pyet një koleg, mik, prind apo mësimdhënës për këshilla.
- Elena i tregon mbikëqyrësit të saj se ajo nuk ndihet rehat që të punoj në orët e vona tënatës, detyrat e ndaluara me ligj.
- Elena pyet përfaqësuesin e punëtorëve të drejtat e punëtorëve.
- Elena heq dorë nga puna e saj për shkak të orëve të gjata ose kërkesave të tjera të papërshtatshme.
- Elena informon punëdhënësin e saj se, me ligj, ajo është shumë e re për të përdorur makinën për prerjen e mishit.
- Elena paraqet ankesë tek Inspektorati i Punës.

Diskutoni përfundimet alternative të propozuara nga grupet.

Merrni parasysh pyetjet e mëposhtme:

- Sa serioz është problemi?
- A ka nevojë të rregullohet menjëherë?
- A do ndikojë ndonjëra nga këto ide që Elena të humbas punën e saj?
- Cila do të ishte mënyra më e mirë për të zgjidhur problemin?

Hapi3:

Përmbliidhni pikat kryesore të mësimi

5 minuta

Rikujtojuni hapat kryesor përtë reaguuar ndaj problemeve në punë. Diskutoni për rëndësinë e secilit hap.

Hapi 4:

Shqyrtoni dhe përmbliidhni pikat kyçe të mësimi.

5 minuta

Jepni nga një kopje të Materialit 17 të nxënësit dhe Raportin e Vlerësimit për secilin nxënës në klasë.

Kërkoni nxënësve t'i kompletojnë dhe t'i kthejnë formularët. Formularët janë anonim.

Informoni nxënësit se komentet dhe idetë e tyre janë të rëndësishme dhe do të ndihmojnë për ta përmirësuar mësimin për nxënësit e ardhshëm.

Materiali 12 për mësimdhënësin

Tregimi i Elenës

- Skena:** Dyqan sandviçësh. Elena është një 15 vjeçare, nxënëse e shkollës së mesme. Z. Xhonson është mbikëqyrësi i saj dhe Xhoi është një nga kolegët e saj. Është e enjte mbrëma.
- z. Xhonson:** Elena, Andre ka lajmëruar se nuk mund të vijë në punë ngase është i sëmurë, kështu që kam nevojë që të punosh disa orë shtesë. Sonte duhet të qëndrosh deri në orën 22.00.
- Elena:** Por, z. Xhonson, unë kam test nesër dhe më duhet të jem në shtëpi për të studiuar.
- z. Xhinson:** Me të vërtetë më vjen keq, por ky është rast urgjent. Nëse don të punosh këtu, duhet të jesh e gatshme që të punosh kur kemi nevojë për ty.
- Elena:** Por unë kurrë nuk kam bërë punën e Andreut më parë.
- z. Xonson:** Së pari, shko prapa banakut dhe merru me porositë e sandviçëve për një kohë. Kërko nga Xhoi që të tregoj se si përdoret makina për prerjen e mishit. Pastaj, kur të përfundosh prerjet, shko pastro dyshemenë në dhomën e furnizimit. Disa nga pajisjet për pastrim janë derdhur dhe është bërë rrëmujë.
- Më vonë:** Elena merr lecat dhe shkon në dhomën e furnizimit.
- Elena:** Hej, Xho! A e din se çfarë gjëra janë derdhur në dysheme?
- Xhoi:** Nuk kam ide. Vetëm ki kujdes që të mos prekësh me duar. Duhet të bartësh dorëza në qoftë se gjen. Andre mori një skuqje të lëkurës nga ato gjëra javën e kaluar.



RINIA PUNË

Diskutim për sigurinë

Materiali për nxënësit



KUIZI I SIGURISË NË PUNË

Punoni së bashku me grupin tuaj për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve. Të qëlluarit me hamendje është në rregull! Ju nuk do të vlerësoheni për përgjigjet tuaja. Zgjidhni një person në grupin tuaj për të raportuar përgjigjet.

✓ NËNVIZO PËRGJIGJEN E SAKTË.

1 Ligji thotë se punëdhënësi juaj duhet t'iu ofroj një vend të sigurt dhe të shëndetshëm në punë.

E SAKTË

E PA SAKTË

2 Ligji kufizon se sa vonë ju mund të punoni në një ditë të shkollës në qoftë se jeni nën moshën 18 vjeçare.

E SAKTË

E PA SAKTË

3 Nëse jeni 16 vjeç, ju lejohet të vozitni makinën në rrugët publike si pjesë e punës suaj.

E SAKTË

E PA SAKTË

4 Nëse lëndoheni në punë, punëdhënësi juaj duhet të paguaj për kujdesin tuaj shëndetësor.

E SAKTË


E PA SAKTË

GJENI RREZIQET

RESTAURANT I USHQIMEVE TË SHPEJTA

RINIA në PUNË

Diskutim për sigurinë
Materiali 2 për nxënësit



GJENI RREZIQET DYQAN USHQIMOR

RINIA në PUNË

Diskutim për sigurinë
Materiali 3 për nxënësit



GJENI RREZIQET

ZYRA

RINIA ^{në} PUNË

Diskutim për sigurinë
Materiali 4 për nxënësit



GJENI RREZIQET PIKË E KARBURANTIT

RINIA ^{në} PUNË

Diskutim për sigurinë
Materiali 5 për nxënësit



IDENTIFKIMI I RREZIQEVE

RINIA  PUNË

Diskutim për sigurinë
Materiali 6 për nxënësit

RREZIKU DËMI I MUNDSHËM

KUZHINË

RREZIKU DËMI I MUNDSHËM

ZYRË

RREZIKU DËMI I MUNDSHËM

TJETËR FUSHË...

ZGJIDHJET E RREZIQEVE

RESTORANTE DHE KAFITERI

RINIA  **PUNË**

Diskutim për sigurinë

Materiali 7 për nxënësit

| Rreziku | Efekti i mundshëm | Zgjidhja e mundshme |
|---|---|--|
| SIGURIA | | |
| Pajisjet për gatim | Djegje ose goditje elektrike | <ul style="list-style-type: none"> Mbani pajisjet në kushte të sigurta Vendosni mbuloja rreth sipërfaqeve të nxehta Vishni dorëza për t'u mbrojtur kundër djegieve |
| Yndyrat e nxehta | Djegje | <ul style="list-style-type: none"> Përdorni enë për yndyrëra që derdhen automatikisht Vendosni enë mbrojtëse nga spërkatjet Vishni rrobat mbrojtëse |
| Prerëset dhe pajisjet elektrike për prerje | Prerjet | <ul style="list-style-type: none"> Nuk guxon të operoni nëse jeni nën 18 vjeç Mbani mbrojtëset në vend Merrni trajnimin e duhur Fikeni dhe hiqeni nga priza për ta pastruar |
| Dyshemetë e lagura /të rrëshqitshme | Rrëshqitjet ose rrëzimet | <ul style="list-style-type: none"> Pastroni shpejt derdhjet Përdorni qilim për dysheme Vishni këpucë me thembra jo-të rrëshqitshme |
| Xham i thyer | Prerjet | <ul style="list-style-type: none"> Patroni xhamat e thyer me kujdes Vishni dorëzat Trajtoni plehrat me kujdes, që mund të përmbajnë xhama të thyer |
| KIMIKATE | | |
| Produktet për pastrimin e enëve | Kontakti me lëkurën mund të shkaktojë irrim, skuqje të lëkurës, djegie kimike | <ul style="list-style-type: none"> Përdorni produkte më të sigurta Vishni dorezat e duhura për t'u mbrojtur |
| Produktet për pastrim | Disa avuj shkaktojnë dhimbje koke, marramendje dhe probleme tjera shëndetësore; kontakti me lëkurën mund të shkaktojë irrim, skuqje të lëkurës, djegie kimike | <ul style="list-style-type: none"> Konsultohuni me legjislacionin në fuqi për kimikatet të cilave nuk guxon t'u ekspozohen personat nën moshën 18 vjeçare Vishni dorezat e duhura për t'u mbrojtur Siguroni ventilim/ajrosje të mirë |
| RREZIQE TË TJERA | | |
| Qëndrimi në këmbë për periudha të gjata Lëvizje të përsëritura | Tendosje të shpinës/ plagosje | <ul style="list-style-type: none"> Përdorni qilima për dysheme Merrni pushime të herëpashershme Punë me ndërrime |
| Përkulja, zgjatja, shtrirja, dhe ngritja | Ndrydhje dhe tendosje të muskujve | <ul style="list-style-type: none"> Konsultohuni për peshën e lejuar për personat nën moshën 18 vjeçare Mbani artikujt e rëndë në raftet më të ulëta Punë me ndërrime Përdorni ndihmës |
| Orët e vona Ngacmimi apo kërcënimi | Stres, trauma emocionale / fizike | <ul style="list-style-type: none"> Puna natën (pas orës 22.00) nuk lejohet për persona nën 18 vjeç Të ketë siguri të mjaftueshme Të paktën 2 persona në ndërrim Përdorni barriera ku behet pagesa Merrni trajnimin për shërbimin e klientit Punë me ndërrime Mbani një ditar për të përshkruar rreziqet |

ZGJIDHJET E RREZIQEVE

SHITJE ME PAKICË

RINIA në **PUNË**

Diskutim për sigurinë
Materiali 7 për nxënësit

| Rreziku | Efekti i mundshëm | Zgjidhja e mundshme |
|---|---|---|
| SIGURIA | | |
| Thika të mprehta | Prerjet | <ul style="list-style-type: none"> Mbani në gjendje të mirë Përdorni me kujdes Paloni mirë kur i vendosni në vend |
| Prerëset për ushqim | Prerjet | <ul style="list-style-type: none"> Nuk lejohet përdorimi nëse jeni nën 18 vjeç Mbani enët mbrojtëse në vend Merrni trajnimin e duhur Fikini kur t'i pastroni. Hiqni nga priza makinën. |
| Karrocat për blerje | Pickimet, prerjet e gishtave; tendosje të shpinës | <ul style="list-style-type: none"> Limitoni numrin e karrocave për t'i shtyrë në të njëjtën kohë Vishni doreza për të ju mbrojtur |
| Makinat (në parking) | Dëmtime trupore | <ul style="list-style-type: none"> Vishni veshje standarde në mënyrë që makinat të mund të ju shohin. Merrni trajnim mbi sigurinë/ rreziqet në parking. |
| KIMIKATE | | |
| Produktet për pastrim | Disa avuj shkaktojnë dhimbje koke, marramendje dhe probleme tjera shëndetësore; kontakti me lëkurën mund të shkaktojë iritrim, skuqje të lëkurës, djegie kimike | <ul style="list-style-type: none"> Konsultohuni me legjislacionin në fuqi për kimikatet të cilave nuk guxon t'u ekspozohen personat nën moshën 18 vjeçare Vishni dorezat e duhura për t'iu mbrojtur. Siguroni ventilim/ajrosje të mirë. |
| RREZIQE TË TJERA | | |
| Orët e vona Ngacimi apo kërcënim nga konsumatorët, kolegët apo persona të tjerë | Stres, trauma emocionale / fizike | <ul style="list-style-type: none"> Puna natën (pas orës 22.00) nuk lejohet për persona nën 18 vjeç Të ketë siguri të mjaftueshme. Të paktën 2 persona në ndërrim. Përdorni barriera ku behet pagesa. Merrni trajnimin për shërbimin e klientit. Punë me ndërrime. Mbani një ditë për të përshkruar rreziqet. Raportoni situatat e pakëndshme dhe/apo rreziqet te punëdhënësi apo një i rritur i besueshëm |
| Arka në dyqan | Lëndime nervore, të muskujve, ligamenteve | <ul style="list-style-type: none"> Sigurohuni që mbështetëset e arkave janë projektuar për t'iu mundësuar juve të punoni të qetë Merrni pushime të rregullta Punë me ndërrime |
| Përkulja, zgjatja, ngritja me rastin e rregullimit të rafteve dhe vendosjes së produkteve | Ndrydhje dhe tendosje të muskujve | <ul style="list-style-type: none"> Përdorni makineri për ngritje Mbani artikujt e rëndë në raftet më të ulëta Merrni trajnimin e duhur për ngritjen e peshave Bëni ndërrime të shpeshta të aktivitetit Merrni ndihmë nga kolegët |
| Temperaturat e ftohtë (në zonat e ftohta të magazinimit, frigoriferët me ngrirje të thellë) | Morth | <ul style="list-style-type: none"> Kufizoni kohën e punës në vende të ftohta |

ZGJIDHJET E RREZIQEVE

KINEMAJA

RINIA  **PUNË**

Diskutim për sigurinë

Materiali 7 për nxënësit

| Rreziku | Efekti i mundshëm | Zgjidhja e mundshme |
|--|---|---|
| SIGURIA | | |
| Kokoshkat, salsiçet dhe aparatet e kafesë | Djegjet apo shoku elektrik | <ul style="list-style-type: none"> • Të mbahen aparatet në gjendje të mirë të punës • Të përdorën dorëzat • Të fiket aparati nga rryma |
| Dyshemetë e rrëshqitshme | Rrëshqitjet apo rrëzimet | <ul style="list-style-type: none"> • Të fshihen shpejt gjërat e derdhura • Të përdoret mbulesa e dyshemesë • Të përdoren të mbathura që nuk rrëshqasin |
| KIMIKATE | | |
| Produktet për pastrim | Disa avuj shkaktojnë dhimbje koke, marramendje dhe probleme tjera shëndetësore; kontakti me lëkurën mund të shkaktojë irrim, skuqje të lëkurës, djegie kimike | <ul style="list-style-type: none"> • Konsultohuni me legjislacionin në fuqi për kimikatet të cilave nuk guxon t'u ekspozohen personat nën moshën 18 vjeçare • Vishni dorezat e duhura për t'iu mbrojtur. • Siguroni ventilim/ajrosje të mirë. |
| RREZIQE TË TJERA | | |
| Dhunë, ngacmim, maltretim, diskriminim (nga klientët, kolegët e punës) | Stres, traumë emocionale/ fizike | <ul style="list-style-type: none"> • Puna natën (pas orës 22.00) nuk lejohet për persona nën 18 vjeç • Të ketë siguri të mjaftueshme. • Të paktën 2 persona në ndërrim. • Përdorni barriera ku behet pagesa. • Merrni trajnimin për shërbimin e klientit. • Bëni ndërrime me kolegët për të iu shmangur lëvizjeve të përsëritura • Mbani një ditar për të dokumentuar situatat e pakëndshme/ të rrezikshme • Raportoni situatat e pakëndshme dhe/apo rreziqet te punëdhënësi apo një i rritur i besueshëm |
| Ambientet e errëta | Lodhja e syve, rrëshqitjet apo rrëzimet. | <ul style="list-style-type: none"> • Të përdoret llamba e dorës. |
| Qëndrimi në këmbë për periudha të gjata | Tendosje të shpinës/ plagosje | <ul style="list-style-type: none"> • Përdorni qilima për dysheme • Merrni pushime të herëpashershme • Punë me ndërrime |

ZGJIDHJET E RREZIQEVE

ZYRA

RINIA  **PUNË**

Diskutim për sigurinë
Materiali 7 për nxënësit

| Rreziku | Efekti i mundshëm | Zgjidhja e mundshme |
|---|---|---|
| SIGURIA | | |
| Kabllo dhe vendosja jo e duhur e qilimit | Pengesat në të ecur dhe rrëzimet | <ul style="list-style-type: none"> Të mos i vendosen kabllo përgjatë hapësirave publike. Sigurohuni që qilimat janë të sigurte. |
| Mobilet e pasigurta | Mund të rrëzohen, përmbysen | <ul style="list-style-type: none"> Të sigurohen mobilet e rënda, raftet e librave, dosjeve. |
| Qarqet e tej-ngarkuara elektrike | Zjarri | <ul style="list-style-type: none"> Të ketë priza të mjaftueshme. Të përdoren mbrojtësit nga ndryshimi i tensionit. |
| KIMIKATE | | |
| Ozoni nga fotokopjet | Vështirësi në frymëmarrje, dhimbje koke, marramendje. | <ul style="list-style-type: none"> Të vendosen fotokopjet në hapësirë të ndarë. Siguroni ventilim të mjaftueshëm |
| Cilësi e dobët e ajrit brenda zyrës | Vështirësi në frymëmarrje, dhimbje koke, marramendje, lodhje. | <ul style="list-style-type: none"> Siguroni ajrosje të mirë |
| RREZIQE TË TJERA | | |
| Tastiera dhe miu i kompjuterit | Lodhje e syve, lodhje muskujsh | <ul style="list-style-type: none"> Përdorni karrige dhe tavolinë pune me mundësi përshtatjeje. Mbani trupin drejt. Merrni pushime të rregullta. |
| Qëndrimi ulur për një kohë të gjatë. | Dhimbje shpine | <ul style="list-style-type: none"> Përdorni karrige që përshtaten. Mbani trupin drejt. Merrni pushime të rregullta. |
| Punë që përsëritet, e mërzitshme | Stres | <ul style="list-style-type: none"> Bëni ndërrime të aktivitetit |
| Dhunë, ngacim, maltretim, diskriminim (nga klientët, kolegët e punës) | Stres, traumë emocionale/fizike | <ul style="list-style-type: none"> Të ketë siguri të mjaftueshme. Të paktën 2 persona në ndërrim. Merrni trajnimin për shërbimin e klientit. Bëni ndërrime me kolegët Mbani një ditar për të dokumentuar situatat e pakëndshme Raportoni situatat e pakëndshme dhe/apo rreziqet te punëdhënësi apo një i rritur i besueshëm |

KËRKIMI I INFORMATAVE

A. FLETË PUNE

Nga mësimdhënsi do t'iu caktohet një tregim nga pjesa C e këtij materiali.

PËRGJIGJUNI NË PYETJET E MËPOSHTME.

- 1** Ku gjendet problemi (rreziku) për shëndet dhe siguri në rastin tuaj?
- 2** Çfarë informatash mund t'i gjeni në vendin e punës? Ku do të mund t'i gjeni?
- 3** Zgjidhni tri burime të mundshme të informatave jashtë vendit të punës!

Këto duhet të përfshihet së paku një agjenci qeveritare dhe të paktën një organizatë apo agjenci që nuk bën pjesë në qeveri. Mund të gjurmoni në internet ose të kërkonit informatat me telefon. Në pjesën B të këtij materiali janë sugjeruar disa burime. Nuk duhet të kufizoheni vetëm në këto burime. Çdo anëtar i ekipit mund të merr informata nga ndonjë burim tjetër ose mund të punoni bashkë. Përdorni këto burime për t'iu përgjigjur pyetjeve në vijim.

Cilat janë efektet afat-shkurtra në shëndet?

| Informata | Burimi |
|-----------|--------|
| | |
| | |
| | |
| | |

Cilat janë efektet afat-gjata në shëndet?

| Informata | Burimi |
|------------------|---------------|
| | |
| | |
| | |
| | |

Cilat janë disa nga mënyrat për ta zvogëluar apo larguar këtë rrezik?

| Informata | Burimi |
|------------------|---------------|
| | |
| | |
| | |
| | |

4 Cila ka qenë informata më e rëndësishme që e ke mësuar, dhe pse ka qenë aq e rëndësishme?

5 Cili ishte burimi më i dobishëm i informatave dhe pse?

B. BURIMET: KU TË MERREN INFORMATAT

Më poshtë gjeni një listë të institucioneve ku mund të merren të dhëna dhe informacione tjera mbi rreziqet në shëndet dhe siguri. Ju mund të hulumtoni në internet për kontaktet e tyre (ueb faqet dhe telefonat).

Gjithashtu mund të gjurmoni edhe agjenci të tjera shtetërore apo lokale (në komunën tuaj) ku mund të gjenden informata të dobishme për kufizimet specifike shtetërore për punëtorët nën moshën 18 vjeçare.

AGJENCITË SHTETËRORE

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Inspektorati i Punës

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Punës dhe Punësimit

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Familjes dhe Politikave Sociale, Divizioni i Shërbimeve Sociale

Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra për të Drejta të Njeriut

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Zyra për të Drejta të Njeriut

Instituti Kombëtar i Mjekësisë së Punës, Gjakovë

Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare- Repartet e Mjekësisë së Punës (në të gjitha qytetet)

Instituti i Mjekësisë së Punës , Obiliq

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik- Prishtinë

Institutet Rajonale të Shëndetit Publik (Prishtinë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Prizren)

C. SKENARËT

SKENARI I PARË: NGRITJA E PESHAVE TË RËNDA

Jakobi punon në një magazinë. Ai është 17 vjeçar. Një ditë, kur ai ishte duke shkarkuar disa kuti 15 kg nga një paletë druri, papritmas ndjeu një dhimbje të mprehtë në pjesën e poshtme të shpinës. Jakobit i është dashur të mungojë nga puna për një javë që të shërohet, dhe ende ndonjëherë ka dhimbje në shpinë. Ai është i shqetësuar për mundësinë e lëndimit të serishëm të shpinës dhe përpiqet të jetë i kujdesshëm, por ai dëshiron të mësojë më shumë për ngritjen e sigurt dhe mënyra tjera për të parandaluar lëndimet e shpinës.

SKENARI I DYTË: TAVOLINË E PAPËRSHTATSHME E PUNËS NË KOMPJUTOR

Asifi, 16 vjeçar, është duke punuar si asistent administrativ në një zyrë të madhe. Ai është nëpunësi më i ri në zyrë, dhe me sa duket të gjitha pajisjet i ka të vjetruara. Tastiera dhe mausi gjenden në tavolinën e punës së tij, së bashku me monitorin e kompjuterit. Leva për të rregulluar lartësinë e karriges së tij nuk punon. Asifi punon pjesën më të madhe të ditës në kompjuterin e tij. Ai e di se një person në zyrë mban proteza në kyçet e duarve dhe ajo nuk mund të bëjë shumë gjëra në shtëpi, sepse shtrëngimin në shuplakën e dorës e ka të dobët. Asifi nuk dëshiron të ketë probleme të tilla, dhe ai dëshiron të dijë se çfarë mund të bëjë.

SKENARI I TRETË: ZHURMA NË PUNË

Hose është 18 vjeç, dhe ka një vit që punon për një kompani ndërtimi. Pjesën më të madhe të kohës ai punon me sharrë elektrike. Veshët zakonisht i kumbojnë për një kohë në mbrëmje, por kumbimi zhduket deri në mëngjes. Ai është pak i shqetësuar rreth asaj nëse zhurma e dëmton dëgjimin e tij, por nga ana tjetër ka përshtypjen se kjo ndjenjë nuk është më e ndryshme nga ajo e kumbimit të veshëve pas një koncerti. Ai dëshiron të gjen disa informacione për dëmin që mund t'i shkaktoj zhurma dhe veprimet që mund t'i ndërmerr.

SKENARI I KATËRT: SIGURIA NË MINIMARKET

Shanisa, 17 vjeç, punon në një dyqan. Ajo dhe punonjësit e tjerë punojnë me rradhë në ndërrimin e natës. Shanisa nuk ndihet e sigurtë kur punon në ndërrimin e natës, por ajo e di se në qoftë se nuk e pranon ndërrimin pronari thjesht do t'a zëvendësoj me dikë tjetër. Ajo e mban një topuz në çantë dhe pronari e ka udhëzuar që t'i dorëzoj paratë nëse ajo përballet me ndonjë grabitës. Ajo dëshiron të dijë se çfarë tjetër mund të bëjë që të ndjehet e sigurt.

PROFESIONET KRYESORE NË FUSHËN E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

- **Punëtorët e higjienës industriale:** parashikojnë, njohin, vlerësojnë, komunikojnë dhe kontrollojnë ekspozimet në vendin e punës që mund të rezultojnë në lëndime ose sëmundje të punëtorëve. Ata ofrojnë fakte për punëtorët dhe punëdhënësit mbi aspekte të shëndetit dhe sigurisë dhe zhvillojnë politika për t'i bërë punëtorët më të sigurt.
- **Mjekët e shëndetit në punë** trajtojnë njerëzit që janë të sëmurë ose të lënduar për shkak të punës së tyre. Ata studiojnë sëmundjet për të kuptuar se si të identifikojnë njerëzit e rrezikuar nga sëmundjet në vendet e ndryshme të punës, për të planifikuar masat e parandalimit të sëmundjeve në punë si dhe ofrojnë shërbime mjekësore për personat që janë lënduar ose sëmurë në punë.
- **Infermieret e shëndetit në punë** trajtojnë punëtorët të cilët janë të sëmurë ose të lënduar në punë dhe parandalojnë efektet shëndetësore të shkaktuara nga puna.
- **Specialistët e sigurisë dhe shëndetit në punë** zhvillojnë programe trajnimi për punonjësit dhe promovojnë sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës. Ata ofrojnë fakte për punëtorët dhe punëdhënësit mbi aspekte të shëndetit dhe sigurisë dhe zhvillojnë politika për t'i bërë punëtorët më të sigurt.
- **Profesionistët e sigurisë** parashikojnë, njohin, vlerësojnë, komunikojnë dhe kontrollojnë rreziqet e sigurisë në vendin e punës për të gjetur dhe korrigjuar kushtet e pasigurta dhe praktikatat e punës. Ata ofrojnë trajnime për përmirësimin e sigurisë dhe për zbatimin e programeve të sigurisë, si dhe masin e studiojnë efikasitetin e këtyre përpjekjeve.
- **Epidemiologët** studiojnë modelet e sëmundjeve, rreziqet e shëndetit, ose lëndimet e grupeve të caktuara të njerëzve apo kulturave.
- **Ergonomistët** projektojnë mjete, mobile, makineri dhe procese punuese që mbrojnë shëndetin e punëtorëve duke ulur tendosjen fizike, lodhjen operuese dhe përhumbësinë.
- **Psikologët e shëndetit në punë:** punojnë në fushën e psikologjisë për të përmirësuar cilësinë e jetës në punë, dhe për të mbrojtur dhe promovuar sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e punëtorëve.

EMERGJENCAT NË LAJME

RINIA  PUNË

Diskutim për sigurinë
Materiali 10 për nxënësit

RASTI 1: Zjarri nga yndyrat në restorant djeg punonjës

Një zjarr shpërtheu në një restorant familjar mbrëmjen e së martës duke lënduar në mënyrë kritike një punonjës dhe duke shkaktuar dëme materiale. Zjarri nisi kur një tigan i mbushur me vaj në një shporet të nxehtë ishte lënë i pambikëqyrur. Zjarri u përhap shpejt në peshqirët varur aty pranë. Një punonjës e pa zjarrin dhe u përpoq që ta shuante atë duke derdhur ujë në furrë. Kjo bëri që yndyra e djegur t'ia spërkat fytyrën, krahët dhe gjoksin e tij! Një koleg, pasi dëgjoji britmat, bërtiste që të gjithë të largoheshin menjëherë nga restoranti dhe telefonoi 211-shin. Zjarrfikësit e shuan zjarrin dhe u kujdesën për punëtorin e djegur. I lënduari u dërgua në spital me lëndime të rënda.

- Çfarë shkoi mirë?
- Çfarë shkoi keq?
- Çfarë mund të bëhet për të mbrojtur dhe përgatitur më mirë punonjësit?

RASTI 2: Grabitësi kërcënon me armë punonjës

Një punonjës 16-vjeçar i një dyqani, ishte kërcënuar me armë të enjten mbrëma nga një person i maskuar i cili kërkonte të holla. Punonjësi ishte duke punuar vetëm, dhe ishte duke e mbyllur dyqanin për atë natë. Më vonë, punonjësi i tha policisë se, derisa po e zbraste arkën, grabitësi e kishte lidhur atë, dhe u largua me të holla. Edhe pse grabitja e tronditi punonjës, ai nuk ishte lënduar fizikisht. Emri i punonjësit po mbahet i fshehur për shkak të moshës së tij.

- Çfarë shkoi mirë?
- Çfarë shkoi keq?
- Çfarë mund të bëhet për të mbrojtur dhe përgatitur më mirë punonjësit?

RASTI 3: Një punonjës i ri ndërtimi rrëzohet nga shkalla

Një bojaxhi 18-vjeçar, që po ngjyrose katin e dytë të shtëpisë, u rrëzua dje nga shkalla duke thyer të dyja këmbët e tij. Ai gjithashtu pësoi prerje të rënda kur e zuri krahun në një gardh metalik. Kolegët nxituan për ta ndihmuar dhe thirrën një ambulancë. Teknikët e emergjencës mjekësore thanë se kolegët kanë bartur punonjësin e lënduar në oborr dhe pastaj kanë aplikuar presion në plagë të hapur për të ndaluar gjakderdhjen.

- Çfarë shkoi mirë?
- Çfarë shkoi keq?
- Çfarë mund të bëhet për të mbrojtur dhe përgatitur më mirë punonjësit?

RASTI 4: E ëma e punëtorit të ri me aftësi të kufizuara flet për reagimet e punëdhënësit gjatë tërmetit

Punonjësit e një Qendre Tregtare u grumbulluan nën tavolina dhe korridore, meqë një tërmet i shkallës 6.1 tronditi ndërtesën e tyre. Kur tërmeti u ndal, punëtorët ndjekën shenjat ndriçuese dalëse për tek shkallët. Ata i kaluan 10 palë shkallë dhe dolën në rrugë. Marie Krasniqi nga Drenasi ka një djalë, Jonin, i cili është një punonjës i kompanisë. Ajo është ankuar se djali i saj, i cili ka sindromin Down, kishte mbetur i vetëm gjatë dhe pas tërmetit. Punonjësi dhe mbikëqyrësit nuk kishin ide se Joni kishte mbetur në katin e 11-të. Kompania zotohet që të shikoj Planin e Veprimit të Emergjencës dhe siguron që plani i përgatit dhe i mbron të gjithë punonjësit, duke përfshirë edhe ata që mund të kenë nevojë për më shumë ndihmë.

- Çfarë shkoi mirë?
- Çfarë shkoi keq?
- Çfarë mund të bëhet për të mbrojtur dhe përgatitur më mirë punonjësit?

RASTI 5: Era e fortë i thyen dritaret e një dyqani lokal

Një erë e fortë shpërtheu dje në qytet duke lënë pa energji zona të mëdha dhe duke dëmtuar shumë ndërtesa. Era theu shumicën e dritareve në një dyqan. Derisa xhamat binin, punonjësit i tubuan konsumatorët në sektorët e çdo kati të ndërtesës tre-katëshe. Konsumatorët ishin mirënjohës për ndihmën që punonjësit iu dhanë në largimin e të gjithëve nga dritaret.

- Çfarë shkoi mirë?
- Çfarë shkoi keq?
- Çfarë mund të bëhet për të mbrojtur dhe përgatitur më mirë punonjësit?

PLANI I VEPRIMIT TË EMERGJENCAVE

Planifikimi rrit sigurinë e punonjesve dhe vendeve të punës në situata emergjente. Inspektorati i Punës obligon çdo biznes të ketë një Plan Veprimi të Emergjencave. Plani përfshin masat e nevojshme para, gjatë dhe pas një emergjence. Ai gjithashtu paraqet hapat që të gjithë duhet të ndjekin në raste emergjente. Plani duhet të përfshijë edhe personat përgjegjës në rast emergjence. Ai duhet të ketë edhe hartën e lokacioneve ku janë ruajtur kimikatet dhe listat e të dhënave të sigurisë së produkteve kimike (në rast se kimikatet përdoren në vendin e caktuar të punës). Plani duhet të parasheh masat e mbrojtjes së punonjësve, duke përfshirë punonjësit me aftësi të kufizuara.

Trajnimi dhe stërvitjet

Punonjësit duhet të marrin pjesë në trajnim dhe stërvitje të rregullta që të përgatiten për reagim në situata të ndryshme emergjente. Stërvitjet dhe trajnimet duhet të përfshijnë këtë informacion:

- Si të raportohet një rast emergjent?
- Çfarë duhet të bëjnë punëtorët?
- Si tingëllojnë dhe si duken alarmet?
- Si dihet se “gjithçka ka përfunduar”?
- Ku është vendi i takimit?
- Çfarë duhet bërë nëse derdhen kimikatet?
- Kur dhe si të përdoren pajisjet e emergjencës?

Sistemet e alarmit

Të gjithë punonjësit duhet të jenë në gjendje të shohin, dëgjojnë dhe të kuptojnë alarmet.

Strehimoret dhe evakuimi

Punonjësit duhen informuar për daljet e brendshme dhe strehimoret, për shtigjet më të mira për të dalë jashtë dhe rregullat që duhen ndjekur gjatë largimit. Ju duhet të dini se ku do të takoheni me punonjësit tjerë.

Daljet duhet të kontrollohen vazhdimisht nga personi përgjegjës në ndërmarrjen ku punoni për tu siguruar se nuk janë të bllokuara. Vendi ku ju punoni duhet të ketë dalje të mjaftueshme dhe ato duhet të jenë mjaft të gjera në mënyrë që punonjësit të mund të dalin jashtë shpejt. Të gjithë duhet të dinë se ku të takohen jashtë në mënyrë që të konstatohet nëse dikush ka mbetur brenda.

Dritat e emergjencës

Rrugët/korridoret për të dalë jashtë duhet të kenë dritat emergjente në të gjitha hapësirat e punës.

Mjetet e emergjencës

Plani duhet të listoj mjetet e nevojshme emergjente për vendin tuaj të punës. Kjo mund të përfshijë sistemet spërkatëse në ndërtesë, aparatet për fikjen e zjarrit, sistemet për larjen e syve dhe dushet e sigurisë, nëse janë përdorur kimikatet.

Si të veprohet në rast të lëndimit

Plani duhet të përcaktoj edhe se sa kuti të ndihmës së parë do të jenë në dispozicion, ku mund ti gjejmë dhe kush do të trajnohet për përdorimin e tyre. Punonjësit duhet ta dinë kush është trajnuar për dhënien e ndihmës së parë dhe ku të marrin ndihmë mjekësore, nëse është e nevojshme.

**A JE TI NJË PUNONJËS I RI NË
KOSOVË?
MBROJ SHËNDETINI! NJIH TË DREJTAT TUA!**

A MUND TË LËNDOHEM OSE SËMUREM NË VENDIN E PUNËS?

Buna 17-vjeçare e kapi dorën e saj në një prerës elektrik të lakrës në një restorant të ushqimit të shpejtë. Dora e saj më kurrë nuk do të jetë e njëjtë dhe ajo kurrë nuk do të jetë në gjendje ta përdor atë plotësisht.

Guri 17 vjeçar ishte një ndihmës në ndërtim. Një goditje elektrike e vrau atë kur ai u ngjit në një shkallë metalike, ndërsa mbante një turjelë elektrike.

Ema 16 vjeçare është qëlluar dhe grabitur me armë në një dyqan për sanduiç. Ajo ishte duke punuar vetëm pas orës 23:00.

Çdo vit në Kosovë shumë punonjës lëndohen dhe humbin jetën në punë.

Si një punëtor i ri, ti ke më shumë gjasa se një person i vjetër që të lëndohesh në punë. Nga ti mund të kërkohet të bësh edhe punë që ligji i ndalon për personat e moshës nën 18 vjeçare.



NGA CILAT RREZIQE DUHET TË RUHEM UNË?

| Lloji i punës | Shembuj të rreziqeve |
|-----------------------|---|
| Shërbimet e ushqimeve | Dysheme të rrëshqitshme Skarë Thikat Ngacmimi ose diskriminimi |
| Shitje me pakicë | Krime të dhunshme Ngritje e peshave të rënda Ngacmimi ose diskriminimi |
| Zyrë | Stresi Dizajnimi i dobët i vendit të punës Ngacmimi ose diskriminimi |
| Kujdesi shëndetësor | Kimikate helmuese Gjilpëra të hedhura Ngritje e peshave të rënda Ngacmimi ose diskriminimi |

CILAT JANË TË DREJTAT E MIA NË VENDIN E PUNËS?

Ju keni të drejtën ligjore për:

- Një vend të sigurt dhe të shëndetshëm pune. Kjo duhet të përfshijë edhe trajnimet, me fjalë që ju mund ti kuptoni. Shefi juaj ndoshta duhet t'iu mësoj juve se si të përballeni në rastet e emergjencave dhe rreziqe të tilla si kimikatet.
- Pajisjet e sigurisë si: kufjet e veshit, dorëzat, syzet e sigurisë dhe veshjet e veçanta (sipas nevojës).
- Të fitoni të paktën rrogën minimale. Në Kosovë paga minimale për të punësuarit deri në moshën 35 vjeçare është 130 Euro, ndërsa për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeçare është 170 Euro. Shih në <http://www.rks-gov.net> për më tepër informacion dhe për të dhënat e fundit.
- Në qoftë se lëndoheni në punë e drejta për kompensim të trajtimit mjekësor dhe e drejta për rrogat në mungesë (gjatë trajtimit mjekësor)
- Lloje të tjera të ndihmës nëse ju keni probleme afatgjata shëndetësore për shkak të lëndimit tuaj në punë.

Ju gjithashtu keni të drejtë të:

Raportoni problemet e sigurisë në Inspektoratin e Punës.

Të punoni aty ku nuk ngacmoheni për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, fesë, gjinisë, shtatzënisë, vendlindjes, paaftësisë, moshës apo tjetër; ngacmim janë edhe shakatë ofenduese ose ekspozimi i fotografive të caktuara, fyerjet racore apo tjetër.

Pyetni për mundësitë e përshtatjes së vendit tuaj të punës (në rast se një gjë e tillë nevojitet për shkak të gjendjes tuaj shëndetësore, besimit fetar apo tjetër).

Bisedoni me kolegët tuaj rreth se sa fitojnë ata dhe cilat janë kushtet e tyre të punës.

Bashkëpunoni me inspektorët e punës, gjatë inspektimeve të tyre apo për të lajmëruar ndonjë shkelje.

Ju gjithashtu mund të merrni pjesë në përpjekjet për përmirësimin e kushteve të punës, pagesave dhe përfitimeve.

A është në rregull të bësh çdo lloj pune?

JO! Legjislacioni në Kosovë mbron adoleshentët nga punët e rrezikshme.

JU KENI TË DREJTË TË RAPORTONI

Nëse ju mendoni se ligjet për sigurinë, punën e fëmijëve ose pagat nuk janë duke u zbatuar. Ju duhet gjithashtu të raportoni në qoftë se mendoni se ligjet që mbajnë punëtorët nga të qenit të diskriminuar dhe të keqtrajtuar janë duke u thyer. Është kundërligjore nëse ju pushoheni nga puna apo keqtrajtoheni në ndonjë mënyrë tjetër, sepse ju raportoni këto probleme. Ligji gjithashtu ju mbron në qoftë se ju lëndoheni në punë dhe aplikoni për pagesën e faturave tuaj mjekësore.



Disa aktivitete punuese të rrezikshme dhe të ndaluara për personat e moshës 15-18¹

Nëse jeni nën 18 vjeç, ju nuk mund të

| | |
|---------------------------------------|---|
| Vozitni ose punoni me | <ul style="list-style-type: none"> • Makineri bujqësore dhe çfarëdo pajisje tjetër motorike |
| Operoni me | <ul style="list-style-type: none"> • Pesticide • Sharrë motorike dhe makina për përpunimin e drurit; |
| Punoni në | <ul style="list-style-type: none"> • shkatërrim, demolim, gërmim apo miniera; • prerje-transportim të trupave, sharrë; • shërbimet e pylltarisë, ose shuarjen e zjarreve në pyje; • thertore dhe në industrinë e përpunimit të mishit; • në thellësi, nën sipërfaqe të tokës, nën ujë dhe vende të mbyllura; • ndërtimtari (gërmimi i dheut, sitja e rërës dhe çimentos, puna në skela); • përpunimi i metaleve; • vendet ku ka ekspozim ndaj temperaturave ekstreme të larta apo të ulëta, ndaj zhurmës dhe dridhjes; • vendet ku ka prezencë të agjensëve biologjikë; • vendet ku ka prezencë të substancave toksike; • eksploatimin e pasurive natyrore (gërmimet sipërfaqësore dhe eksploatimi i thëngjillit, rërës dhe gurëve |
| Ngritni dhe bartni peshë | <ul style="list-style-type: none"> • mbi 15 kg (M) dhe 10 kg (F), në rast të ngritjes dhe bartjes së kohëpas-kohshme; • mbi 10 kg (M) dhe 5 kg (F), në rast të ngritjes dhe bartjes së vazhdueshme; |
| Punoni në orët e vona të natës | <ul style="list-style-type: none"> • nga ora 22 e mbremjes deri në ora 6.00 të mëngjesit |

Disa aktivitete tjera me rrezikshmëri të lartë

Nëse jeni nën 18 vjeç, ju poashtu nuk guxoni të

| | |
|--|---|
| Punoni në deponi të mbeturinave | <ul style="list-style-type: none"> • Hulimtimi dhe grumbullimi i mbeturinave në deponitë e mbeturinave apo në kontejnerë të qytetit |
| Punoni në rrugë | <ul style="list-style-type: none"> • Shitje e sendeve të impta • Transportim i mallrave • Kërkim lëmoshe • Pastrim i parafangove të automjeteve |
| Aktivitete të tjera | <ul style="list-style-type: none"> shih • UA 05/2013 për Listën e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve dhe • Konventën për të Drejta të Fëmijëve |

¹ Listën e plotë mund ta gjeni në UA 01/2012 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për Sistemin e Punëve të Lejuara dhe të Ndaluar për Personat nën moshën 18 vjeçare

A KA NDONJË PUNË TË CILËN UNË NUK MUND TA BËJ?

PO! Shumë vende të punës, përveç atyre të listuara këtu, nuk janë të ndaluara për punëtorët e rinj. Për shumicën e vendeve të punës duhet të jesh së paku 15 vjeçar. **Para se të pranosh një punë, sigurohu që ke të drejtë për ta bërë atë punë.**

ÇFARË DUHET TË BËJ QË TË JEM I SIGURTE NË PUNË?

Për të punuar në mënyrë të sigurtë ti duhet të

- Respektosh të gjitha rregullat dhe udhëzimet e sigurisë;
- Përdorësh pajisjet e sigurisë dhe veshjet mbrojtëse, kurdo që është e nevojshme;
- Kuptosh ndikimin që rreziqet mund të kenë tek ti, familja dhe kolegët tu;
- Mbash ambientin e punës të pastër dhe pa rrëmujë;
- Përgatitesh dhe reagosh si duhet në rast emergjence;
- Njoftosh mbikëqyrësit për ndonjë rrezik të shëndetit dhe sigurisë;
- Informohesh dhe të bësh pyetje për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në vendin tënd të punës.

NGACMIMI NË PUNË: A ËSHTË ILEGALE?

Ngacmimi në vendin e punës ndodh kur dikush ju ngacmon, abuzon me fjalë, ju keqtrajton, apo ju kërcënon. Kushdo që e bën këtë shkon kundër politikës së kompanisë apo shkel ligjin.

Çfarë mund të bëni nëse mendoni se ju jeni një viktimë e ngacmimit në vendin e punës?

Mbani shënime sa herë që ndiheni të keqtrajtuar.

Bisedoni me një të rritur të besuar. Ngacmimi në vendin e punës mund të dëmtojë punën dhe shëndetin tuaj!



SA GJATË MUND TË PUNOJ?

Personat e moshës 15-18 vjeçare në shtetin tonë mund të punojnë maksimalisht 30 orë në javë.

SA VONË MUND TË PUNOJ?

Orari i punës për personat e moshës 15-18 vjeçare në shtetin tonë nuk guxon të jetë më vonë se ora 22.00 në mbrëmje dhe ora 06 në mëngjes.

ÇKA NËSE LËNDOHEM NË PUNË?


Lajmëroni menjëherë mbikëqyrësin tuaj. Nëse jeni nën 18 vjeç, tregojuni prindërve ose kujdestarëve. Merrni trajtim urgjent mjekësor nëse është e nevojshme. Pyesni për një formë të kërkesës nga punëdhënësi juaj, ose merreni nga ofruesi i kujdesit shëndetësor, nëse punëdhënësi juaj nuk ju jap një të tillë menjëherë.

Plotësoni formularin dhe dorëzoni te punëdhënësi juaj për të siguruar se ju do të përfitoni kompensimin e punëtorëve.

ÇKA NËSE KAM NJE PROBLEM TË SIGURISË?

Bisedoni me mbikëqyrësin, prindërit, mësimdhënësit, përfaqësues të trajnimit në punë ose përfaqësuesit e sindikatës në lidhje me problemin.

Kontaktoni inspektorin e punës për informacione të përgjithshme të sigurisë.






Ligji i Punës

Materiali 13 për nxënësit

TABELA # 1

B I N G O


























Ligji i Punës

Materiali 13 për nxënësit

TABELA # 2

B I N G O

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
|  |  |  | |  |
|  |  |  | |  |
|  |  |  |  | |
| |  |  |  |  |
| |  |  |  |  |























Ligji i Punës

Materiali 13 për nxënësit

TABELA # 3

B I N G O

| | | | | |
|---|---|---|--|---|
|  |  | |  |  |
|  |  |  |  |  |
|  |  |  | |  |
| |  | |  babysitting |  |
|  | |  |  | |

















Ligji i Punës

Materiali 13 për nxënësit

TABELA # 4

B I N G O

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
|  |  |  |  | |
|  | |  |  |  |
|  |  |  |  | |
|  |  |  |  |  |
|  |  | | |  |
























Ligji i Punës

Materiali 13 për nxënësit

TABELA # 5

B I N G O

| | | | | |
|---|---|---|--|---|
|  |  |  |  |  |
|  |  | |  | |
|  |  |  |  |  |
|  | | |  |  |
|  |  | |  |  |
























Ligji i Punës

Materiali 13 për nxënësit

TABELA # 6

B I N G O

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
|  |  |  | |  |
| | |  | |  |
|  |  |  |  |  |
|  |  |  | |  |
|  |  |  |  |  |























Ligji i Punës

Materiali 13 për nxënësit

TABELA # 7

B I N G O

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
|  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |
|  | |  | |  |
| | |  |  | |
|  |  |  |  | |























Ligji i Punës

Materiali 13 për nxënësit

TABELA # 8

B I N G O

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
|  |  | |  |  |
| |  |  |  |  |
| |  |  | |  |
| |  |  |  |  |
|  |  |  |  | |
























Ligji i Punës

Materiali 13 për nxënësit

TABELA # 9

B I N G O

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| |  |  |  |  |
|  |  |  | | |
|  |  |  |  |  |
|  |  |  |  | |
|  | |  |  |  |























Ligji i Punës

Materiali 13 për nxënësit

TABELA # 10

B I N G O

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
|  |  | | |  |
|  |  |  | |  |
|  |  |  | |  |
| |  |  |  |  |
|  |  |  |  | |




Ligji i Punës

Materiali 13 për nxënësit

TABELA # 11

B I N G O

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
|  |  | |  | |
|  |  | | |  |
|  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |
|  | |  |  |  |























Ligji i Punës

Materiali 13 për nxënësit

TABELA # 12

B I N G O

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | |  |  |
|  | | | |  |
|  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |
























Ligji i Punës

Materiali 13 për nxënësit

TABELA#13

B I N G O

| | | | | |
|---|--|---|---|---|
|  |  | |  | |
|  |  |  |  |  |
|  |  <p>10:00 pm</p> |  | |  |
| <p>\$ _____</p> |  |  <p>7:00 pm</p> |  <p>4 hours</p> |  |
|  <p>5:00 am</p> | |  |  <p>9:00 pm</p> |  |



TREGIMI I ELENES

RINIA  PUNË

Diskutim për sigurinë

Materiali 14 për nxënësit

SKENA: Dyqan sandviçësh. Elena është një 15 vjeçare, nxënëse e shkollës së mesme. Z. Xhonson është mbikëqyrësi i saj dhe Xhoi është një nga kolegët e saj. Është e enjte mbrëma.

z. Xhonson: Elena, Andre kalajmëruar se nuk mund të vijë në punë ngase është i sëmurë, kështu që kam nevojë që të punosh disa orë shtesë. Sonte duhet të qëndrosh deri në orën 22.00.

Elena: Por, z. Xhonson, unë kam test nesër dhe më duhet të jem në shtëpi për të studiuar.

z. Xhinson: Me të vërtetë më vjen keq, por ky është rast urgjent. Nëse don të punosh këtu, duhet të jesh e gatshme që të punosh kur kemi nevojë për ty.

Elena: Por unë kurrë nuk kam bërë punën e Andreut më parë.

z. Xonson: Së pari, shko prapa banakut dhe merru me porositë e sandviçëve për një kohë. Kërko nga Xhoi që të tregoj se si përdoret makina për prerjen e mishit. Pastaj, kur të përfundosh prerjet, shko pastro dyshemenë në dhomën e furnizimit. Disa nga pajisjet për pastrim janë derdhur dhe është bërë rrëmujë.

Më vonë: Elena merr lekat dhe shkon në dhomën e furnizimit.

Elena: Hej, Xho! A e din se çka është derdhur në dysheme?

Xhoi: Nuk kam ide. Vetëm ki kujdes që të mos e prekësh me duar. Duhet të bartësh dorëza në qoftë se gjen. Andre mori një skuqje të lëkurës nga ato gjëra javën e kaluar.

ZHVILLIMI I ROLIT TUAJ

1. Diskutoni me klasën cilat ligje janë duke u shkelur këtu.

2. Punoni me grupin tuaj të vogël për të dalë me një fund tjetër në këtë tregim. Zgjidhni një problem në tregim dhe përqendrohuni në të. Mendoni për këto tre pyetje:

- Si duhet ti qaset Elena mbikëqyrësit të saj në lidhje me këto probleme?
- Si mund të reagoj mbikëqyrësi i saj?
- Ku tjetër mund të merr ndihmë Elena?

3. Ushtroni skeqin tuaj. Ju do të performoni për klasën më vonë.

ÇKA KENI MËSUAR?

✓ NËNVIZO PËRGJIGJEN E SAKTË

1 Ligji thotë se punëdhënësi juaj duhet t'iu ofroj një vend të sigurt dhe të shëndetshëm në punë.

E SAKTË E PA SAKTË

2 Ligji kufizon se sa vonë ju mund të punoni në një ditë të shkollës në qoftë se jeni nën moshën 16 vjeçare.

E SAKTË E PA SAKTË

3 Nëse jeni 16 vjeç, ju lejohet të vozitni makinën në rrugët publike si pjesë e punës suaj.

E SAKTË E PA SAKTË

4 Nëse lëndoheni në punë, punëdhënësi juaj duhet të paguaj për kujdesin tuaj shëndetësor.

E SAKTË E PA SAKTË

PËRGJIGJU NË PYETJET VIJUESE

- 5** Në rast të një problemi të shëndetit dhe sigurisë në punë, cilat janë dy gjëra që ju duhet të bëni?

- 6** Përmendni të paktën dy gjëra të reja që keni mësuar në lidhje me shëndetin dhe sigurinë.

- 7** Çfarë ju ka pëlqyer më shumë në lidhje me materialin e trajtuar gjatë Modullit për Sigurinë në Punë?

- 8** Çfarë do të përmirësoje ose ndryshoje?